

**PËRMBLEDHJE E
VENDIMEVE TË
KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

2023

PËRMBAJTJA

<u>I.</u>	<u>ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË VENDBANIMIT</u>	5
1.	<u>I.D., kundër Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës</u>	5
<u>II.</u>	<u>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE</u>	8
2.	<u>I.N., kundër Bashkisë Kamëz</u>	8
3.	<u>D.M., kundër Bashkisë Kukës</u>	11
<u>III.</u>	<u>ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL</u>	14
4.	<u>Qendra “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, kundër Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, përfaqësuar nga A.P., dhe A.G.</u>	14
<u>IV.</u>	<u>ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE</u>	18
5.	<u>Qendra “Për Advokim Social”, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë</u>	18
6.	<u>I.G., kundër Bashkisë Korçë dhe OSHEE sh.a.</u>	23
<u>V.</u>	<u>ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË</u>	27
7.	<u>Shoqata “Për Drejtësi Sociale” kundër shtetasit S. N.</u>	27
<u>VI.</u>	<u>ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQËRORE</u>	31
8.	<u>A. A., kundër Përgjegjësit të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZV ASHK) Tropojë</u>	31
<u>VII.</u>	<u>ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR</u>	34
9.	<u>Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz</u>	34
10.	<u>A. G., kundër Kompanisë “Chicken Farm Albania” sh.p.k</u>	38
11.	<u>S.C., kundër Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 1, Tiranë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive</u>	41
12.	<u>Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë së Tiranës</u>	44
13.	<u>Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz</u>	47
14.	<u>Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a., (Zyra Postare Tirana 21)</u>	50
15.	<u>M. SH., kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.</u>	54
16.	<u>A. Z, kundër Bashkisë Fier</u>	57
17.	<u>S. H., kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.</u>	60
18.	<u>M. S, kundër Shoqërisë së Transportit “EL-ALBA 1” sh.p.k.</u>	63
19.	<u>A. M., kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.</u>	66

20.	J. M., kundër Shoqërisë LEDJAN sh.p.k.	69
21.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë.	72
22.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kavajë	76
23.	H. Ç., kundër Shoqërisë LEDJAN sh.p.k.	80
24.	Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, kundër Postës Shqiptare sh.a., dhe Bashkisë Korçë.	83
25.	Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” kundër Bashkisë së Tiranës	86
26.	A. B. kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.	89
27.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kavajë	92
28.	Fondacioni “Së Bashku”, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër.	95
VIII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE	98
29.	A. B., kundër Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan.	98
IX.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR	101
30.	I. B., kundër Shkollës Jopublike, Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër.	101
31.	F. LL., kundër: Ministrisë së Kulturës, Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kombëtare dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër	104
32.	P. S., kundër Rektores së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”	107
33.	A. D., kundër Shoqërisë “Illyrian Guard” sh. a. Tiranë	110
34.	M. K., kundër Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.	113
35.	S. L., kundër Rektores së Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër	117
36.	J. M., kundër Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)	120
X.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMEN NDËRSEKTORIALE	123
37.	Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, kundër Bashkisë Vorë	123
38.	J. Q., kundër Bashkisë Korçë	128
39.	J. Sh., kundër Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK), Bashkia Tiranë	132
40.	R. G., kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës	138
41.	P. GJ., kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë	143

Parathënie

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një organ publik i pavarur, i cili ka për funksion garantimin e zbatueshmërisë së Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Një ndër kompetencat më të rëndësishme që ky institucion ka, është ai i trajtimit të ankesave që mbërrijnë nga individë, grupe individësh dhe organizata të shoqërisë civile me qëllim konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e sjelljes diskriminuese të konstatuar.

Komisioneri mund të ngrejë edhe çështje kryesisht ose *ex officio*, si dhe ka të drejtë të vendosë sanksione administrative kundrejt subjekteve që nuk zbatojnë vendimet që kanë konstatuar diskriminim.

Qëllimi i kësaj përmbledhje vendimesh të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është që t’i shërbejë publikut të gjerë për ta informuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni, por sidomos edhe për ta udhëzuar atë mbi shkaqet, format dhe fushat e diskriminimit me qëllim për një kuptueshmëri më të mirë të tyre.

Përmbledhjet e vendimeve janë hartuar në mënyrë të tillë që ta japin aspektet më thelbësore të vendimit, por sigurisht për një hulumtim më të thellë do të nevojitej konsultimi i tyre në tërësi. Gjithashtu, funksioni i përmbledhjes së vendimeve ka për qëllim edhe të lehtësojë gjetjen e tyre sipas interesit të subjekteve, në faqen *web* të institucionit ku publikohen të gjitha vendimet.

Së fundmi, qëllim specifik është ai i nxitjes së operatorëve të së drejtës, juristë, avokatë, gjyqtarë, lektorë, studiues, studentë, punonjës administrate që të konsultojnë këto vendime për njohjen e praktikës së maturuar prej 10 vjetësh nga institucioni por, edhe për të shprehur sensin e tyre kritik mbi kuptimin dhe arsyeshmërinë e vendimmarrjes, si dhe të nxitjes së debatit juridik, social dhe politik mbi të drejtat e njeriut e më specifikisht të parimit të barazisë dhe atij të mosdiskriminimit. Uroj që kjo përmbledhje të shërbejë për qëllimin e saj dhe të jetë një mjet i dobishëm për çdokënd të interesuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
PhD Robert Gajda

I. ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË VENDBANIMIT

I. D. kundër Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës

VENDIM NR. 154, DATË 03.08.2023

Shkaku: Vendbanimi
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesit i është mohuar e drejta e ndjekjes së programit të doktoraturës nga ana e FEUT-së, si rezultat i refuzimit të pranimit të aplikimit për shkak të vendqëndrimit të tij jashtë Shqipërisë, (në kuadër të punësimit pranë American University Middle East).

FAKTET

Subjekti ankues i ka drejtuar një kërkesë Departamentit të Marketing-Turizmit, pranë Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës, për ndjekjen e programit të studimit të doktoraturës.

Nëpërmjet email-it të dërguar nga Kryetarja e Degës së Kualifikimit Shkencor pranë këtij Fakulteti (FE/UT), ankuesit i është bërë me dije se dosja e tij e aplikimit për doktoraturë pranë FE/UT nuk mund të konsiderohet pasi vendqëndrimi i tij është jashtë Shqipërisë (referuar vërtetimit të punësimit pranë American University Middle East).

Nga komunikimi me email mes tyre, evidentohet se ankuesi ka kërkuar sqarime lidhur me faktin se mbi bazën e cilit akt ligjor apo nënligjor bazohet argumentimi i FE/UT, ku të jetë përcaktuar si kriter përjashtues fakti që personat me punësim jashtë vendit nuk mund të aplikojnë në studimet e ciklit të tretë në Shqipëri. Përgjigjja që i është komunikuar nga Fakulteti është se: *“Kuotat e doktoraturave ofruar nga FE/UE, janë për personelin akademik apo personelin kërkimor shkencor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar pranë IAL-ve në Shqipëri apo IAL-ve që kanë marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës”*.

Lidhur me argumentimin e FE/UT, ankuesi pretendon se është shtrembërim i interpretimit të Ligjit Nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë”*, pasi pikës 2, të nenit 79, të tij, i janë shtuar fjalë e fraza për të përligjur vendimin që dosja e aplikimit të tij për doktoraturë të përjashtohet e të mos dërgohet pranë Komisionit të Departamentit ku ai kishte aplikuar. Ankuesi shprehet se punësimi i tij jashtë Shqipërisë, edhe pse i përkohshëm me kohë të pjesshme e dytësor, duhet të ishte një vlerë e shtuar dhe jo një kriter përjashtues e diskriminues, për më tepër kur në asnjë nga kriteret e shpallura nga Fakulteti, nuk cilësohet se vendbanimi (apo vendqëndrimi) duhet të ishte në Shqipëri detyrimisht.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, e ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut¹,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi Nr. 08, datë 26.04.2021, të Senatit Akademik të UT-së, Rregullorja “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e FEUT-së, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të vendbanimit jashtë Shqipërisë për shkak të punësimit të tij, vetëm lidhur me respektimin e procedurës së përcaktuar përpara i takon shqyrtimit të kërkesës së tij për regjistrimin në programin e doktoratës, dhe jo me analizimin e vlerësimit e faktit nëse kjo vendim-marrje ishte e drejtë dhe e ligjshme.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt. Kjo në këndvështrimin referuar faktit nëse, FEUT, ka respektuar të drejtën ligjore të ankuesit, lidhur me shqyrtimin e vlerësimit e kërkesës së tij, nga organi legjitim, i përcaktuar në aktet rregullatore përkatëse, dhe që kishte kompetencën për ta bërë një vlerësim të tillë.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri vlerësoi se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e në shkelje të dispozitave sa më sipër cituar, në të drejtën e tij, që kërkesën e dosjen e paraqitur, për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës, duhet ta shqyrtonte e vlerësonte Komisioni i posaçëm Ad-Hoc, dhe jo një punonjëse e vetme e FEUT-së, dhe për më tepër pa asnjë kompetencë për të bërë një gjë të tillë. Komisioneri prezumon faktin se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, duke u mbështetur në faktin që, *(sikurse vetë strukturat e FEUT-së i kanë pohuar ankuesit, por edhe para KMD-së)*, vendbanimi/vendqëndrimi i tij i përkohshëm jashtë Shqipërisë, për arsye të punësimit të tij në AUM/Kuvajt, ka shërbyer si shkak për mosshqyrtimin e kërkesës e dosjes së tij nga ana FEUT-së, lidhur me regjistrimin në programin e doktoratës, pranë këtij Fakulteti dhe përjashtimin e tij nga kjo e drejtë.

¹ Në nenin 26 : “Të gjithë kanë të drejtë në arsim. Arsimi i lartë do të jetë njësoj i arritshëm për të gjithë në bazë të meritave”.

Sa më sipër, në rastin në shqyrtim duket qartë që ka një lidhje mes trajtimit të diferencuar dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Në rastin në fjalë, Komisioneri vlerësoi se lidhja e shkakut me trajtimin e padrejtë e të pafavorshëm të ankuesit nga ana e FEUT-së, nuk i nënshtrohet një analizimi e vlerësimi të tillë, pasi, Komisioneri nuk ka vlerësuar këtë vendimmarrje, nëse ajo është apo jo e drejtë dhe e bazuar në kriteret e vendosura; përsa kohë që, FEUT kundrejt ankuesit ka konsumuar shkelje të atilla procedurale, të cilat kanë cenuar rëndë këtë procedurë, duke e bërë atë të paligjshme e të padrejtë. Në këtë kontekst, vetë FEUT, UT, në parashtrimet e tyre nuk kanë provuar se procedura e ndjekur prej tyre, është konform akteve rregullore përkatëse, por janë investuar të argumentojnë se vendimmarrja e tyre ishte e drejtë dhe ligjshme. Fakt për të cilin Komisioneri nuk ka bërë asnjë analizë ligjore, përsa kohë një vendim i tillë është marrë në mungesë të kompetencës së organit përgjegjës për të bërë një vlerësim e për të dalë me një vendim-marrje të tillë.

Në përmbyllje të gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, pavarësisht faktit se si do të ishte vendim-marrja lidhur me kërkesën e ankuesit për regjistrimin në programin e studimeve të doktoratës, (*gjë cila nuk është pjesë e analizës së këtij vendimi*), FEUT, duhet të kishte respektuar të drejtën e ankuesit, bazuar në detyrimin ligjor të tyre, për kalimin e kërkesës e dosjes së tij, për shqyrtim, pranë Komisionit Ad-Hoc, të ngritur për këtë funksion, në respektim të nenit 6, të Rregullores “*Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës*”, dhe jo të lejonte (*për më tepër të mos vepronte as në vijim për korrigjimin e saj*) një shkelje kaq të rëndë të procedurës që duhej ndjekur për kalimin për shqyrtim të kërkesës e dosjes së tij, tek organi kompetent, Komisioni Ad-Hoc, i ngritur për të kryer këtë funksion.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, I. D., për shkak të vendbanimit për arsye të punësimit jashtë Shqipërisë, në të drejtën e tij për arsim, nga ana e Fakultetit të Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës (FEUT).
- FEUT, të marrë masat përkatëse, brenda një afati të arsyeshëm kohor, për kalim e dosjes së kërkesës së I. D., për shqyrtimin e vlerësimin e saj, në Komisionin Ad-Hoc, pranë FEUT-së, të ngritur për këtë funksion.
- FEUT, rekomandohet të marrë masat e nevojshme, për respektimin e të gjitha pikave të Rregullores “*Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës*” dhe legjislacionit në fuqi, në kuadër të transparencës dhe së drejtës për informim, lidhur me metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, dhe publikimit të tyre në faqen e internetit të çdo njësie kryesore, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve².

² Sipas përcaktimit të pikës 6, të kësaj Rregulloreje.

II. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

I. N. kundër Bashkisë Kamëz

VENDIM NR. 28, DATË 14.02.2023

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Kamëz. Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Ankuesi me Urdhrin Nr. 230, datë 08.04.2016 është emëruar si “*Punonjës i Bordit të Kullimit + Pyjeve*”, pranë Drejtorisë ZMTP-së, të Bashkisë Kamëz.

Me shkresën Nr. 4820/1, datë 26.06.2020 “*Dhënie mase disiplinore*”, Drejtori i Drejtorisë së MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, si eprori direkt, ka dhënë masë disiplinore për ankuesin, për shkelje të lehtë, për sjellje të parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun. Po e njëjta masë disiplinore me të njëjtin motivacion, është dhënë dhe për punonjësit, M. H. dhe H. H.

Me Urdhrin Nr. 323, datë 14.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “*Për lëvizje paralele në detyrë*”, është urdhëruar që E. B., të lëvizë nga detyra Drejtor, pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe emërohet Drejtor, pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Kadastrës.

Me Urdhrin Nr. 1, datë 22.06.2021 të E. B., Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Kadastrës është ngritur grupi i punës me punonjësit, M. H., I. N., H. H., dhe O. Y., për të verifikuar/ azhurnuar pozicionimin/konstatimin e pronës së S. T.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, grupi i punës ka mbajtur procesverbalin Nr. 1/1, datë 23.06.2021, në të cilin ka dhënë konkluzionet përkatëse.

Me Urdhrin Nr. 4, datë 30.06.2021 të E. B., Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Kadastrës është ngritur grupi i punës me punonjësit, M. H., I. N., H. H., dhe O. Y., për të verifikuar/azhurnuar pozicionimin/konstatimin e pronës së E. G.

Vetëm 3 (tre) javë pas ardhjes së tij në detyrë, Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Kadastrës, me Relacionin Nr. 6894, datë 06.07.2021, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka kërkuar marrjen e masës disiplinore “Largim nga detyra” për ankuesin.

Me Urdhërin Nr. 366, datë 07.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz është urdhëruar largimi nga detyra i I. N., me motivacionin “*Moszbatim në mënyrë të vazhdueshme të detyrave funksionale*”, dhe në të njëjtën ditë më shkresën Nr. 6901, datë 07.07.2021, ankuesi është njoftuar për urdhrin e largimit nga puna.

Gjithashtu, me Vendimin Nr. 6904, datë 07.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz është vendosur dhënia e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për punonjësin H. H., me motivacionin “*Moskorrektësi në zbatimin e detyrave funksionale*”.

Ankuesi kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike dhe angazhimit të tij gjatë administrimit të procesit zgjedhor të datës 25.04.2021, për subjektin politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerësoi se argumenti i parashtruar nga ana e Bashkisë Kamëz, për moszbatim në mënyrë të vazhdueshme të detyrave funksionale nga ana e ankuesit, është i pabazuar dhe nuk qëndron, për arsye se:

Së pari, deri në datë 07.07.2021, ankuesi nuk ka asnjë njoftim për moszbatim të detyrave të ngarkuara apo vlerësime pune negative.

Së dyti, me relacionin e hartuar në datë 06.07.2021, nga ana e Drejtorit të Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Kadastrës është kërkuar largimi nga puna i ankuesit, ndërkohë që nuk është kërkuar

largim nga puna për punonjës të tjerë të grupit të punës, që kishin përgjegjësi të barabartë me ankuesin.

Së treti, nga ana e Bashkisë Kamëz, nuk është menduar që masat disiplinore të jepen duke u përshkallëzuar, nga një masë më e lehtë në një masë më të rëndë, por për ankuesin është propozuar dhe marrë menjëherë masa disiplinore më e rëndë, ajo e largimit nga puna.

Së katërti, Bashkia Kamëz nuk arriti të provojë para Komisionerit se, kishte zhvilluar një takim paraprak me ankuesin, në të cilin ta kishte njohur me arsyen dhe motivin mbi të cilin bazohej zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, apo që t'i kishte krijuar mundësinë këtij të fundit të dëgjohej dhe të mbronte interesat e tij të ligjshëm.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë, njëkohësisht duke iu referuar faktit se pasojat negative ndaj ankuesit janë kryer në periudhën pas zgjedhjeve të datës 25.04.2021, Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për largimin nga puna të ankuesit. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar dhe përfaqësues në procesin e administrimit zgjedhor të subjektit politik Partia Demokratike, dhe faktit që Bashkia Kamëz, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Kamëz, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të ankuesit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Kamëz.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kamëz, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

D. M. kundër Bashkisë Kukës

VENDIM NR. 150, DATË 31.07.2023

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim në formën e rëndë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Kukës. Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Me Urdhrin Nr. 09, datë 10.01.2022 “Për emërim në detyrë”, të Bashkisë Kukës, ankuesi është emëruar në pozicionin “*Specialist i Kontrollit të Territorit*” në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të Bashkisë Kukës dhe mes palëve është lidhur Kontrata e Punës Nr. 08, datë 11.01.2022, me afat deri në përfundimin e procesit të rekrutimit në Shërbimin Civil.

Me shkresën Nr. 814, datë 14.09.2022 “*Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*”, Bashkia Kukës ka njoftuar ankuesin se: “... për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës si pjesë e riorganizimit me ndryshimet në strukturën e Bashkisë Kukës ju njoftojmë se në bazë të vjetërsisë që ju keni në këtë pozicion pune, marrëdhënia juaj e punës dhe financiare me Bashkinë Kukës përfundon me datë 21.10.2022”.

Me shkresën datë 29.09.2022, drejtuar Bashkisë Kukës, D. M., ka kërkuar anulimin dhe shfuqizimin e akteve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Në vijim të njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nuk evidentohen të jenë ndërmarrë hapa të tjerë apo të jetë vijuar më tej me procedurën e iniciuar kundrejt ankuesit nga punëdhënësi, deri në datë 30.12.2022.

Me Urdhrin Nr. 1012, datë 30.12.2022 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, Bashkia Kukës ka urdhëruar: “*Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të D. M., nga pozicioni Specialist i Kontrollit të Territorit në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të Bashkisë Kukës, me përfundimin e afatit të kontratës së punës*”.

Ankuesi e kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të bindjes politike të tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokolli 12 i saj;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në mënyrë të përsëritur ka kërkuar nga Bashkia Kukës informacion dhe dokumentacion, lidhur me procedurën e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, studimin/relacionin lidhur me arsyet e ndryshimit të strukturës së Bashkisë Kukës, dokumentin mbi vlerësimin e bërë për të gjithë punonjësit e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të Bashkisë Kukës, të cilët do të nënshtroheshin ristrukturimit (*kriteret dhe tabela e vlerësimit me pikë*), përzgjedhjen e punonjësve që do vazhdonin marrëdhëniet e punës në pozicionin e specialistit të kontrollit të territorit, sa punonjës janë larguar nga puna si pasojë e ristrukturimit të institucionit, sa punonjës të prekur nga ristrukturimi janë transferuar në pozicione të tjera dhe kopje të planit vjetor të vitit 2022, të pranimeve në shërbimin civil të Bashkisë Kukës, por nga ana e Bashkisë nuk u vunë në dispozicion të Komisionerit informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar.

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, Bashkia Kukës, jo vetëm që nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike, por ky subjekt, mbajti një qëndrim nënvlerësues, duke mos paraqitur shpjegimet apo informacionin dhe dokumentacionin që iu kërkua zyrtarisht nga Komisioneri.

Komisioneri konstatoi se Bashkia Kukës ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim, pasi ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të bindjeve politike.

Komisioneri konstatoi se:

- Bashkia Kukës ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj ankuesit D. M. Rezulton se, Bashkia Kukës, me Urdhrin Nr. 160, datë 17.03.2021, ka larguar nga detyra si

Inspektor Kontrolli për Sigurinë Ushqimore, D. M., Urdhrin për largim nga puna, ankuesi e ka kundërshtuar në Gjykatë dhe pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin Nr. 186, datë 30.09.2021, ka konstatuar diskriminimin e D. M., nga ana e Bashkisë Kukës për shkak të bindjes politike dhe ka kërkuar rikthimin e tij në punë.
- Me Vendimin Nr. 03, datë 06.01.2022, Komisioneri ka gjobitur Bashkinë Kukës për moszbatimin e vendimit të KMD-së.
- Bashkia Kukës, në zbatim të vendimit të Komisionerit, me Urdhrin Nr. 09, datë 10.01.2022, ka bërë emërimin e D. M., në pozicionin Specialist i Kontrollit të Territorit në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të Bashkisë Kukës.
- Bashkia Kukës, me Urdhrin Nr. 1012, datë 30.12.2022, ka ndërprerë për herë të dytë, marrëdhëniet e punës me D. M.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, ndaj D. M., është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Bashkisë Kukës, pasi përmbushen parashikimet e nenit 3/1 të LMD-së.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, të ankuesit D. M., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Kukës.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kukës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

III. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL

Qendra “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, kundër Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, përfaqësuar nga A. P., dhe A. G.

VENDIM NR. 172, DATË 28.08.2023

Shkaku: Orientimi seksual, identiteti gjinor dhe përkatësia në një grup të veçantë
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Personat që i përkasin komunitetit LGBTI, janë diskriminuar si pasojë e gjuhës së urrejtjes të përdorur nga A. P.

FAKTET

Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, është një grupim individësh, që ka në përbërje persona juridik dhe fizik, të cilët janë mbledhur në mbrojtje të familjes dhe jetës, por nuk u konstatua që Koalicioni të ishte regjistruar në organet gjyqësore dhe të ekzistonte si person juridik. Pra, rezultoi se, Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës nuk kishte fituar personalitet juridik sipas formës së kërkuar nga legjislacioni Shqiptar. Për këtë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vijoi shqyrtimin e ankesës kundër A. P., dhe A. G.

Më datë 23 nëntor 2022, Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, kishte organizuar takimin për të diskutuar rreth shfaqjes së filmit “*Strange World*”, në Kinema Millenium më datë 24.11.2022. Nga pala ankuese, u pretendua për diskriminim kundër Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, përfaqësuar nga A. P., dhe A. G., për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

Sipas informacionit të dhënë nga palët, në profilin e *Facebook* të A.P., ishte transmetuar në kohë reale takimi i mbajtur. Ndër pjesëmarrësit në këtë takim kishin qenë vetë A.P., dhe A.G. Sakaq, Komisioneri nuk arriti të administrojë në cilësinë e provës, videon e plotë të takimit të mbajtur më datë 23.11.2022, por arriti të shkarkoj nga llogaria në *Facebook* e A.G., fjalën e mbajtur prej tij në këtë takim.

Pala ankuese pretendoi se nga ana e A. P., dhe A. G., ishin bërë thirrje në rrjetet sociale gjatë takimit të “*Koalicionit Pro Jetës dhe Familjes*”, ku ishin shprehur se filmi që do të shfaqej ishte një kurth, pasi Kinemaja nuk u ofronte informacione prindërve mbi përmbajtjen e tij homoseksuale. Sakaq, përmes këtyre thirrjeve, A. P., dhe A. G., kishte vënë në pozita diskriminuese anëtarët e komunitetit LGBT, për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave);
- Rekomandimi CM/Rek (2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave);
- Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132);
- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 22, Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993.

KONKLUZIONE

Lidhur me shprehjet e përdorura nga A. P., pala ankuese vuri në dispozicion të Komisionerit 2 (dy) “linqe” ku mund të aksesohet videoregjistrimi i takimit të “Koalicionit Pro Jetës dhe Familjes”, të datës 23.11.2022. Pavarësisht këtij fakti, Komisioneri nuk arriti të aksesojë videoregjistrimin e takimit, pasi “linqet” e vendosura në dispozicion nuk hapeshin, një fakt të tillë e kishte pohuar edhe pala ankuese gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës. Ato ishin fshirë nga interneti dhe nuk ishte i mundur aksesimi i tyre.

Nga palët në proces por edhe nga Komisioneri, nuk u arrit të sigurohet informacioni dhe të administroheshin provat e nevojshme, për t’u shprehur mbi pretendimet e ngritura nga pala ankuese kundër A. P., dhe për të vlerësuar nëse jemi përpara përdorimit të gjuhës së urrejtjes, në kuptim të ligjit. Në këto kushte, Komisioneri arriti në përfundimin se, për pjesën e ankesës që lidhet me pretendimet e ngritura kundër A. P., procedura administrative duhej të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar.

Lidhur me shprehjet e përdorura nga A. G., pavarësisht faktit që nga ana e palës ankuese nuk u vu në dispozicion të Komisionerit videoregjistrimi i aktivitetit të mbajtur më datë 23.11.2022, u arrit të administrohet në llogarinë e Facebook të A. G., fjala e mbajtur prej tij në këtë takim. Referuar diskutimeve të sipërcituara të A. G., rezulton se fokusi i takimit të mbajtur me datë 23.11.2022, ka

qenë ndalimi i shfaqjes së filmit “*Strange World*”, në Kinema Milleniun me arsyetimin si më poshtë:

- informimi i prindërve mbi titullin e përkthyer jo korrekt, pasi nga anglishtja në shqip do të përkthehej “Botë e Çuditshme”, ndërsa nga ana e Kinema Millenium ishte përkthyer “Botë e Mrekullueshme”;
- informimi i prindërve dhe familjarëve të tyre mbi tematikën edhe përmbajtjen e filmit, pasi nuk ka patur asnjë informacion rreth kontentit të tij dhe prindërit kanë qenë të pa informuar.

A. G., në fjalën e tij theksoi se shfaqja e këtij filmi mund të cenonte shëndetin mendor, gjendjen emocionale dhe psikologjike të fëmijëve, duke ndikuar negativisht tek ata. Në këtë mënyrë personat LGBTI portretizoheshin si persona të cilët paraqisnin rrezik për këtë kategori të veçantë, siç janë fëmijët. Gjuha e përdorur nga A. G., ishte përcjellë në një kontekst të një debati i lindur si pasojë e shfaqjes së filmit “*Strange World*”. Si pasojë e këtij debati, nga pala ankuese ishin konstatuar kërcënime në rrjetet sociale, shprehje fyese dhe diskriminuese kundrejt anëtarëve të komunitetit LGBTI.

Komisioneri konstatoi se gjuha e përdorur nga shtetasi A. G., kishte nxitur komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “*Youtube*”, “*Facebook*” apo “*Tik Tok*”, komente të cilat ishin fyese, denigrues dhe në disa raste edhe ishin përdorur fjalë të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë përbënin thirrje për akte dhune. Duke qenë një avokat i njohur dhe mbrojtës i shumë kauzave në shoqëri, A. G., kishte aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Në mënyrë të veçantë rezultonte se A. G., ishte një person shumë aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij, ai mbarte detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhej të tregonte një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet e ndryshme.

Komisioneri gjykoi se nuk ishte e gabuar të informohej publiku dhe të diskutohej për tema sensitive që preknin grupe të ndryshme vulnerabël, por veshja dhe referimi i mendimeve apo perceptimeve personale, sidomos me konotacion negativ, në momentin që nuk disponohej ekspertiza e duhur dhe e nevojshme për tema specifike dhe nuk shërbenin për informim, përbënte një qëndrim të gabuar dhe krijonte premisa për paragjykime si dhe stereotipe negative. Në këtë kuptim, referimi i A. G., se *shfaqja e filmit, mund të cenojë shëndetin mendor, gjendjen e tij emocionale dhe psikologjike, duke ndikuar negativisht edhe pa e kuptuar tek fëmijët*, përbënte një qëndrim jo profesional, jo informues, paragjykues dhe nga ana tjetër krijonte negativitet kundrejt një grupi specifik shoqëror që janë personat LGBTI duke i shqetësuar ato dhe duke krijuar premisa për sjellje diskriminuese kundrejt tyre.

Komisioneri vlerësoi se, gjuha e përdorur nga A. G., krijonte në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja

urrejtje ndaj komunitetit LGBT. Edhe pse deklaratat e bëra nga A. G., nuk drejtoheshin kundër individëve të caktuar, anëtarët e komunitetit LGBTI, portretizoheshin dhe etiketoheshin si modele negative vetëm për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Këto deklarata edhe pse nuk ishin një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptoheshin si deklarata që nxisnin urrejtje.

Përfundimisht, Komisioneri arriti në përfundimin se, gjuha e përdorur nga A. G., përbënte gjuhë urrejtje kundër personave që i përkisnin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, ishin në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzonin mbrojtje nga legjislacioni i analizuar. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerësoi se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si pasojë e gjuhës së përdorur nga A. G., në takimin e mbajtur më datë 23.11.2022, transmetuar *live* në rrjetin social *Facebook*.
- Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar procedurën administrative për pjesën e ankesës që lidhet me pretendimet e ngritura kundër A. P., për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura apo qëllimi i saj, është bërë i pamundur.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, A. G., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, A. G., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masa për rishikimin e video-regjistrimit të publikuar nga ana e tij në rrjetet sociale, duke hequr prej tij shprehjet e konstatuara si diskriminuese në këtë vendim.

IV. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE

Qendra “Për Advokim Social”, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe
Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 266, DATË 28.12.2023

Shkaku: Gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces

VKM-ja Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, diskriminon fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, duke i vënë në kushte të pafavorshme për shkak të gjendjes ekonomike.

FAKTET

Këshilli i Ministrave për t’u ardhur në ndihmë dhe për t’u siguruar shërbimin arsimor fëmijëve që u përkasin familjeve në nevojë dhe me të ardhura të pakta dhe për të ulur nivelin e braktisjes shkollë, si dhe për të mbështetur financiarisht disa kategori sociale të nxënësve në nevojë për të kryer shërbimin e detyrueshëm arsimor, ka miratuar VKM-në Nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Referuar VKM-së, fëmijët që vijnë nga shtresa më e varfër, që janë familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë të përfshirë në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, ndërkohë që janë parashikuar dhe kategori të tjera, jashtë kriterit ekonomik që përfitojnë bursë për regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës. Midis këtyre kategorive rezulton një ndryshim, pasi për nxënësit që trajtohen sipas kriterit ekonomik, janë vënë kushte shtesë për përfitimin e bursës, ndërsa nxënësit e tjerë e përfitojnë për shkak të statusit të tyre. Në mes të tjerash në këtë vendim, shteti për të ulur nivelin e braktisjes shkollë, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare janë braktisës të shkollës, ka parashikuar trajtimin e këtyre nxënësve me bursë financiare, nga fondet e pushtetit qendror ose nga fondet e njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Sa më sipër, rezultoi se nxënësi sipas kriterit ekonomik, për të përfituar bursë, së pari duhet të ketë distancë nga vendbanimi dhe të akomodohet në konvikte publike, të braktisë shkollën dhe së dyti duhet të plotësojë kriterin ekonomik, që familja e tij/saj të jetë familje në nevojë/pamundësi financiare.

Në kuadër të shqyrtimit të një ankese të mëparshme, Komisioneri analizoi VKM-në Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke vlerësuar se fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me grupet e tjera si fëmijët me statusin e jetimit, ato me aftësi të kufizuara apo grupet e tjera që përfitojnë prej saj.

Në këtë kuadër, me vendimin Nr. 148, datë 22.07.2022, Komisioneri konstatoi diskriminimin e fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave. Komisioneri iu drejtua Këshillit të Ministrave për të marrë masa, për rishikimin e VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.

Lidhur me këtë, në zbatim të vendimmarrjes së Komisionerit, Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në nr. 511, datë 27.07.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*”, të ndryshuar, duke bërë përfitues në ndryshimet si më poshtë:

- Pika 2.1 “Kriteri ekonomik”, germa c) ndryshoi si vijon: *“... nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë ...”*.

Pavarësisht sa më sipër, u konstatua se nxënësit që vinin nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, janë përballur me të njëjtën situatë si përpara ndryshimeve të pësuara të VKM-së Nr. 666/2019.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës;
- GJEDNJ *Çështjet* Molla kundër Greqisë, Fábían kundër Hungarisë, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, *Çështja* Thlimmenos kundër Greqisë, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja* J. D., dhe A., kundër Mbretërisë së Bashkuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012, *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*;

- Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10289, datë 17.06.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- VKM Nr. 666, datë 10.10.2019, i Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”;
- VKM Nr. 866, datë 24.12.2019, ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020-2023;
- VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015, ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020;
- Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

KONKLUZIONE

Në analizë të informacionit të administruar, Komisioneri vërejt se pavarësisht ndryshimeve të bëra në vitin 2022, të pikës 2.1 c), në VKM-në Nr. 666/2019, ku parashikohej trajtimi me bursë i fëmijëve të familjeve në pamundësi ekonomike, sërish nuk dilte i qartë synimi i Këshillit të Ministrave, në zbatim të vendimit të Komisionerit, për trajtimin me bursë të kësaj kategorie për të përfutur si kategori më vete, pavarësisht nëse e braktis apo jo shkollën apo kanë distancë nga vendbanimi.

Në rastin konkret, ishin parashikuar si kategori të veçanta: nxënësit me statusin e jetimit; nxënësit që kanë humbur kujdestarinë ligjore; nxënësit me aftësi të kufizuara; nxënësit e personave që kanë statusin e invalidit; nxënësit që kanë humbur kujdesin prindëror; nxënësit, fëmijë të punonjësve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton; ndërsa fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, nuk ishin përcaktuar si kategori më vete.

Në vlerësim të Komisionerit, fëmijët e familjeve që trajtoheshin me ndihmë ekonomike, pavarësisht ndryshimeve të bëra në vitin 2022, të pikës 2.1 “c” në VKM-në Nr. 666/2019, ishin trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me grupet e tjera si fëmijët me statusin e jetimit, ato me aftësi të kufizuara apo grupet e tjera që përfitojnë nga kjo VKM, e ndryshuar. Në përmbajtje, ndryshimi i bërë në vitin 2022, në VKM-në Nr. 666/2019, nga ana e Këshillit të Ministrave, nuk

kishte sjellë asnjë risi në zbatimin e saj, duke mbetur sërish kufizuese dhe në të njëjtën logjikë me VKM-në e mëparshme Nr. 666/2019, për të cilën Komisioneri kërkoi rishikimin e saj.

Sakaq, VKM-ja e sipërcituar, evidentoi se nuk ishte e qartë dhe e kuptueshme nga organet të cilat vendosen përpara përgjegjësish për ta zbatuar atë. Duke qenë e paqartë, vendoste përpara vështirësisë institucionet/organet përgjegjëse në sjelljen që duhet të mbanin për zbatimin e saj.

Komisioneri vlerësoi se politika e mbështetjes me bursë e fëmijëve që braktisin shkollën, si me fondet e qeverisë qendrore ashtu dhe asaj vendore, nuk kishte rezultuar efikase dhe nuk kishte arritur qëllimin për të cilën është hartuar.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerësoi se, faktet dhe provat e administruara krijuan bindjen se, subjektet ankues, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, ishin vënë në pozita diskriminuese nga parashikimi i VKM-së Nr. 666/2019, të ndryshuar, si kategori në nevojë për shkak të gjendjes ekonomike, duke i vendosur kritere shtesë dhe duke mos parashikuar trajtimin me bursë, pavarësisht ndryshimeve të bëra në këtë VKM në vitin 2022.

Për rrjedhojë, Komisioneri arriti në përfundimin se MAS-i, si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të zhvillimit të sistemit arsimor, duhet të kishte marrë iniciativën, për përfshirjen e të gjithë nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, gjatë periudhës së ndjekjes së shkollës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të nxënësve A. A., O. G., A. G., B. T., K. , dhe A. , si fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve A. A., O. G., A. G., B. T., K. , dhe A. , nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar në vitin 2022, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.
- Për të shmangur situatën e krijuar në rastin konkret, rekomandohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë

procesit të hartimit të politikave gjithëpërfshirëse apo akteve ligjore/nënligjore, në mënyrë që ato të jenë të qarta dhe të zbatueshme nga institucionet përgjegjëse.

I. G. kundër Bashkisë Korçë dhe OSHEE sh.a.

VENDIM NR. 241, DATË 04.12.2023

Shkaku: Gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces

Ankuesja, e cila është e pastrehë për shkak të një investimi publik, është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, pasi nuk i është siguruar një strehim i përshtatshëm si pasojë e mungesës së energjisë elektrike në ambientin ku është strehuar si e pastrehë, nga ana e Bashkisë Korçë.

FAKTET

Ankuesja I. G., është e datëlindjes 16.08.1964 dhe banon në qytetin e Korçës. Ajo ka mbetur e pastrehë për shkak të investimeve me interes publike, të kryera nga ana e bashkisë. Si pasojë e zhvendosjes së ankueses dhe familjes së saj nga banesa për shkak të investimit me interes publik, Bashkia Korçë e ka strehuar ankuesen dhe familjen e saj në një objekt banimi të përkohshëm në Konviktin e Shkollës Bujqësore, kati 2, dhoma Nr. 2. Strehimi i ankueses në këtë ambientet është realizuar në datën 01.11.2016, në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Huapërdorjes. Ankuesja ka si burim të ardhurash pensionin e bashkëshortit, i cili ka ndërruar jetë, në masën 12953 lekë në muaj. Rezulton se ankuesja I. G., është e identifikuar nga Bashkia Korçë si familje në pamundësi ekonomike. Ajo është trajtuar me ndihmë ekonomike për periudhën nëntor 2018-gusht 2019 dhe më pas ka pasur një shpëputje nga skema. Ka aplikuar për t'u rifutur në skemën e ndihmës ekonomike, por është refuzuar nga sistemi.

Rezultoi e provuar se ankuesja në ambientin ku është strehuar nga Bashkia Korçë, nuk furnizohet me energji elektrike, që prej vitit 2018. Bashkisë Korçë edhe pse iu kërkua informacion në lidhje me situatën e furnizimit me energji elektrike të ankueses e cila është një banore e pastrehë, e cila është sistemuar nga bashkia në ambientin e Konviktin e Shkollës Bujqësore, nuk e kundërshtoi pretendimin e ankueses për mungesën e furnizimit me energji elektrike dhe nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me ndonjë masë të ndërmarre nga ana e Bashkisë për të siguruar furnizimin me energji elektrike të ankueses. Bashkia Korçë pretendoi se, strehimi i ankueses në ambientin e Konviktit të Shkollës Bujqësore është i përkohshëm.

Ankuesja, për shkak të pamundësisë ekonomike nuk ka mundur që ta transferojë matësin e energjisë elektrike nga ish banesa ku ka jetuar tek Hani i Gjelit për tek Konvikti i Shkollës Bujqësore ku ajo është strehuar pasi ka mbetur e pastrehë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollu 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 4 (1991) mbi të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe Nr. 7 (1997) mbi dëbimet e detyrueshme, të Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

KONKLUZIONE

Strehimi i përkohshëm nuk mund të zgjasë më shumë se dy vjet. Ankuesja I. G., nëse do të pranohet pretendimi i Bashkisë Korçë se është strehuar në mënyrë të përkohshme në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore në datën 01.11.2016, që prej këtij momenti kanë kaluar më shumë se dy vjet, dhe ankuesja duhet të kishte aplikuar në programet e tjera sociale të strehimit. Bashkia Korçë pretendoi, por nuk provoi se nga ana e saj ishin ezauruar të gjitha mundësitë dhe ankueses i është dhënë ndihmë dhe mbështetje efektive në mënyrë që ajo të përmirësonte gjendjen e strehimit për të përfituar nga programe të tjera në kuadër të strehimit social.

Megjithatë, në kushtet kur ankuesja ka vazhduar të jetojë në ambiente që vetë Bashkia Korçë i konsideron si një zgjidhje e përkohshme strehimi për personat e pastrehë, Bashkia Korçë nuk i ka siguruar ankueses një strehim të përshtatshëm, për shkak se ankueses i ka munguar furnizimi me energji elektrike. Pavarësisht faktit që godina ku është strehuar ankuesja mund të ofrojë akses ndaj furnizimit me energji elektrike, për shkak të pamundësisë financiare ankuesja e ka pasur të pamundur që të sigurojë një kontratë për furnizim me energji elektrike, për shkak të detyrimit të vendosur në aktin rregullator të ERE sipas të cilit të gjithë abonentët duhet të paguajnë në avancë tarifën për lidhje të re ose modifikimin e një lidhje ekzistuese.

Komisioneri vlerësoi se, ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm pasi nuk i është siguruar një strehim i përshtatshëm si pasojë e mungesës së energjisë elektrike, nga ana e Bashkisë Korçë.

Në rastin konkret, në pamje të parë Bashkia Korçë nuk e ka trajtuar ankuesen ndryshe apo në mënyrë më pak të favorshme se personat e tjerë të pastrehë të cilët janë strehuar në të njëjtat ambiente sikurse ankuesja. Ankuesja është në pamundësi financiare për shkak të gjendjes së saj ekonomike, për të bërë në avancë pagesën e kërkuar nga operatori i energjisë elektrike që do t'i mundësonte asaj furnizimin me energji elektrike në ambientin ku është strehuar nga ana e Bashkisë

Korçë. Në këtë mënyrë, gjendja ekonomike e ankueses e vendos atë në kushte të disfavorshme duke i pamundësuar furnizimin me energji elektrike, krahasimisht me personat e tjerë që nuk janë në pamundësi ekonomike.

Energjia elektrike është një komponent kryesor dhe thelbësor i strehimit të përshtatshëm, prandaj të jetosh në ditët e sotme pa energji elektrike e bën jetën e secilit të vështirë ose ekstremisht të pamundur. Qasja ndaj energjisë elektrike është një parakusht i pashmangshëm për një strehim të përshtatshëm dhe njëkohësisht është thelbësor për garantimin e të drejtave të tjera, duke siguruar gjithashtu uljen e varfërisë. Qasja në strehim të përshtatshëm mund të jetë parakusht për gëzimin e disa të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për punë, shëndetësi, arsim, sigurime shoqërore, të drejtën për të votuar dhe atë për jetën private dhe familjare.

E drejta për strehim të përshtatshëm, ku përfshihet e drejta për të pasur energji elektrike, është një e drejtë themelore e njeriut. Si e tillë, shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë akses në energji elektrike, e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e një strehimi të papërshtatshëm. Në rastin konkret, Bashkia Korçë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në fushën e kompetencës të të cilës përfshihen çështjet e strehimit social dhe si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është banore ankuesja I. G., ka detyrimin për të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të siguruar që ankuesja të gëzojë në mënyrë efektive kushte të përshtatshme strehimi, ku përfshihet edhe e drejta për t'u furnizuar me energji elektrike.

Të drejtat dhe liritë duhet të garantohen jo vetëm *de jure*, por edhe *de facto*, pra të sigurohet gëzimi në mënyrë efektive nga ana e personave. Strehimi i ankueses në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore pa siguruar që ankuesja të ketë furnizim me energji elektrike nuk mund të konsiderohet përmbushje efektive e të drejtës për të pasur një strehim të përshtatshëm. Komisioneri vlerëson se, është në detyrimin e njësisë së vetëqeverisjes vendose, në rastin konkret Bashkisë Korçë, që të sigurojë duke marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme që personat e pastrehë të strehuar nga ana e saj të jetojnë në kushte të përshtatshme, përfshi këtu furnizimin me energji elektrike.

Kushtet e strehimit të personave të pastrehë në banesën kolektive, sikurse është Konvikti i Shkollës Bujqësore, nuk është një problematikë e panjohur për Bashkinë Korçë. Rezulton se në këtë ambient janë strehuar familje të pastreha që i përkasin grupeve shoqërore vulnerabël, sikurse janë pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane. Gjithashtu, edhe Komisioneri ka trajtuar më parë problematika që lidhen me strehimin e personave të pastrehë që janë strehuar nga Bashkia Korçë në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore, dhe ka konstatuar se me anë të mosveprimeve, Bashkia Korçë ka sjellë trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë të banorëve të Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë për shkak të kushteve të papërshtatshme të strehimit në këtë ambient.

Për sa kohë që Bashkia Korçë nuk ka arritur të sigurojë përmirësimin e kushteve të strehimit të

ankueses duke e përfshirë atë në programe të tjera të strehimit social, ajo ka detyrimin që të sigurojë të gjitha kushtet e një strehimi të përshtatshëm në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore që i konsideron si zgjidhje e përkohshme. Bashkia Korçë, nuk arriti të tregojë se çfarë veprimesh konkrete kishte ndërmarrë për të përmirësuar situatën e strehimit të ankueses. Në kushtet kur, ankuesja për shkak të gjendjes ekonomike ka qenë në pamundësi financiare për të lidhur një kontratë për furnizimin me energji elektrike në ambientin ku është strehuar si e pastrehë nga ana e Bashkisë Korçë, kjo e fundit ka patur detyrimin që të marrë masa pozitive në mënyrë që t'i mundësonte ankueses akses në furnizimin me energji elektrike, me qëllim sigurimin e një strehimi të përshtatshëm.

Në bazë të fakteve dhe provave të administruara, Komisioneri vlerësoi se në mënyrë të pajustificuar dhe për një kohëzgjatje të konsiderueshme Bashkia Korçë nuk ka ndërmarrë asnjë përpjekje për të bërë të mundur që ankuesja të furnizohet me energji elektrike, në kushtet kur është në detyrimin e saj si njësi e vetëqeverisjes vendore që të jetë në dijeni të situatës së ankueses si person i pastrehë i strehuar në mënyrë të përkohshme nga ana e kësaj Bashkie.

Komisioneri vlerësoi se Bashkia Korçë dështoi që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë nuk ka ardhur si pasojë e gjendjes ekonomike të ankueses. Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesja I.G., është diskriminuar në të drejtën për strehim të përshtatshëm, në formën e diskriminimit të tërthortë, për shkak të gjendjes ekonomike, si rezultat i dështimit të Bashkisë Korçë për të marrë të marrë masa pozitive për të mundësuar furnizimin me energji elektrike të ankueses. Për rrjedhojë Bashkia Korçë, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, të parashikuar nga Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të ankueses I. G., në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë.
- Bashkia Korçë, duhet të marrë masa të menjëhershme për të mundësuar lidhjen e energjisë elektrike në ambientin ku ankuesja është strehuar, pranë Konviktit të Shkollës Bujqësore, Korçë.
- Bashkia Korçë duhet të marrë masa për të përcaktuar dhe rregulluar mënyrën se si duhet vepruar për kategorinë e personave të pastrehë që janë në të njëjtat kushte me ankuesen, të cilët për shkak të gjendjes së tyre ekonomike janë në pamundësi financiare për të siguruar furnizimin me energji elektrike.

V. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË

Shoqata “Për Drejtësi Sociale” kundër shtetasit S. N.

VENDIM NR. 199, DATË 11.10.2023

Shkaku: Gjinia
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Gjuha e përdorur nga shtetasi S. N., në emisionin “Më lër të flas”, transmetuar në datë 14.04.2023, në Televizionin Top-Channel, përbën diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të gjinisë.

FAKTET

Shtetasi S. N., ka qënë i ftuar në Top Channel, në emisionin “Më lër të flas” të datës 14.04.2023, i cili kishte si tematikë diskutimi tradhtinë.

Shoqata pretendon se në dialogun e mëposhtëm, është përdorur gjuhë urrejtjeje dhe denigruese e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë gratë:

“S. N.: - Sipas legjislacionit anglez, nuk mund ta akuzosh ti tjetrin për përdhunim në rast se nuk ke rezistuar ... Eshtë dhe “scherzo” e vajzës që bën sikur jo. Të akuzojnë X për përdhunim, në bazë të së drejtës penale angleze, ata matin sa e ke segmentin e rezistencës. Sepse vjen një moment i caktuar që femra ... pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet. ... E dini ju se çfarë thotë ligji anglo-sakson? Ata kur dënojnë një person që përdhunon një vajzë, grua apo zonjë, marrin parasysht rezistencën e saj. A i ka rezistuar ajo ndaj kësaj tentative apo jo. E dini pse? Sepse gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.”

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO/Inf(2017)13 Miratuar më 12 Tetor 2017³;

³ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-GREVIO.pdf>

- Rekomandimi CM/Rec (2013), miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare “*Mbi barazinë gjinore dhe median*”;
- Rekomandimi CM/Rec (2019), miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, më datë 27 mars 2019 “*Parandalimi dhe luftimi i seksizmit*”;
- Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132);
- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”, miratuar më 8 Dhjetor 2015;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” i ndryshuar;
- Progres Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2021, publikuar në 19 tetor 2021;
- Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 31.05.2023⁴;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021 “*Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, dhe të Planit të saj të Veprimit*”.

KONKLUZIONE

Shprehjet e përdorura, në emisionin “*Më lër të flas*”, të datës 14.04.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, nga shtetasi S. N., paraqesin rëndësi të veçantë, pasi janë përdorur në një televizion privat kombëtar si Top-Channel, në një orar dhe në kushtet kur shikueshmëria e këtij emisioni nga publiku është e konsiderueshme.

Gjuha e përdorur nga S. N., është përcjellë në një kontekst të një debati të lindur si pasojë e diskutimit të një tematike krejtësisht tjetër, atë të tradhtisë në çift. Si pasojë e këtij debati, nga pala ankuese janë konstatuar në rrjetet sociale, komente e shprehje fyese dhe diskriminuese kundrejt grave/vajzave. Komisioneri ka konstatuar se gjuha e përdorur ka nxitur komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “*Youtube*”, “*Facebook*”, etj, komente të cilat janë fyese, paragjyquese, denigruese dhe krejtësisht të papërshtatshme.

Komisioneri gjykoj se, ilustrimi i përdorur nga S. N., lidhur me faktin se *si* dhe *kur* konsiderohet se ka ndodhur një akt përdhunimi, sipas të drejtës anglo-saksone (*duke cituar edhe autorin J.Herring*), pa kontestuar vërtetësinë apo jo të kësaj reference, është përdorur për të shtjelluar mendimin e tij gjatë bisedës me të ftuarit e tjerë dhe prezantuesit e emisionit në fjalë.

Në këtë kontekst, Komisioneri evidentoi se, deklarata të tilla të bëra nga një avokat e ekspert i njohur i legjislacionit në Shqipëri, siç është S. N., mund të keqinformojnë e krijojnë bindje të gabuara tek publiku që i ndjek lidhur me perceptimin e konceptin e përdhunimit në vetvete, duke

⁴ Faqe 13 e Raportit, përkthim i Komisionerit: <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>

prezumuar se, një femër që i nënshtrohet një akti të tillë të rëndë si përdhunimi, nëse nuk arrin të provojë rezistencën e madhe fizike kundrejt personit që kryen aktin, e pranon atë dhe në një farë mënyre konsiderohet fajtores se nuk ka bërë një rezistencë të madhe fizike (*gjë e cila nuk ka një masë matëse*), ose në rastin më të keq, prezumon se e ka dashur dhe pranuar një akt të tillë.

Në këtë kuptim, Komisioneri vlerësoi se, referimi e citimi i S. N., se, *vjen një moment i caktuar që pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet ... gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhuhohen dhe më pas dorëzohen*, përbën një qëndrim jo profesional, jo informues, paragjykes dhe nga ana tjetër krijon negativitet kundrejt grave e vajzave në përgjithësi, e në veçanti kundrejt asaj kategorie që mund të jenë viktimat të përdhunimit, duke i shqetësuar ato dhe duke krijuar premisa për sjellje diskriminuese kundrejt tyre.

Gjuha e përdorur dhe qëndrimi i S. N., për sa më sipër, pa u sqaruar, distancuar, shpjeguar në moment ose dhe më vonë prej tij, edhe pse nuk është një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohet si qëndrim a gjuhë që nxit urrejtje, apo paragjykim të grave e vajzave.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerësoi se përdorimi i shprehjeve të gjuhës seksiste dhe denigruese për shkak gjinie, ndaj grave/vajzave, nuk e justifikon moskërkimin e një ndjese publike apo shpjegimit të faktit nëse ai ka qenë i keqkuptuar në deklaratimet e tij, duke qartësuar qëndrimin e tij lidhur me sa është perceptuar në publik. Në këtë kuptim, përdorimi i saj referuar grave/vajzave, i ka vënë ato në pozita diskriminuese për shkak të gjinisë, në formën e gjuhës së urrejtjes. Komisioneri theksoi faktin se përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, stimulon veprime fyese, denigruese, kërcënuese dhe urrejtje ndaj grave/vajzave, aq më tepër kur përdoret në hapësira mediatike nga persona që bëjnë pjesë në jetën publike dhe kanë një numër të madh audience.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara, Komisioneri arriti në përfundimin se, gjuha e përdorur nga S. N., përbën gjuhë urrejtje, për shkak të gjinisë, mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojnë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsytet e mësipërme, Komisioneri vlerësoi se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi hapat e ndërmarrë nga ana e Televizionit Top-Channel për heqjen e videos nga të gjitha kanalet e tyre zyrtare dhe jo zyrtare, bashkëpunimin e treguar dhe distancimin nga gjuha e përdorur nga ana e S. N.

VENDIMI

- Gjuha e përdorur nga S. N., transmetuar në emisionin “*Më lër të flas*”, të datës 14.04.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, përbën diskriminim, në formën e “*gjuhës së urrejtjes*”, për shkak të gjinisë.
- Në referim të pikës 3, të këtij vendimi, S. N., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëj një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtje dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.

VI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQËRORE

A. A., kundër Përgjegjësit të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZV ASHK) Tropojë

VENDIM NR. 252, Datë 13.12.2023

Shkaku: Gjendja shoqërore

Forma: Diskriminim në formën e shqetësimit

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është diskriminuar nga ana e Përgjegjësit të ZV ASHK Tropojë, krahasuar me kolegët e Zyrës, duke mos e zënë me punë, për shkak të gjendjes së saj shoqërore, si person kundrejt së cilës kishte patur një çështje penale në hetim.

FAKTET

Subjekti ankues, me detyrë juriste në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZV ASHK) Tropojë, pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DV ASHK) Kukës, pretendon se gjatë marrëdhënieve të punës, Përgjegjësi i Zyrës së ASHK Tropojë e ka diskriminuar duke e mbajtur të pazënë me punë.

Ankuesja, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, është shprehur se, që në ditën e parë që është kthyer në këtë institucion, pas heqjes së pezullimit të saj për shkak se kishte qenë person nën hetim në kuadër të një çështjeje penale në ngarkim të saj, Përgjegjësi i ZV ASHK Tropojë, e ka mbajtur larg çdo pune që lidhet me profesionin e juristit. Ankuesja pretendon se ndihet e diskriminuar pasi megjithëse ka pothuajse pesë vite në këtë institucion, tani gjendet para faktit që nuk angazhohet me asnjë punë dhe nuk përmbush detyrat e saj funksionale, të përcaktuara në kontratën individuale të punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e punëdhënësit, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se nga ana e personit përgjegjës për ngarkimin e saj me punë e detyra konkrete, eprorit të saj direkt, Përgjegjësit të ZV ASHK Tropojë, nuk u sollën prova dhe argumente bindës që të mund të provonin apo përligjinin faktin se ankueses si punonjëse e kësaj Zyre, në detyrën e juristes, i ishte ngarkuar ndonjë detyrë a punë për t’u realizuar që nga momenti i fillimit të marrëdhënies së saj të punës me ASHK, në detyrën e specialistes/juristes në ZV ASHK Tropojë.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, Përgjegjësi i ZV ASHK Tropojë, në cilësinë e eprorit direkt të ankueses dhe autoritetit përgjegjës për ngarkimin e detyrave të punonjësve të kësaj Zyre, për pasojë edhe të ankueses, si juriste e kësaj Zyre, nuk ka provuar se:

- Lidhur me periudhën e pretenduar: shkurt 2023 - mars 2023, nuk ka funksionuar sistemi multifunksional me të cilin operonin punonjësit e ZV ASHK Tropojë, e për rrjedhojë dhe *e-maili* e “*useri*” i ankueses, për sa kohë ka qenë jofunksional dhe kur është bërë efektivisht funksional;
- Ankuesja gjatë kësaj periudhe (shkurt - mars 2023) është ngarkuar me detyra të tjera, nga Përgjegjësi i ZV ASHK Tropojë;
- Nuk u sollën prova, fakte a dokumente që ai të faktonte në ndonjë mënyrë që kishte ngarkuar e zënë me punë ankuesen, se cilat ishin detyrat e ngarkuara prej tij dhe se cilat e si ishin përmbushur ato nga ankuesja, për periudhën në vijim, prill 2023 – maj 2023, duke penguar ankuesen dhe në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të punës.

Për më tepër, Komisioneri evidentoi se, nga ana e Përgjegjësit të ZV ASHK Tropojë, në mënyrë të gabuar cilësohet se periudha e punësimit të saj është nga 15.02.2023 deri në datën 04.04.2023, datë kur është bërë propozimi për largimin nga puna.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri theksoi se, Përgjegjësi i ZV ASHK Tropojë *nuk mund e nuk duhet* të hamendësonte e paragjykonte se si do të vijonte më tej nga organet e tij eprorë procedura e propozimit të masës ekstreme prej tij, dhe për më tepër, duke marrë të mirëqenë faktin se periudha e propozimit të masës disiplinore kundrejt ankueses nënkuptonte se ajo nuk ishte më në marrëdhënie pune. Pra, haptazi është keqzbatuar kompetenca e Përgjegjësit të Zyrës duke mos e zënë me punë ankuesen me arsyetimin se meqë ishte propozuar prej tij masa disiplinore, ajo nuk duhej zënë me punë.

Komisioneri gjykoi gjithashtu se, Përgjegjësi i ZV ASHK Tropojë, ka paragjykuar punonjësen e tij, specialisten A. A., duke theksuar se: *“Ankuesja e cila ka iniciuar procedurën e ankimimit për diskriminim është një punonjëse dhe ish-drejtuese nën hetim për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Falsifikimit të dokumenteve”, “Kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik”, “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, etj.”* Në këtë kontekst, Përgjegjësi i ZV ASHK Tropojë, me veprime konkludente ka dëshmuar se pikërisht se për këtë shkak ai nuk ka zënë me punë ankuesen, duke paragjykuar se ajo ishte person nën hetim nga organet përkatëse, dhe ky fakt provohet që nga momenti i fillimit punë të saj si specialiste/juriste, pranë ZV ASHK Tropojë e gjatë gjithë periudhës objekt shqyrtimi pranë KMD-së, duke cenuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri, gjykoi se, veprimet e sjellja e eprorit direkt/Përgjegjësit të ZV ASHK Tropojë (moszënia me punë e ankueses), duke mos gjetur edhe mbështetje e argument ligjor, haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga gjendja shoqërore e saj, fakti që ka qenë person nën hetim nga organet përgjegjëse, dhe se asaj i është cenuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta e ushtrimit të detyrës dhe profesionit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, në formën e shqetësimit, të subjektit ankues, A. A., në të drejtën për punësim, nga ana e Përgjegjësit të ZV ASHK Tropojë, për shkak të gjendjes shoqërore të saj.

VII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz

VENDIM NR. 6, DATË 18.01.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë në Pallatin e Kulturës, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, duke i diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Fondacioni “Së bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë, diskriminon personat me aftësi të kufizuar në Pallatin e Kulturës, në Bashkinë Kamëz.

Pallati i Kulturës, në Bashkinë Kamëz është ndërtuar në vitin 2010, ndërsa ofrimi i shërbimeve në këto ambiente është realizuar në vitin 2012. Në katin e parë të godinës zhvillohen të gjitha aktivitetet e Pallatit të Kulturës, ndërsa në katin e dytë të kësaj godinë ndodhet biblioteka. Rezulton se godina e Pallatit të Kulturës, nuk është e pajisur me ashensor ose ndonjë mekanizëm tjetër për të bërë të mundur aksesimin e bibliotekës, e cila ndodhet në katin e dytë të saj, nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Bashkia Kamëz, deklaroi se do të merrte masa për të zhvendosur bibliotekën në katin e parë të godinës së Pallatit të Kulturës, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që ajo të aksesohet nga personat me aftësi të kufizuar. Pala ankuese e prapësoi këtë qëndrim të mbajtur nga bashkia Kamëz, se zhvendosja e bibliotekës në katin e parë të godinës së Pallatit të Kulturës do të eliminonte pengesat dhe do të bënte të mundur aksesin e personave me aftësi të kufizuar, pasi rampa pavarësisht se ekziston, nuk mund të përdoret nga personat me aftësi të kufizuar për shkak të mungesës së standardeve të duhura teknike. Hyrja e Pallatit të Kulturës rezultoi të ishte e pajisur me rampë, por sipas pamjeve fotografike ku tregohet hyrja në godinën e Pallatit të Kulturës, rezulton se rampa e vendosur në ambientet e jashtme, në hyrje të ndërtesës, nuk është e rrethuar dhe nuk ka doreza mbajtëse. Bashkia Kamëz deklaroi se kishte në plan marrjen e masave për të rregulluar rampën ekzistuese.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), *mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*.

KONKLUZIONE

Referuar parashikimeve të bëra në VKM Nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushin ndërtesat ku kryhen aktivitete kulturore, sikurse është në rastin objekt shqyrtimi ndërtesa e Pallatit të Kulturës, në Bashkinë Kamëz, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht qëndrimit dhe gatishmërisë së treguar nga Bashkia Kamëz për të zhvendosur ambientet e bibliotekës në katin e parë të ndërtesës, ajo nuk arriti të tregojë se kishte hartuar një plan masash, me afate konkrete dhe burime financiare të përcaktuara, se kur do të realizohej zhvendosja e bibliotekës në katin e parë. Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi gjithashtu e provuar se, rampa, e cila ekziston në hyrje të ndërtesës së Pallatit të Kulturës, nuk është brenda standardeve dhe kushteve teknike të kërkuara nga VKM Nr. 1503/2008 fakt ky që u pranua edhe nga Bashkia Kamëz, e cila deklaroi se parashikonte marrjen e masave për rregullimin dhe sjelljen e rampës ekzistuese brenda standardeve. Megjithatë, Bashkia Kamëz, sikurse në rastin e zhvendosjes së bibliotekës në ambientet e katit të parë të godinës së Pallatit të Kulturës, nuk arriti të tregojë përpara Komisionerit se kishte marrë masa konkrete për hartimin e një plani masash, me afate konkrete dhe burime financiare të përcaktuara, për të sjellë rampën ekzistuese në përputhje me kriteret teknike të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi. Në këto kushte edhe angazhimi i Bashkisë

Kamëz, për të zhvendosur bibliotekën në katin e parë, është një masë joefektive, pasi në kushtet kur rampa ekzistuese është jashtë kriterëve teknike të kërkuara ajo është e papërdorshme nga ana e personave me aftësi të kufizuar dhe nuk garanton aksesin e tyre në godinën e Pallatit të Kulturës dhe përdorimin jo vetëm të bibliotekës por edhe të aktiviteteve dhe shërbimeve të tjera kulturore që ofrohen në Pallatin e kulturës.

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuar, edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe (edhe pse në rastin konkret nuk është në përputhje me standardet e kërkuara), nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se, ndërtesa e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kamëz nuk është e aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar në shikim, pasi mungojnë vijat me relief për të orientuar këta persona.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM Nr. 1503/2008. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në arsim në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukurore në ndërtesën e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kamëz, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t'ju mohohet aksesin në këtë ndërtesë ku zhvillohen aktivitete kulturore. Është në përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore që të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesave ku zhvillohen aktivitete kulturore, bibliotekat apo ambienteve për lexim. Rrjedhimisht, Komisioneri vlerësoi se, është në përgjegjësinë e Bashkisë Kamëz, si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është administruimi i Pallatit të Kulturës, të sigurojë aksesueshmërinë e kësaj ndërtese.

Komisioneri arriti në përfundimin se, ndërtesa e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kamëz, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, e për rrjedhojë Bashkia Kamëz nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerësoi se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuar.

Pallati i Kulturës është ndërtuar në vitin 2010 dhe është vënë në funksionim në vitin 2012. Pra, pavarësisht se standardet e aksesueshmërisë për ndërtesat ku zhvillohen aktivitete kulturore dhe bibliotekat ekzistojnë që prej vitit 2008, Bashkia Kamëz e cila ka ndërtuar godinën e Pallatit të Kulturës në vitin 2010, nuk i ka përmbushur këto standarde, duke dështuar që të sigurojë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar.

Bashkia Kamëz, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me masat konkrete afatshkurtra me afatet kohore dhe fondet, për të rikonstruktuar rampën ekzistuese në ndërtesën e Pallatit të Kulturës, në përputhje me standardet dhe kriteret teknike në fuqi. Bashkia Kamëz, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me hartimin e një plani veprimi, me afate kohore dhe fonde të përcaktuara, për eliminimin e barrierave infrastrukturore/artitektonike dhe sigurimin e standardeve dhe kriterëve teknike të aksesueshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë ndërtesën e Pallatit të Kulturës, e në mënyrë të posaçme, por jo vetëm, për të siguruar aksesin për në katet e sipërme të ndërtesës, pajisjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme me shiritat orientues për personat që nuk shikojnë dhe pajisjen e ndërtesës me një plan orientues për lëvizje në ndërtesa. Bashkia Kamëz, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me evidentimin e objekteve ekzistues në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë. Komisioneri vlerëson se, nga ana e Bashkisë Kamëz nuk janë marrë masa për të punuar drejt realizimit gradual të aksesit universal, brenda kufijve të buxhetit në dispozicion. Komisioneri konstaton se, Bashkia Kamëz, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave infrastrukturore/arkitektonike dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar në Pallatin e Kulturës.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Pallatin e Kulturës, në Bashkinë Kamëz, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Kamëz nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë ndërtesë ku zhvillohen aktivitete kulturore dhe është e vendosur biblioteka. Komisioneri arriti në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuar dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuar si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë së ndërtesën e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kamëz, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë Kamëz, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në Pallatit të Kulturës, Bashkia Kamëz.
- Bashkia Kamëz, duhet të marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në Pallatin e Kulturës, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.
- Bashkia Kamëz, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuar. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

A. G. kundër Kompanisë “Chicken Farm Albania” sh.p.k

VENDIM NR. 9, DATË 18.01.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Vendimi i pa ankimuar

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Chicken Farm Albania sh.p.k”. Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune pranë subjektit privat, Shoqërisë “Chicken Farm Albania” sh.p.k., nga data 01.11.2018 deri më datë 29.04.2022, me detyrë “shofer”.

Ankuesi nuk ka patur asnjë masë disiplinore apo vërejtje për mosrealizim detyrash apo ndonjë shkelje tjetër nga ana e punëdhënësit, deri në momentin e largimit nga puna. Sjelljet diskriminuese kundrejt tij e kanë motivin tek aftësia e kufizuar, pasi procedura për largimin nga puna është iniciuar mbi një motivacion të paprovuar nga ana e punëdhënësit, si dhe në shkelje të procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, konform legjislacionit që rregullon këtë marrëdhënie kontraktuale.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Plani Kombëtar i Veprimtimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025⁵.

⁵ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 276, datë 12. 05.2021 dhe botuar në Fletore Zyrtare Nr. 75, datë 20.05.2021.

KONKLUZIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtrimeve të palëve, Komisioneri vlerësoi se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, punëdhënësi, nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së kontratës së punës. Kompania nuk arriti të provojë para Komisionerit se, kishte zhvilluar një takim paraprak me ankuesin, në të cilin ta kishte njohur me arsyen dhe motivin mbi të cilin bazohej zgjidhja e marrëdhënies të punës me të, apo që t'i kishte krijuar mundësinë këtij të fundit të dëgjohej dhe të mbronte interesat e tij të ligjshëm.

Komisioneri vlerësoi se, shkaqet e shtuara në shpjegimet e sjella para Komisionerit nga ana e punëdhënësit, nuk janë cituar në asnjë nga shkresat në procedurën e ndjekur prej tij, për largimin e ankuesit nga puna. Ato janë shtuar si argumente shtesë gjatë prapësimeve para Komisionerit, për rrjedhojë nuk mund të kenë shërbyer si shkak për largimin e tij nga puna. Komisioneri vëren se, Shoqëria, nuk arriti të provojë para KMD-së, se:

- Ankuesi kishte shkelur ndonjë nen të Kontratës Individuale të punës;
- Ankuesi kishte sjellë dëm të rëndë financiar kundrejt punëdhënësit dhe për më tepër, me dashje të tij;
- Ankuesi kishte konsumuar mospërbushje të detyrave funksionale apo të kishte shpërdoruar pasurinë e Shoqërisë;
- Ajo kishte zbatuar procedurën ligjore lidhur me njoftimin e zgjidhjes së marrëdhënies të punës me ankuesin;
- Masa për largimin e ankuesit nga puna të ishte e justifikuar, e bazuar në fakte e prova si dhe të ishte proporcionale në raport me shkeljen e pretenduar;
- Shoqëria kishte marrë masat që të zbatonte ligjin për mbrojtjen efektive që duhet të kishte ankuesi/ punëmarrës si pjesë e kategorisë së mbrojtur, PAK, (në zbatim të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, ligj i cili ishte i aplikueshëm dhe i detyrueshëm për zbatim në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies të punës me ankuesin nga ana e Shoqërisë) me invaliditet të pjesshëm, fakt të cilin ato vetë e kishin njohur dhe pranuar si të tillë deri në momentin e largimit të tij nga puna.

Në përfundim të analizimit të veprimeve të ndërmarra nga ana e punëdhënësit kundrejt ankuesit, si dhe të legjislacionit përkatës që normon marrëdhëniet e punës mes palëve, Komisioneri konstatoi se Kompania, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim, pasi largimi i tij nga detyra, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive apo të ishte proporcional në raport me shkeljen e prezumuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, B. G., në të drejtën për punësim, nga ana e Shoqërisë “*Chicken Farm Albania*” sh.p.k., për shkak të aftësisë së kufizuar të tij.

S. C. kundër Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 1, Tiranë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

VENDIM NR. 14, DATË 24.01.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka kërkuar që të ndjekë një nga programet e formimit profesional, por godina nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke e diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Subjekti ankues është person me aftësi të kufizuara fizike e cila kërkon të ndjekë një kurs profesional, për të mundësuar punësimin e saj në të ardhmen. Ankuesja është paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 1, për të ndjekur një kurs kompjuteri, që zhvillohej në ambientet e kësaj drejtorie dhe i është parashtruar që meqenëse kursi zhvillohet në katin e dytë, ajo nuk mund ta ndiqte atë, pasi godina nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025;

- Udhëzimi Nr. 14, datë 27.05.2021 të MFE “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.

KONKLUZIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtrimeve të palëve, rezultoi e provuar se, godina e DROFPP Nr. 1, Tiranë nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, pasi:

- Rampa nuk plotëson standardet e kërkuara në pikën 2.11 të nenit 8 të VKM Nr. 1503/2008.
- Pjesa hyrëse dhe korridoret e godinës nuk plotësojnë kërkesat e nenit 3, pikat 19, 20, 21 dhe 22 të VKM Nr. 1503/2008 (*përpunimi relievor, vija relievore drejtuese, vija relievore paralajmëruese, fusha relievore paralajmëruese*).
- Parkimi i dedikuar për personat me aftësi të kufizuara nuk ka sinjalistikën horizontale dhe vertikale të domosdoshme për plotësimin e standardeve të kërkuara në pikën 3.3 të nenit 8, të pjesës së dytë të rregullores.

Objekt i ankesës në shqyrtim është godina e DROFPP Nr. 1, Tiranë, e cila është pjesë e sistemit të arsimit dhe formimit profesional dhe është një godinë në juridiksionin e MFE-së dhe në menaxhimin e AKPA-së. Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, është në përgjegjësinë e MFE-së dhe AKPA-së, si ministria dhe agjencia përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional në juridiksionin e të cilës është godina e DROFPP Nr. 1, Tiranë, të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesës.

AKPA nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë në qendrat e formimit profesional në varësi të saj. Rezulton se, MFE dhe AKPA nuk kanë marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë në godinën e DROFPP Nr. 1, Tiranë, në juridiksionin e saj për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se, nga ana e MFE dhe AKPA nuk ka shprehje vullneti, për të punuar drejt realizimit gradual të aksesit universal, brenda kufijve të buxhetit në dispozicion.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në godinën e DROFPP Nr. 1, Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për ankuesen, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se MFE dhe AKPA nuk arritën të provojnë se kanë marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i saj, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të S. C., nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të marrin masa për të siguruar në mënyrë të përshtetshme aksesueshmërinë në godinën e DROFPP Nr. 1, Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të marrin masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve, në të cilat ofrohet formimi profesional, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 31, DATË 27. 02.2023

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, ka vënë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar personat me aftësi të kufizuar.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj.*)

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtroi se nga inspektimi në terren, kanë konstatuar disa problematika për garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga Bashkia Tiranë, për mosgarantimin e aksesueshmërisë në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Tiranë, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me masat konkrete, afatet kohore dhe fondet, (*apo hartimin e një plani konkret të mirëfilltë*) për të rikonsideruar ndërhyrjen a përmirësimin e situatës teknike, në ishullin e semaforin ekzistues në kalimin e këmbësorëve në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtuquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, në përputhje me standardet dhe kriteret teknike në fuqi. Komisioneri vlerësoi se, nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa për të punuar drejt realizimit gradual dhe as të menjëhershëm, të përmbushjes së standardeve të kërkuara të aksesueshmërisë.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstatoi se, Bashkia Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave infrastrukturore/arkitektonike dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në ishullin e këmbësorëve dhe semaforin e tij, në vendndodhjen e ashtuquajtur si “Kupola” Tiranë.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në ishullin e semaforin ekzistues në kalimin e këmbësorëve në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtuquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Tiranë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Në këto kushte, Komisioneri arriti në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë së ishullit e semaforit ekzistues në kalimin e këmbësorëve në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtuquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Tiranë nuk ka marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në ishullin e semaforin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtuquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë së Tiranës, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ishullin e semaforin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtuquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.
- Bashkia e Tiranës, të marrë masa konkrete për të siguruar në mënyrë efektive, aksesueshmërinë në ishullin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtuquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz

VENDIM NR. 32, DATË 27.02.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mungesa e vendparkimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kamëz, vendos ata në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin Nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, Fondacioni ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjektit ankues i është mohuar trajtimi i barabartë dhe është diskriminuar lidhur me mungesën e garantimit të vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, në territorin e Bashkisë Kamëz, duke krijuar kështu vështirësi për personat me aftësi të kufizuara për të dalë dhe për të marrë shërbime në të gjithë këtë bashki.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;

- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Kamëz, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me garantimin e parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuar.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, parkimi pranë godinës së Bashkisë Kamëz, nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, pasi:

- Parkimi i dedikuar për personat me aftësi të kufizuar nuk ka sinjalistikën horizontale dhe vertikale të domosdoshme për plotësimin e standardeve të kërkuara në pikën 3.3 të nenit 8, të pjesës së dytë të rregullores teknike sipas VKM Nr. 1503/2008.
- Shenja e parkingut të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, nuk është sipas figurës 3, shenja 1.25, të shtojcës A, të rregullores teknike sipas VKM Nr. 1503/2008.

Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri konstatoi se, Bashkia Kamëz, në mënyrë të pajustificuar, nuk kishte ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Bashkia Kamëz nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me sigurimin e parkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Bashkisë Kamëz, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër

personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Kamëz dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kamëz. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kamëz, në lidhje me garantimin e parkimeve të personave me aftësi të kufizuara në territorin e bashkisë.
- Bashkia Kamëz, të marrë masa për plotësimin e të gjitha standardeve të parkimeve ekzistuese, në përputhje me standardet ligjore në fuqi për personat me aftësi të kufizuara.
- Bashkia Kamëz të marrë masa për hartimin e një plani të detajuar për parkimet publike për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për sigurimin e parkimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.

Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a., (Zyra Postare Tirana 21)

VENDIM NR. 42, DATË 27.03.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë dhe në formën e rëndë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Gjobë për moszbatim vendimi

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a në Zyrën Postare Tirana 21, duke i diskriminuar ato për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Fondacioni “Së bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare Tirana 21, në Bashkinë Tiranë, një ambient ku ofron shërbimet e saj Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, diskriminon personat me aftësi të kufizuar.

Rezultoi se në hyrje të Zyrës Postare Tirana 21, ka shkallë dhe nuk janë vendosur instrumente për të bërë të mundur eliminimin e pengesës që paraqesin shkallët për personat me aftësi të kufizuar që janë përdorues të karrocës me rrota apo që kanë vështirësi në lëvizje dhe mungojnë shiritat orientues për personat që nuk shikojnë.

Posta Shqiptare sh.a. nuk dha asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e kritereve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë të parashikuara nga VKM Nr. 1503/2008 apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUZIONE

Rezultoi e provuar se, ndërtesa ku ofrohen shërbimet nga Zyra Postare Tirana 21, ka në hyrje të saj shkallë, të cilat përbëjnë pengesa infrastrukturore dhe nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuara në lëvizje të cilët janë përdorues të karriges me rrota që të hyjnë në ndërtesë dhe të marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Ndërtesa ku ofrohen shërbimet nuk është e pajisur me rampë, që është një nga elementët e parashikuar për eliminimin e pengesave ose barrierave. Shkallët dhe mungesa e rampës, përbëjnë një burim vështirësie për lëvizjen e të gjithë atyre personave që kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar. Posta Shqiptare sh.a., nuk dha asnjë informacion në lidhje me plotësimin e standardeve teknike të detyrueshme për zbatim për ndërtesat që ofrojnë shërbime të postë telekomunikacionit, sikurse ato që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM Nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Tirana 21. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në ndërtesën ku ofrohen shërbimet nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Tirana 21, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesimi për të marrë shërbimet e ofruara.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa ku ushtron veprimtarinë Zyra Postare Tirana 21, pjesë e rrjetit të Postës Shqiptare sh.a., nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Posta Shqiptare sh.a., nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, në ofrimin e shërbimeve prej saj. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë

dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Tirana 21.

Nëpërmjet disa vendim-marrjeve të tij, Komisioneri ka konstatuar mungesën e aksesueshmërisë në disa zyra postare ku ushtron veprimtarinë e saj Postën Shqiptare sh.a., dhe ka kërkuar nga ky subjekt hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë. Komisioneri evidenton se, Posta Shqiptare sh.a., nuk ka marrë asnjë masë në drejtim të sigurimit të aksesueshmërisë.

Komisioneri konstaton se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Tirana 21, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në këtë zyrë postare. Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a., dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Tirana 21. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Komisioneri konstatoi se:

- Posta Shqiptare sh.a., ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a., më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a., ushtron aktivitetin e saj (Zyra Postare Qendër Shkodër, Zyra Postare Qendër Durrës, Zyra Postare Hardhisht, Zyra Postare Sukth, Zyra Postare Qendër Shijak, Zyra Postare Ishëm, Zyra Postare Kamëz).
- Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë

kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a, nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM Nr. 1503/2008, miratimin e VKM Nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe disa vendimmarrjeve të Komisionerit, ku Posta Shqiptare sh.a., është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet aksesueshmëria.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, ndaj personave me aftësi të kufizuara është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a., pasi përmbushen parashikimet e në nenin 3/1 të LMD-së.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Tirana 21.
- Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:
 - a. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Tirana 21, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
 - b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
 - c. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

M. SH. kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.

VENDIM NR. 66, DATË 27.04.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik të Bashkisë Kamëz për M.SH, person me aftësi të kufizuara, ka sjellë diskriminimin e tij për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Ankuesi ka udhëtuar me autobusin e linjës urbane Tiranë-Paskuqan. Pas nisjes së autobusit fatorino i ka kërkuar të bëjë pagesën e biletës duke mos i njohur librezën e verbërisë. Pas debatit të zhvilluar mes tij dhe fatorinos është detyruar të bëjë pagesën e biletës. Gjithashtu, ankuesi ka udhëtuar me autobusin e Shoqërisë së Transportit “Shpresa AL”, nga Terminali i Autobusëve, në drejtim të stacionit pranë Institutit Bujqësor. Sërish ka ndodhur e njëjta situatë, ku është detyruar të paguaj biletën, duke mos iu njohur librezë e verbërisë së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

- Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Nga informacioni i administruar nga Komisioneri në kuadër të ankesave të mëparshme me të njëjtin objekt, kundër Bashkisë Kamëz, Bashkia ka qenë në dijeni të situatës së krijuar ndërmjet operatorit të transportit publik Shpresa AL dhe kategorive të personave që përfitojnë udhëtimin pa pagesë në territorin e saj, në përgjithësi dhe specifikisht edhe të rastit konkret me shtetasin M. SH. (për problematikën e të cilit është vënë në dijeni nga Komisioneri shkresërisht). Pavarësisht kësaj, nuk rezultoi të kishte pasur përpjekje nga ana e Bashkisë për verifikimin e problematikës me ankuesit, apo rregullimin përfundimtar të situatës, duke i mohuar të drejtën për të përfituar lehtësira në udhëtim, si dhe duke shkelur njëherësh edhe detyrimet e saj kontraktuale me shoqërinë e transportit.

Në përfundim, Komisioneri gjykoi se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Bashkia Kamëz kishte ekspozuar subjektin ankues, M. SH., i cili bën pjesë në kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit urban qytetas pa pagesë.

Nisur nga analizimi i detyrimeve kontraktuale, të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve Bashkia Kamëz dhe Shoqëria Shpresa AL, Komisioneri vlerësoi se, detyrimi për të ofruar falas shërbimin urban qytetës për kategorinë e personave të verbër nga ana e Shoqërisë Shpresa AL ishte i kushtëzuar nga përmbushja e detyrimit të Bashkisë për ta subvencionuar atë.

Përsa kohë Bashkia nuk kishte zbatuar detyrimin e saj për të subvencionuar Shoqërinë, ajo nuk mund të ngarkohej me detyrimin për të ofruar një shërbim të tillë. Në këtë këndvështrim, Komisioneri gjykoi se, Shoqëria nuk kishte kryer veprime të cilat binin ndesh me zbatimin e kontratës së mësipërme nënshkruar mes saj dhe Bashkisë. Për rrjedhojë, ajo nuk kishte shkelur dispozitat e Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, por ishte Bashkia Kamëz që me mosveprimet e saj kishte ndikuar që subjektin ankues dhe gjithë kategorisë së personave që si ai janë pjesë e kategorisë së personave të verbër⁶ t’u mohohet e drejta e udhëtimit falas në transportin urban qytetës.

⁶ Vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetasit M. SH. dhe të gjithë kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar*”.

A. Z. kundër Bashkisë Fier

VENDIM NR. 72, DATË 15.05.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, duke iu refuzuar përfitimi i shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror dhe akomodimi në Shtëpinë e të Moshuarve, nga ana e Bashkisë Fier.

FAKTET

Ankuesi A. Z., është i datëlindjes 10.04.1956, banon në qytetin e Fierit, është person me aftësi të kufizuara në shikim dhe përfiton nga statusi i të verbërit, grupi i parë, duke e gëzuar këtë status përgjithmonë. Rezulton se ankuesi figuron me gjendje civile “i divorcuar” dhe është kryefamiljar i vetëm.

Ankuesi pretendon se me gjithë përpjekjet sistematike që ka bërë pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, në Bashkinë Fier, është refuzuar dhe diskriminuar. Në këto kushte, ai i është drejtuar Bashkisë Fier me një kërkesë në lidhje me shqetësimin e tij dhe që të bëhej e mundur sistemimi i tij në Shtëpinë e të Moshuarve pranë kësaj bashkie. Ankuesi parashtron se në kushtet në të cilat ai ndodhej, si një njeri në moshën 66 vjeçare, i cili jeton i vetmuar dhe pa asnjë njeri që mund ti ofrojë shërbime ndihmëse dhe nevojës për përkujdesje të vazhdueshme, i është drejtuar Shtëpisë së të Moshuarve pranë Bashkisë Fier duke dorëzuar dhe dokumentacionin e kërkuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;

KONKLUZIONE

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Fier, ka detyrimin që të identifikojë nevojat e personave që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror që jetojnë në juridiksionin e saj, si dhe detyrimin, jo vetëm për të drejtuar procesin e aplikimit, por edhe për të siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të VKM nr. 518, datë 04.09.2018. Komisioneri konstaton se, Bashkia Fier ka patur dijeni për nevojën e ankuesit për të përfituar nga shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, e megjithatë nuk ka marrë asnjë masë që ankuesi A. Z. t’i nënshtrohet procesit dhe për të vlerësuar nëse ankuesi mund të sistemohet apo jo pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier. Rrjedhimisht, pretendimi i Bashkisë Fier se, rasti i ankuesit nuk është shqyrtuar pasi ai nuk ka depozituar në bashki dokumentacionin e kërkuar sipas VKM nr. 518, datë 04.09.2018, është i pabazuar, pasi me identifikimin e nevojave dhe kërkesës së ankuesit për t’u sistemuar pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier, bashkia duhet të kishte marrë masat dhe duhet të kishte vepruar në përputhje me rolin dhe detyrimet e saj, që ankuesi t’i nënshtrohej procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes nga autoritetet përgjegjëse.

Pavarësisht se ankuesi nuk i është nënshtrohet formalisht procesit të vlerësimit dhe nuk ka një vendimmarrje formale në lidhje me kërkimin e tij për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, duke mbajtur në konsideratë sjelljen pasive dhe mosveprimin nga ana e Bashkisë Fier, për të përmbushur detyrimet që ajo ka në drejtim të administrimit të procesit të përfitimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe përgjigjen që Bashkia Fier i ka kthyer ankuesit se “...Duke qenë se Shtëpia e të Moshuarve është institucion social, me një numër të kufizuar punonjësish, është e pamundur të asistojë një person të tillë gjithë kohën...”, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Fier e ka deklaruar vullnetin e saj refuzues ndaj kërkesës së ankuesit për tu akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, duke i komunikuar atij se, është e pamundur të asistojë një person në kushtet e ankuesit, person me aftësi të kufizuara në shikim.

Komisioneri arrin në përfundimin se, me sjelljen dhe mosveprimin e saj Bashkia Fier, e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, në kuadër të procesit të përfitimit të shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit të ofruara në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.

Komisioneri vlerëson se ky qëndrimi i mbajtur nga ana e Bashkisë Fier në lidhje me pranimin e të moshuarve me aftësi të kufizuar në Shtëpinë e të Moshuarve është përjashtues për këtë kategori të moshuarish dhe vjen në kundërshtim me rregullimin ligjor që bëhet në lidhje me mënyrën e ofrimit

dhe përfitimit të kësaj kategorie të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Bashkia Fier barazon identitetin e ankuesit si person me aftësi të kufizuar dhe nevojat e tij për të përfituar shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve me gjendjen shëndetësore duke e adresuar këtë si një nevojë që duhet të realizohet në një institucion mjekësor. Komisioneri evidenton se qasja e Bashkisë Fier në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuar është një qasje që në mënyrë të gabuar bazohet në modelin mjekësor dhe jo në modelin bio-psiko-social bazuar në të drejtat e njeriut të aftësisë së kufizuar të vendosur nga KDPAK dhe ligji nr. 93/2014.

Komisioneri konstaton se, justifikimet e paraqitura nga Bashkia Fier se, Shtëpia e të Moshuarve Fier është një institucion social dhe jo një institucion spitalor, apo që ka një numër të kufizuar punonjësish dhe për rrjedhojë e ka të pamundur të asistojë ankuesin si një person me aftësi të kufizuar, nuk mund të shërbejnë si një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi. Përkundrazi si ofrues i shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror për të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, Bashkia Fier, ka detyrimi që të marrë të gjitha masat për ta ofruar këtë shërbim në përputhje me nevojat e tyre.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Fier ka refuzuar që të përfshijë ankuesin në procesin e përfitimit të shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror që ofrohen për të moshuarit pranë Shtëpisë së të Moshuarve, vetëm për shkak se ankuesi është i moshuar me aftësi të kufizuar dhe se një sjellje e tillë përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të aftësisë së kufizuar. Motivi apo qëllimi i palës diskriminuese nuk është relevant për përcaktimin nëse ka ndodhur diskriminimi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A. Z., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Fier.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Fier, të marrë masa të menjëhershme:
 - Për të trajtuar procesin e përfitimit të shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier për ankuesin A. Z.
 - Për të asistuar ankuesin A. Z. në çdo hap të procesit të përfitimit të shërbimit.
 - Për të shmangur çdo sjellje diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në aftësinë e kufizuar të personave që duan të përfitojnë nga këto shërbime.

S. H. kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-AL-Transport” sh.p.k.

VENDIM NR. 76, DATË 22.05.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Aftësia e kufizuar
Statusi: Në gjykatë

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik të Bashkisë Kamëz për S. H., person me aftësi të kufizuara, ka sjellë diskriminimin e tij, duke i mohuar aksesin në transportin publik

FAKTET

Ankuesja më datë 28.12.2022, ka udhëtuar me autobusin e linjës urbane Tiranë-Kamëz. Pas nisjes së autobusit fatorino i ka kërkuar të bëj pagesën e biletës, duke mos i njohur librezën e verbërisë. Pas debatit të zhvilluar mes saj dhe fatorinos është detyruar të paguajë biletën. Gjithashtu, më datë 01.01.2023, ankuesja ka udhëtuar me autobusin e Shoqërisë së Transportit “Shpresa AL”, nga Terminali i Autobusëve, në drejtim të stacionit pranë Institutit Bujqësor. Sërish ka ndodhur e njëjta situatë, ku është detyruar të paguaj biletën, duke mos iu njohur librezë e verbërisë së lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, si dhe as ajo e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
- Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Nga informacioni i administruar nga Komisioneri në kuadër të ankesave të mëparshme me të njëjtin objekt, kundër Bashkisë Kamëz, Bashkia ka qenë në dijeni të situatës së krijuar ndërmjet operatorit të transportit publik Shpresa AL dhe kategorive të personave që përfitojnë udhëtimin pa pagesë në territorin e saj, në përgjithësi dhe specifikisht edhe të rastit konkret me shtetasen S. H. (për problematikën e të cilës është vënë në dijeni nga Komisioneri që me datë 17.01.2023). Pavarësisht kësaj, nuk rezultoi të kishte pasur përpjekje nga ana e Bashkisë për verifikimin e problematikës me ankuesen, apo rregullimin përfundimtar të situatës, duke mohuar të drejtën e saj për të përfituar lehtësira në udhëtim, si dhe duke shkelur njëherësh edhe detyrimet e saj kontraktuale me shoqërinë e transportit.

Në përfundim, Komisioneri gjykoj se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Bashkia Kamëz kishte ekspozuar subjektin ankues, S. H., e cila bënte pjesë në kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit urban qytetas pa pagesë.

Nisur nga analizimi i detyrimeve kontraktuale, të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve Bashkia Kamëz dhe Shoqëria Shpresa Al, Komisioneri vlerësoi se, detyrimi për të ofruar falas shërbimin urban qytetas për kategorinë e personave të verbër nga ana e Shoqërisë Shpresa Al ishte i kushtëzuar nga përmbushja e detyrimit të Bashkisë për ta subvencionuar atë.

Përsa kohë Bashkia nuk kishte zbatuar detyrimin e saj për të subvencionuar Shoqërinë, ajo nuk mund të ngarkohej me detyrimin për të ofruar një shërbim të tillë. Në këtë këndvështrim, Komisioneri gjykoj se, Shoqëria nuk kishte kryer veprime të cilat binin ndesh me zbatimin e kontratës së mësipërme nënshkruar mes saj dhe Bashkisë. Për rrjedhojë, ajo nuk kishte shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, por ishte Bashkia Kamëz që me mosveprimet e saj kishte ndikuar që subjektin ankues dhe gjithë kategorisë

së personave që si ai janë pjesë e kategorisë së personave të verbër⁷ t'u mohohet e drejta e udhëtimit falas në transportin urban qytetës.

Lidhur me pretendimin e njohjes si dokument zyrtar të ligjshëm të Librezë së Verbërisë së lëshuar nga ana e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me Shoqatën e Invalidëve të Punës, në situatën e analizuar (parashikimet ligjore për legjitimimin e autoriteteve përgjegjëse kompetente për lëshimin e dokumentit zyrtar të identifikimit të aftësisë së kufizuar) rezultoi qartë që subjekti ankues, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, nuk ndodhet në kushte të njëjta me Shoqatën e Invalidëve të Punës dhe për rrjedhojë, nuk mund të krahasohej me të, dhe në këtë kontekst, Komisioneri vlerësoi se nuk mund të pretendohet për trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm krahasimisht me të.

Në mungesë të këtij trajtimi, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm me “krahasuesin”, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar. Rrjedhimisht, Komisioneri gjykon se nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetases S. H., dhe të gjithë kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetases S. H., nga ana e Kompanisë “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

⁷ Vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

M. S. kundër Shoqërisë së Transportit “EL-ALBA 1” sh.p.k.

VENDIM NR. 93, DATË 09.06.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Zbatuar

Mosnjohja e librezës së verbërisë në linjën e transportit ndërqytetës Tiranë-Durrës nga ana e Shoqërisë “EL-ALBA 1”, për M. S., person me aftësi të kufizuar, ka sjellë diskriminimin e tij për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Ankuesi ka udhëtuar me autobusin e linjës ndërqytetëse Tiranë-Durrës. Pas nisjes së autobusit faturino i ka kërkuar të bëj pagesën e biletës duke mos i njohur librezën e verbërisë të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Në momentin që i ka paraqitur faturinos dhe shoferit të autobuzit, librezën e verbërisë, nga ana e këtyre të fundit, nuk i është njohur librezë dhe i është kërkuar që të paguante biletën e plotë të transportit. Ndërkaq, faturinoja dhe shoferi që është njëkohësisht pronar i mjetit dhe aksioner i Shoqërisë së transportit, i ka mbajtur përkohësisht librezën e verbërisë duke mos ja kthyer atë ankuesit. Pas debatit të zhvilluar mes tij, shoferit dhe faturinos është detyruar të kryejë pagesën e plotë të biletës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;

- Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUSIONE

Nga informacioni i administruar nga Komisioneri në kuadër të ankesave të mëparshme me të njëjtin objekt, kundër Shoqërisë EL-ALBA 1, rezulton se Shoqëria ka qenë në dijeni të situatës së krijuar ndërmjet punonjësve të tyre dhe personave me aftësi të kufizuara, të verbër, që përfitojnë udhëtimin me gjysmë pagese. Por, pavarësisht kësaj, rezulton se nga ana e Shoqërisë EL-ALBA 1, nuk ka pasur veprime efektive dhe efikase me faturinot dhe pronarët e mjeteve të shoqërisë, për shmangien e këtyre ngjarjeve dhe njohjen e të drejtës së personave me aftësi të kufizuara, të verbër, për të udhëtuar me gjysmë çmimi.

Shoqëria EL-ALBA 1 ka pranuar se ky është rasti i tretë i përsëritjes së kësaj situatë dhe se në rastin objekt shqyrtimi, kanë konstatuar veprime abuzive nga pronari i mjetit, që është njëkohësisht dhe aksioner i Shoqërisë, por nuk kanë dërguar asnjë dokumentacion për veprime konkrete të ndërmarra për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla.

Nga informacioni i administruar, rezulton se pronari i mjetit që është njëkohësisht dhe aksioner i Shoqërisë, jo vetëm që nuk ka pranuar pagesën me gjysmë çmimi të ankuesit por me veprimet dhe sjelljen e tij, duke debatuar me ankuesin dhe duke mos i kthyer librezën e verbërisë si formë presioni, ka cenuar dinjitetin e ankuesit dhe ka krijuar një mjedis frikësues dhe ofendues për M. S., sa ky i fundit është nisur për të bërë denoncim në polici.

Komisioneri konstaton se të gjitha veprimet dhe mosveprimet në shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi bazën e të cilave rregullohet transporti urban ndërqytetës, nga ana e Shoqërisë EL-ALBA 1, kanë krijuar një mjedis frikësues dhe ofendues ndaj ankuesit për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Shoqëria EL-ALBA 1 shpk, ka ekspozuar subjektin ankues, i cili bën pjesë në kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit ndërqytetës me gjysmë pagese.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe në formën e shqetësimit, të shtetasit M. S., për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë EL-ALBA 1 shpk.

- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Shoqëria EL-ALBA 1 shpk të marrë masa të menjëhershme për ndalimin e shqetësimit dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

A. M, kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.

VENDIM NR. 94, DATË 09.06.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Mosnjohja e librezës së verbërisë nga ana e Shoqërisë së transportit urban “Shpresa-Al” në transportin publik të Bashkisë së Kamëz për A. M, person me aftësi të kufizuara, ka sjellë diskriminimin e tij për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Ankuesi ka udhëtuar me autobusin e linjës urbane Tiranë-Kamëz. Pas nisjes së autobusit faturino i ka kërkuar të bëj pagesën e biletës duke mos i njohur librezën e verbërisë. Pas debatit të zhvilluar mes tij dhe faturinos është detyruar të kryejë pagesën e biletës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri evidentoi se Bashkia Kamëz është subjekti i cili licenson shoqëritë e transportit që ushtrojnë aktivitetin qytetas në territorin që ajo mbulon.

Në kontekst të legjitimitimit të subjektit ankues kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ka pretenduar diskriminimin, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, Bashkia Kamëz, gëzon legjitimitim pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin për ofrimin e monitorimin e shërbimit të transportit për kategorinë e të verbërve, nga ana e operatorëve të transportit rrugor, me të cilët ajo hyn në marrëdhënie kontraktuale.

Në këtë kuadër, Komisioneri bëri pjesë të procedurave hetimore dhe këtë njësi të vetëqeverisjes vendore, si subjekt ndaj të cilit shqyrtohet ankesa e paraqitur nga ana e shtetasit A. M., i përfaqësuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Nga informacioni i administruar nga Komisioneri në kuadër të ankesave të mëparshme me të njëjtin objekt, kundër Bashkisë Kamëz, Bashkia ka qenë në dijeni të situatës së krijuar ndërmjet operatorit të transportit publik Shpresa AL dhe kategorive të personave që përfitojnë udhëtimin pa pagesë në territorin e saj, në përgjithësi dhe specifikisht edhe të rastit konkret me shtetasin A.M. Pavarësisht kësaj, nuk rezulton të ketë pasur përpjekje nga ana e Bashkisë për verifikimin e problematikës me ankuesin, apo rregullimin përfundimtar të situatës nga ana e saj, duke mohuar të drejtën e tij për të përfituar lehtësira në udhëtim, si dhe duke shkelur njëherësh edhe detyrimet e saj kontraktuale me shoqërinë e transportit.

Në përfundim, Komisioneri gjykoj se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Bashkia Kamëz kishte ekspozuar subjektin ankues, A. M, i cili bën pjesë në kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit urban qytetas pa pagesë.

Nisur nga analizimi i detyrimeve kontraktuale, të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve Bashkia Kamëz dhe Shoqëria Shpresa AL, Komisioneri vlerësoi se, detyrimi për të ofruar falas shërbimin urban qytetës për kategorinë e personave të verbër nga ana e Shoqërisë Shpresa AL, ishte i kushtëzuar nga përmbushja e detyrimit të Bashkisë për ta subvencionuar atë.

Përsa kohë Bashkia nuk kishte zbatuar detyrimin e saj për të subvencionuar Shoqërinë, ajo nuk mund të ngarkohej me detyrimin për të ofruar një shërbim të tillë. Në këtë këndvështrim, Komisioneri gjykoj se, Shoqëria nuk kishte kryer veprime të cilat binin ndesh me zbatimin e kontratës së mësipërme nënshkruar mes saj dhe Bashkisë. Për rrjedhojë, ajo nuk kishte shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, por ishte Bashkia Kamëz që me mosveprimet e saj kishte ndikuar që subjektin ankues dhe gjithë kategorisë

së personave që si ai janë pjesë e kategorisë së personave të verbër t'u mohohet e drejta e udhëtimit falas në transportin urban qytetës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetasit A. M., dhe të gjithë kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetasit A. M., nga ana e Kompanisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

J. M. kundër Shoqërisë LEDJAN sh.p.k.

VENDIM NR. 137, DATË 26.07.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesi është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, sa i takon mos ofrimit të transportit ndërqytetës sipas legjislacionit në fuqi.

FAKTET

Ankuesi J. M. është person me aftësi të kufizuar në shikim dhe që prej datës 26.03.2012, është vlerësuar nga Komisioni Mjekësor për Caktimin e Verbërisë si “Grupi i I (Parë)”, duke qenë në këtë mënyrë përfitues i ligjit Nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar.

Ankuesi J. M., pretendon se në datën 15.09.2022 ka udhëtuar në linjën e transportit të udhëtarëve Durrës- Berat. Fatorino i ka kërkuar që të paguante vlerën e plotë të biletës. Fillimisht ankuesi nuk ka pranuar të paguajë biletën e plotë, duke pretenduar se, në bazë të ligjit Nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar ai duhet të paguante 50 % të vlerës së biletës dhe jo vlerën e plotë. Sipas ankuesit, fatorino i ka deklaruar se ai ishte privat dhe nuk e njihnte librezën. Më pas, ankuesi është detyruar që të bëjë pagesën e plotë të biletës. Ankuesi pretendoi se është gjendur në të njëjtën situatë edhe në datën 08.11.2022.

Rezultoi se linja e transportit në të cilën ka udhëtuar ankuesi është një linjë e transportit ndërqytetës që lidh qytetin e Durrësit dhe të Beratit. Rezultoi e provuar, fakt ky që u pranua edhe nga vetë subjekti, se mjetet e transportit me të cilat ka udhëtuar ankuesi i përkasin Shoqërisë LEDJAN sh.p.k. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, është pajisur me licencën nr. 80, datë 15.06.2022 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, lëshuar nga DPSHTRR.

Shoqëria LEDJAN sh.p.k gjatë shqyrtimit të ankesës nuk i kundërshtoi faktet dhe ngjarjet e pretenduara nga ankuesi se kishin ndodhur në të dyja rastet, por theksoi faktin se këto situata kanë ndodhur nga ana e punonjësve të shoqërisë që punojnë me mjetet e shoqërisë dhe se kjo e fundit i dënon këto sjellje dhe angazhohet që ato mos ndodhin më në të ardhmen.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”;
- Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar;

KONKLUZIONE

Personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetës dhe ndërqytetës. Parashikimet ligjore, gjejnë pasqyrim edhe në certifikatat me të cilat është pajisur Shoqëria LEDJAN sh.p.k për të ushtruar veprimtarinë e transportit në linjën ndërqytetëse Durrës-Berat-Durrës. Shoqëria LEDJAN sh.p.k nuk ngriti pretendime gjatë shqyrtimit të ankesës se pala ankuese nuk kishte përmbushur detyrimin e saj për të paraqitur dokumentin përkatës ligjor për të përfituar biletën me gjysmë çmimi, që në rastin konkret është librezë e verbërisë, e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Që në momentin e parë të marrjes dijeni në lidhje me ankesën, shoqëria mbajti një qëndrim pranues ndaj ngjarjeve të ndodhura.

Komisioneri vlerëson se ankuesi J. M., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit ndërqytetës me gjysmë pagesë.

Me marrjen e licencës subjekti pa pranuar dhe një detyrimet që burojnë nga legjislacioni në lidhje me ofrimin e transportit për personat me aftësi të kufizuara dhe ka detyrimin që ti garantojë këto të drejta. Pavarësisht se shoqëria pranon dhe një këto të drejta ajo nuk rezulton të ketë marrë masa efektive për të parandaluar që sjellje të tilla të ndodhin në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj

dhe ofrimit të shërbimit të transportit. Komisioneri vlerëson se, ankuesit i është mohuar një e drejtë, e cila i është dhënë nga legjislacioni në fuqi. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se Shoqëria LEDJAN sh.p.k e ka vendosur ankuesin përpara një situatë diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, sa i takon mos ofrimit të transportit ndërqytetës me biletë me gjysmë çmimi. Motivi apo qëllimi i palës diskriminuese nuk është relevant për përcaktimin nëse ka ndodhur diskriminimi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit J. M., për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë LEDJAN shpk.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Shoqëria LEDJAN sh.p.k shpk të marrë masa të menjëhershme për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria LEDJAN sh.p.k duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikatat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.

Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë

VENDIM NR. 142, DATË 26. 07. 2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Proces

Dështimi për të garantuar vendet e parkimit të rezervuara dhe sipas standardeve të miratuara diskriminon, personat me aftësi të kufizuar.

FAKTET

Fondacioni Së bashku, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se, në të gjitha rrugët dhe sheshet ku është i mundur parkimi i makinave, por edhe në godinën e Bashkisë Vorë, nuk ka asnjë vend parkimi për personat me aftësi të kufizuar. Sipas palës ankuese, një situatë e tillë diskriminon personat me aftësi të kufizuara të cilët për shkak të mungesës së vendeve të parkimit, nuk mund të marrin në mënyrë të lirë dhe të pavarur shërbimet e tyre në territorin e administruar nga Bashkia Vorë.

Bashkia Vorë pranon se nuk ka marrë masa për garantimin e hapësirave të parkimit/vendparkimit për personat me aftësi të kufizuar sipas kërkesave të parashikuara nga Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Bashkia Vorë, me gjithë kërkesat e përsëritura të Komisionerit, nuk dërgoi asnjë dokumentacion apo informacion të detajuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e parkimeve për personat me aftësi të kufizuara të parashikuara nga VKM-të nr. 1503/2008 dhe nr. 1074, datë 23.12.2015, apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen. Bashkia Vorë parashtroi se, për shkak të fatkeqësisë natyrore tërmetit të datës 26.11.2019, Bashkia Vorë është në proces rindërtimi dhe si e tillë nuk ka përfunduar ende ndërtimi i pallateve, infrastrukturës dhe hapësirave publike. Qyteti Vorë është në proces rindërtimi dhe për këtë arsye vitet e fundit nuk janë marrë masat sipas legjisllacionit në fuqi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “*Aksesueshmëria*”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”.
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”;

KONKLUZIONE

Bashkia Vorë është autoriteti përgjegjës në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen me sigurimin e parkimeve për personat me aftësi të kufizuar, sigurimin e sinjalistikës rrugore për këto parkime dhe sigurimin e mos zënies së këtyre parkimeve nga përdorues të tjerë. Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, që duhet të përmbushin parkimet për personat me aftësi të kufizuar, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës Bashkia Vorë, pranoi se nuk ka përmbushur detyrimet ligjore sipas parashikimeve në fuqi, në lidhje me parkimin e dedikuar për personat me aftësi të kufizuar pranë godinës së kësaj bashkie apo parkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar në territorin e administruar nga ana e saj.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët shfrytëzimin e hapësirave publike të Bashkisë Vorë. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukurore në hapësirat publike të Bashkisë, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesin për të marrë shërbimet e ofruara.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Vorë nuk ka të parashikuara pranë godinës së saj dhe në në territorin e saj, parkime për personat me aftësi të kufizuar, e për rrjedhojë Bashkia Vorë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të

kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, Komisioneri vlerëson se mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me banorët e tjerë të Bashkisë Vorë.

Bashkia Vorë nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion, në lidhje me planifikimin e fondeve dhe afateve kohore për përmbushjen e detyrimit ligjor për parkimet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuar sipas standardeve teknike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Bashkia Vorë nuk depozitoi asnjë provë për të treguar se nga ana e saj, pavarësisht mospërmbushjes së detyrimit ligjor për të garantuar vendet e parkimit të rezervuar për personat me aftësi të kufizuar në godinën e saj dhe në të gjithë territorin e administruar prej saj, Bashkia Vorë kishte marrë masa konkrete për të siguruar aksesueshmërinë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme, nëpërmjet hartimit të një plani me parashikime konkrete të burimeve financiare dhe afateve kohore për sigurimin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuar.

Në mungesë të dokumentacionit provues në lidhje me hapat konkretë të ndërmarrë për të realizuar aksesueshmërinë, Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Vorë nuk ka marrë asnjë masë për të planifikuar dhe realizuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar. Komisioneri konstaton se, Bashkia Vorë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me sigurimin e parkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Bashkisë Vorë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Vorë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Bashkisë Vorë.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Vorë, në lidhje me garantimin e parkimeve të personave me aftësi të kufizuar në territorin e bashkisë.
- Bashkia Vorë të marrë masa për hartimin e një plani të detajuar për parkimet publike për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për sigurimin e parkimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.

Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 159, datë 10.08.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Gjobë për moszbatim vendimi

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë në Pallatin e Kulturës, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, si pasojë diskriminimit të tyre për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Fondacioni Së bashku, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë, diskriminon personat me aftësi të kufizuar në Pallatin e Kulturës, në Bashkinë Kavajë.

Në godinën e Pallatit të Kulturës gjenden jo vetëm institucione kulturore, por edhe zyra të ndryshme që ofrojnë shërbime për publikun. Kjo godinë edhe pse ka një rampë në hyrje të saj, pasi hyn në ndërtesë, ka shkallë për të mbërritur te institucionet edhe në katin përdhe, nuk ka ashensor për të aksesuar katet e sipërme dhe mungojnë elementët e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar në shikim.

Bashkia Kavajë, pretendoi se godina e Pallatit të Kulturës është e pajisur me ashensor, i cili ndihmon në ngjitjen pa problem në katet më lart për personat me aftësi të kufizuar, por pavarësisht kërkesave të përsëritura të Komisionerit, Bashkia Kavajë nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin për të provuar pretendimin e saj dhe faktin se godina e Pallatit të Kulturës është e pajisur me ashensor. Bashkia Kavajë nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e aspekteve të tjera të aksesueshmërisë në lidhje me godinën e Pallatit të Kulturës. Bashkia Kavajë nuk prapësoi asnjë nga pretendimet e tjera dhe pamjet fotografike të paraqitura nga pala ankuese.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “*Aksesueshmëria*”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”;

KONKLUZIONE

Referuar parashikimeve në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushin ndërtesat që shërbejnë si qendra kulture, sikurse është në rastin objekt shqyrtimi ndërtesa e Pallatit të Kulturës, në Bashkinë Kavajë, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kavajë nuk provoi se godina e Pallatit të Kulturës, plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me parashikimet ligjore. Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuar, edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në arsim në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në ndërtesën e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kavajë, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet akses në këtë ndërtesë ku zhvillohen aktivitete kulturore.

Është në përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore që të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesave ku zhvillohen aktivitete kulturore, bibliotekat apo ambienteve për lexim. Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, është në përgjegjësinë e Bashkisë Kavajë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është Pallati i Kulturës, të sigurojë aksesueshmërinë e kësaj ndërtese.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kavajë, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, e për rrjedhojë Bashkia Kavajë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuar

Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, personat me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar dhe nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kavajë nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me faktin se kur është ndërtuar godina e Pallatit të Kulturës. Standardet e aksesueshmërisë janë vendosur dhe miratuar që prej vitit 2008, sipas VKM nr.1503, datë 19.11.2008. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, edhe nëse godina e Pallatit të Kulturës është ndërtuar përpara miratimit të standardeve të aksesueshmërisë (VKM nr. 1503, datë 19.11.2008), që prej momentit kur janë bërë të detyrueshme standardet e aksesueshmërisë dhe deri në momentin e paraqitjes së ankesës, ka kaluar një kohë e gjatë e pajustificuar, gjatë të cilës Bashkia Kavajë ka dështuar që të sigurojë aksesueshmërinë e kësaj godine. Bashkia Kavajë nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm që e ka pamundësuar atë për të garantuar aksesueshmërinë. Ndërsa, nëse Pallati i Kulturës është ndërtuar pas vitit 2008, çdo godinë e ndërtuar pas këtij viti, ka patur detyrimin që të ndërtohet në përputhje me standardet e përcaktuara nga VKM nr. 1503, datë 19.11.2008.

Bashkia Kavajë nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me hartimin e një plani veprimi, me afate kohore dhe fonde të përcaktuara, për eliminimin e barrierave infrastrukturore/artitektonike dhe sigurimin e standardeve dhe kritereve teknike të aksesueshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë ndërtesën e Pallatit të Kulturës. Bashkia Kavajë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me evidentimin e objekteve ekzistues në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Pallatin e Kulturës, në Bashkinë Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në

baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Kavajë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë ndërtesë. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuar dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuar si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë së ndërtesës e Pallatit të Kulturës në Bashkinë Kavajë, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë Kavajë, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në Pallatit të Kulturës, Bashkia Kavajë.
- Bashkia Kavajë, duhet të marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në Pallatin e Kulturës, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.
- Bashkia Kavajë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuar. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

H. Ç. kundër Shoqërisë LEDJAN sh.p.k.

VENDIM NR. 175, DATË 11.09.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesja është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, sa i takon mos ofrimit të transportit ndërqytetës sipas legjislacionit në fuqi.

FAKTET

Ankuesja H. Ç. është person me aftësi të kufizuar në shikim dhe që prej datës 27.10.2017 është vlerësuar nga Komisioni Mjekësor për Caktimin e Verbërisë si “Grupi i I-rë (Parë) duke qenë në këtë mënyrë përfituese e ligjit Nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar.

Ankuesja pretendon se, në datën 11.01.2023, orari 8 i mëngjesit, ka udhëtuar me linjën e transportit publik nga Durrësi (Plepa) për në Berat dhe ka zbritur në Urën Vajgurore. Në momentin që ka zbritur, ankuesja shpjegon se i ka dhënë lekët që sipas saj i takonte që të jepte, por kur ka zbritur shoferi e ka ndjekur nga mbrapa duke i kërkuar lekët për biletën e plotë. Ankuesja i ka shpjeguar se është invalide dhe është e pajisur me librezë, por shoferi i është përgjigjur se nuk e njeh librezën dhe se duhet t’ia kishte thënë që në momentin që kishte hipur në autobuz.

Rezultoi se, autobuzi me të cilin ankuesja ka udhëtuar, është një mjet i certifikuar për operim nga Shoqëria LEDJAN sh.p.k. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, është pajisur me licencën nr. 80, datë 15.06.2022 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, lëshuar nga DPSHTRR.

Shoqëria LEDJAN sh.p.k gjatë shqyrtimit të ankesës nuk i kundërshtoi faktet dhe ngjarjet e pretenduara nga pala ankuese, por vetëm theksoi faktin se këto situata kanë ndodhur nga ana e një punonjësi të shoqërisë, dhe se kjo e fundit, i dënon këto sjellje dhe angazhohet që ato mos të ndodhin më në të ardhmen.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “*Aksesueshmëria*”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 277, datë 18.06.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, “*Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve*”;
- Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016 “*Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit*”, i ndryshuar;

KONKLUZIONE

Personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetës dhe ndërqytetës. Parashikimet ligjore, gjejnë pasqyrim edhe në certifikatat me të cilat është pajisur Shoqëria LEDJAN sh.p.k për të ushtruar veprimtarinë e transportit në linjën ndërqytetëse Durrës-Berat-Durrës. Shoqëria LEDJAN sh.p.k nuk ngriti pretendime gjatë shqyrtimit të ankesës se pala ankuese nuk kishte përmbushur detyrimin e saj për të paraqitur dokumentin përkatës ligjor për të përfituar biletën me gjysmë çmimi, që në rastin konkret është librezë e verbërisë, e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Që në momentin e parë të marrjes dijëni në lidhje me ankesën, shoqëria mbajti një qëndrim pranues ndaj ngjarjeve të ndodhura. Komisioneri vlerëson se ankuesja, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit ndërqytetës me gjysmë pagese.

Me marrjen e licencën subjekti pa pranuar dhe një detyrimet që burojnë nga legjislacioni në lidhje me ofrimin e transportit për personat me aftësi të kufizuara dhe ka detyrimin që ti garantojë këto të drejta. Pavarësisht se shoqëria pranon dhe një këto të drejta ajo nuk rezulton të ketë marrë masa efektive për të parandaluar që sjellje të tilla të ndodhin në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit. Komisioneri vlerëson se, ankueses i është mohuar një e drejtë, e cila i është dhënë nga legjislacioni në fuqi. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se Shoqëria LEDJAN sh.p.k e ka vendosur ankuesen përpara një situatë diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, sa i takon mos ofrimit të transportit ndërqytetës me biletë me gjysmë çmimi. Motivi apo qëllimi i palës diskriminuese nuk është relevant për përcaktimin nëse ka ndodhur diskriminimi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses H. Ç., për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë LEDJAN shpk.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Shoqëria LEDJAN sh.p.k shpk të marrë masa të menjëhershme për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria LEDJAN sh.p.k duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - i. Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - ii. Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - iii. Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.

Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, kundër Postës Shqiptare sh. a. dhe Bashkisë Korçë

VENDIM NR. 194, DATË 09.10.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Diskriminim të personave të verbër që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Postës Shqiptare sh. a. dhe Bashkisë Korçë, në të drejtën e tyre për ti tërhequr ato pa komisione shtesë.

FAKTET

Bazuar në Ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të Verbërit”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, personat e verbër trajtohen me pagesë për shkak të verbërisë. Personat e verbër të Bashkisë Korçë, më parë e kanë tërhequr pagesën pranë Bashkisë Korçë. Më pas e kanë marrë pranë bankave të nivelit të dytë, pa komision për veprimet e kryera por vetëm 90 lekë për mirëmbajtjen e kartës. Kjo situatë ka vijuar deri në muajin korrik të vitit 2022, në momentin që mes Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare sh.a., ishte nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Këto pagesa, personat e verbër të qytetit të Korçës i tërhiqnin pranë Postës Shqiptare, e cila i mbante për çdo shërbim një komision.

Nga informacioni i administruar, personat me aftësi të kufizuar, të verbër, që mund të merrnin njëkohësisht pagesat e invaliditetit, aftësisë së kufizuar, pagesat shtesë për paketë të veçantë higjieno-sanitare dhe pagesën e ndihmës ekonomike, në zbatim të aktmarrëveshjes mes Postës Shqiptare sh.a. dhe Bashkisë Korçë, ishin të detyruar të paguanin për secilin shërbim komision apo tarifën e parashikuar. Pra, ishin të detyruar të paguanin në varësi të numrit të pagesave që kishin për të tërhequr nga ana e Filialit i Postës sh.a. Korçë.

Sakaq, referuar provave të përcjella nga ana e subjektit ankues, konstatohet që personat e verbër të Bashkisë Korçë, në momentin që kishin tërhequr pagesën e invaliditetit apo të aftësisë së kufizuar, i ishin mbajtur komision prej 100 lekë për secilin shërbim.

Nga analizimi i situatës, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezultoi qartazi se, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, pavarësisht përcaktimeve ligjore në fuqi kishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër, të Bashkisë Korçë dhe njërive administrative në varësi të saj, në raport me të drejtën e tyre ligjore, për marrjen e shërbimeve pa pagesë në zyrën e Filialit të Postës sh.a. Korçë dhe përzgjedhur institucionin ku ata duhet të marrin shërbimin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti Nr. 14/2000 *“E drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit”*, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM-ja nr. 722, datë 11.11.2019, *“Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”*;
- VKM-ja nr. 597, datë 4.9.2019, *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*;
- Udhëzimi i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 47, datë 11.01.2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar”*;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025;

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerësoi dhe arriti në përfundimin se subjekti ankues, personat me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, ishin nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Personat me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, kishin pretenduar se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, përmes ofrimit me pagesë dhe të detyruar pranë zyrave të Filialit të Postës sh.a. Korçë, megjithëse ligji, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë pa pagesë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin

ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të lënë në të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, përzgjedhjen e institucionit (shërbimin postar apo bankar) ku ata do të marrin shërbimin pa pagesë.

Në përfundim, Komisioneri konstatoi se Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, kishin diskriminuar kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, në të drejtën e tyre për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për përzgjedhjen e institucionit (shërbimin postar apo bankar) ku ata do të marrin shërbimin dhe marrjen e tij pa tarifa apo komisione.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar, të verbër, të Bashkisë Korçë, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, të marrin masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj kategorisë së personave të verbër të Bashkisë Korçë, duke i dhënë atyre mundësinë të zgjedhin vetë subjektin për tërheqjen e pagesave, si dhe të zbatojnë legjislacionin duke i përjashtuar nga pagesa e tarifave/komisioneve për shërbimet që ata marrin⁸.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Korçë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj kategorisë së personave të verbër të Bashkisë Korçë, duke i kthyer atyre të gjitha shumat e mbajtura që nga momenti (periudha) kur ka nisur aplikimi i tarifave/komisioneve në shërbimet e marra përmes shërbimin postar dhe atij bankar.

⁸ Pagesë paaftësie, pagesë verbërie, ndihmë ekonomike etj.

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” kundër Bashkisë së Tiranës

VENDIM NR. 212, DATË 25.10.2023

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Gjobë për moszbatim vendimi

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë për personat e verbër, në rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë, ka vënë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar personat e verbër.

FAKTET

Subjekti ankues, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, kryesisht personat me verbëri.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtrohet se nga inspektimi në terren, kanë konstatuar disa problematika për garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, të verbër në rrugën “Xhorxh W. Bush”, Bashkia Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës dhe qëndrimit të mbajtur nga Bashkia, rezultoi se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues/Shoqata, qëndron, dhe se trotuari në rrugën “George W. Bush”/Bashkia Tiranë, nuk është konform standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë për PAK. Trotuari në fjalë nuk ka shirita me relief për personat që nuk shikojnë.

Gjatë komunikimit shkresor me Komisionerin, Bashkia e Tiranës në parashtrimet e depozituara mbajti qëndrimin se, planimetria e përgjithshme e projektit të kësaj rruge, është miratuar me Vendim të Këshillit Teknik, të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, të Bashkisë së Tiranës, me nr. 1, datë 24.01.2019, dhe se planimetria e projektit të sinjalistikës rrugore nuk ka parashikuar vendosjen e pllakave apo shiritave sinjalizues për të verbërit⁹.

Sipas dokumentacionit të depozituar, daton se, punimet në këtë objekt/ rrugën “Xhorxh W. Bush”, kanë filluar më datë 24.11.2022 dhe kanë përfunduar më datë 24.07.2023, ndërkohë që, legjislacioni i brendshëm rregullator për sigurimin e garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, ka hyrë në fuqi dhe ka qenë i detyrueshëm për zbatim shumë kohë përpara se të miratohej Vendimi nr. 1, datë 24.01.2019, i Këshillit Teknik, dhe po ashtu edhe përpara fillimit të punimeve në objektin/rruga “Xhorxh W. Bush”, Tiranë.

Bashkia nuk arriti të tregojë apo dëshmojë vullnetin e saj, se pavarësisht sa më sipër, ajo kishte hartuar apo do të hartonte në një të ardhme të afërt një plan masash, me afate konkrete se kur do të realizohej një ndërhyrje e tillë, në përputhje me kriteret teknike të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia e Tiranës, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me masat konkrete, afatet kohore dhe fondet, (apo hartimin e një plani konkret të mirëfilltë) për të rikonsideruar ndërhyrjen a përmirësimin e situatës teknike, në rrugën “Xhorxh W. Bush”, Tiranë, në përputhje me standardet dhe kriteret teknike në fuqi. Komisioneri vlerësoi se, nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa për të punuar drejt realizimit gradual dhe as të menjëhershëm, të përmbushjes së standardeve të kërkuara të aksesueshmërisë.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të elementëve teknikë të aksesueshmërisë në rrugën “Xhorxh W. Bush”, Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia e Tiranës nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë për PAK.

⁹ Punimet në këtë objekt kanë filluar më datë 24.11.2022 dhe kanë përfunduar më datë 24.07.2023.

Në këto kushte, Komisioneri arriti në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuar dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuar si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë në rrugën “Xhorxh W. Bush”, Tiranë, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë së Tiranës, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë të sinjalistikës rrugore, për personat me aftësi të kufizuara, me statusin e të verbërit, në rrugën “Xhorxh W. Bush”, Tiranë.
- Bashkia e Tiranës, të marrë masa konkrete për të siguruar në mënyrë efektive, aksesueshmërinë e këmbësorëve në rrugën “Xhorxh W. Bush”, Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, me statusin e të verbërit.
- Bashkia e Tiranës, rekomandohet të mbajë gjithmonë në konsideratë, zbatimin e parashikimeve ligjore për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në të gjitha investimet e saj aktuale dhe në të ardhmen.

A. B. kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

VENDIM NR. 235, DATË 16.11.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsimit
Statusi: Zbatuar pjesërisht dhe kundërshtuar në gjykatë

Ankuesja me aftësi të kufizuara është nxënëse në arsimin e mesëm dhe në provimet e Maturës Shtetërore i është nënshtruar testeve të zakonshme dhe jo testeve të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, duke e diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Referuar shkresës së Gjimnazit, vërtetohet se nxënësjja A. B., ka ndjekur studimet me Planin Edukativ Individual dhe është mbështetur me mësues ndihmës, gjatë viteve shkollore 2019-2022.

Rezulton se pas përfundimit të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore 2022, maturantja A. B ka marrë nota jo kaluese në dy provime, atë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsi dhe Provimin me Zgjedhje dhe në dy provimet e tjera është vlerësuar me këto nota: Gjuhë Gjermane (B1) 4.5 dhe Matematikë 5.93. Në sesionin e dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2022, A. B është vlerësuar me këto nota: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi 6.5 dhe Provim me Zgjedhje, Qytetari dhe Psikologji 4.93, si dhe në përfundim të shkollës rezulton me notë mesatare të shkollës së mesme 6.53; notë mesatare të MSH 5.47 dhe notë mesatare 6.

Shkolla me shkresën nr. 1266, datë 28.06.2022, i është drejtuar ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë dhe DPAP Tiranë, në të cilën është ankuar për të drejtën që i është mohuar nxënëses me AK, për të pasur test specifik në provimet e Maturës Shtetërore. Shkresë për të cilën, shkolla dhe nxënësjja nuk kanë marrë përgjigje.

Referuar informacionit të dërguar nga palët, rezulton se maturantja A. B., ka zhvilluar provimet në një mjedis të veçantë, e shoqëruar me mësues ndihmës dhe i është nënshtruar testeve standarte të maturës shtetërore të parashikuara si për të gjithë maturantët.

Pavarësisht ankesës së shkollës dhe të prindit për hartimin e një testi të veçantë dhe gjatë zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, të sesionit të dytë, nxënësjja A. B., i është nënshtruar testeve të hartuara nga QSHA-ja, të njëjtë si për të gjithë maturantët e tjerë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për Drejtat e Njeriut;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Konventa e OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijës”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 (1999) “Mbi të drejtën për arsim”, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Social dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Rregullore për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS;
- Rregullore e Maturës Shtetërore (2022), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 108, datë 04.03.2022;
- Rregullore e Maturës Shtetërore (2023), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 739, datë 15.12.2022;

KONKLUSIONE

Nga analizimi në tërësi i fakteve, rezulton se bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nenin 49/2 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 84/8 të Rregullores për funksionimin e IAP-ve, duhej që MAS dhe institucionet në varësi të saj, të merrnin masa, që nxënësja A. B me aftësi të kufizuara, ti nënshtrohej një testi në përshtatje me veçoritë e saj dhe në përputhje me njohuritë që kishte marrë gjatë procesit mësimor, pasi nxënësja, të gjitha lëndët mësimore gjatë gjithë viteve të shkollimit në shkollën e mesme, i kishte zhvilluar me PEI.

Pavarësisht se maturantja A. B., në përfundim të provimeve të maturës shtetërore, është vlerësuar me nota kaluese në të gjitha lëndët, rezultatet e saj (notat) nuk tregojnë realisht arritjet mësimore të saj, pasi nxënësja gjatë viteve të shkollës ka studiuar me program mësimor të veçantë dhe jo me program mësimor si të gjithë nxënësit e tjerë dhe për këtë arsye dhe rezultatet e saj në provimet e maturës shtetërore, nuk reflektojnë njohuritë dhe arritjet që ajo ka marrë gjatë viteve të shkollës së mesme, pasi mesatarja e shkollës së mesme të ankueses ishte 6.53, ndërkohë që mesatarja e maturës shtetërore pas përfundimit të provimeve ra në 5.47.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, rezulton se neni 49/2 i ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 84 i Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, neni 26/5 i Rregullores së Maturës Shtetërore (2022), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 108, datë 04.03.2022 dhe neni 26/5 i Rregullores së Maturës Shtetërore (2023), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 739, datë 15.12.2022, nuk kanë ndryshuar përsa i përket parashikimit për nxënësit me aftësi të kufizuara lidhur me zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore, ndërkohë që MAS gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore 2023, në ndryshim me maturën shtetërore 2022, ka marrë masat për hartimin e testeve të veçanta për maturanët me aftësi të kufizuara që nuk kishin mësuar me programet standarde lëndore.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi përsa i përket hartimit të testeve të veçanta për maturanen me aftësi të kufizuara, për më tepër që MAS dhe institucionet në varësi të saj, nuk kanë marrë masa për rregullimin e situatës dhe pas kërkesës/ankesës së bërë nga shkolla dhe prindi për hartimin e testeve të veçanta për maturanen A. B., gjatë sesionit të dytë të provimeve të maturës shtetërore 2022.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se moszbatimi i detyrimit ligjor për hartimin e testeve të veçanta për maturanët me aftësi të kufizuara, e ka vendosur A.B., përpara një pengese reale, në raport me pjesën tjetër të maturanëve që kanë zhvilluar dhe janë përgatitur gjatë gjithë viteve të shkollimit me programet standarde të mësimin, gjë e cila ndikoi në rezultatet e kësaj maturaneteje duke e penalizuar dhe me mesataren e maturës shtetërore, duke mos u kualifikuar për ndjekjen e studimeve në arsimin e lartë.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i saj, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të A. B., nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit, në komunikim me A. B., të marrë masa për të siguruar vazhdimin e arsimit të lartë për ankuesen. (Kundërshtuar në gjykatë)
- Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrë masa për përfshirjen e parashikimit të hartimit të testeve të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2024, e në vitet në vazhdim. (Zbatuar)

Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 237, DATË 21.11.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Gjobë

Mungesa e vendparkimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kavajë vendos ata në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin Nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjektit ankues i është mohuar trajtimi i barabartë dhe është diskriminuar lidhur me mungesën e garantimit të vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, në territorin e Bashkisë Kavajë, duke krijuar kështu vështirësi për personat me aftësi të kufizuara për të dalë dhe për të marrë shërbime në të gjithë këtë bashki.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;

- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Kavajë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me garantimin e parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri konstatoi se, Bashkia Kavajë, në mënyrë të pajustificuar, nuk kishte ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike¹⁰ që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me sigurimin e parkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Kavajë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kavajë. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

¹⁰ VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me AK”.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kavajë, në lidhje me garantimin e parkimeve të personave me aftësi të kufizuar në territorin e bashkisë.
- Bashkia Kavajë të marrë masa për hartimin e një plani të detajuar për parkimet publike për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për sigurimin e parkimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.

Fondacioni “Së Bashku”, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër.

VENDIM NR. 259, DATË 28.12.2023

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Zbatuar

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë dhe mungesa e parkimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e verbër, në ambientet e Qendrës Komunitare “Për Familje” nr. 3, një ambient ku ofrojnë shërbimet Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar nr. 1 dhe 2, diskriminon personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk mund të marrin në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët shërbimet e ofruara nga ky institucion.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin Nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj).

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese pretendon se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Qendrës Komunitare “Për Familje” nr. 3, një ambient ku ofron shërbimet e saj Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK) nr. 1 dhe 2, diskriminon personat me aftësi të kufizuara të cilët për shkak të mungesës së aksesit dhe parkimit të rezervuar, nuk mund të marrin në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët shërbimet e ofruara nga ky institucion.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Ligji nr. 15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji nr. 15/2017);
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se godina ku zhvillon veprimtarinë KSHVAK nr. 1 dhe nr. 2 Shkodër, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë dhe parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, DRSHSSH Shkodër deklaroi se për shkak të rikonstruksionit total të ambienteve të Poliklinikës Shkodër, përkohësisht (për gjashtë muaj) dy Komisionet janë zhvendosur në ambientet e Qendrës Komunitare “Për Familje” nr. 3, godinë e cila nuk është e aksesueshme, për arsye se nuk ka rampë dhe parkimi për personat me aftësi të kufizuara nuk mund të ofrohet për arsye të mungesës fizike të infrastrukturës rrugore.

Gjatë shqyrtimit të ankesës DRSHSSH Shkodër, pranoi se nuk ka përmbushur detyrimet ligjore sipas parashikimeve në fuqi, në lidhje dhe me parkimin e dedikuar për personat me aftësi të kufizuar në territorin e godinës ku ushtron veprimtarinë e saj KSHVAK nr. 1 dhe nr. 2 Shkodër, pasi vetëm kur është vënë në dijeni të ankesës, i është drejtuar Bashkisë Shkodër duke i kërkuar bashkëpunim për sigurimin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuar.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga DRSHSSH Shkodër, rezulton se institucioni nuk ka vendosur asnjë kriter të plotësisimit të standardeve të aksesueshmërisë, kur ka bërë kërkesë për

përzgjedhjen e ambienteve ku do zhvillonte veprimtarinë KSHVAK nr. 1 dhe 2, gjatë periudhës së rikonstruksionit të Poliklinikës Shkodër.

Komisioneri konstaton se, DRSHSSH Shkodër, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë godinës së Qendrës Komunitare “Për Familje” nr. 3, Shkodër.
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, të marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në godinën e Qendrës Komunitare “Për Familje” nr. 3, Shkodër, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

VIII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE

A. B. kundër Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan.

VENDIM NR. 37, DATË 09.03.2023

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat, në pozicionin Drejtor. Me shkresën nr. 16, datë 12.02.2021, “Për lirim nga detyra”, është vendosur, lirimi i A.B., nga pozicioni Drejtor i NJVKSH Berat dhe kalimin në pozicionin “Shef Shërbimi” në NJVKSH Berat, pa asnjë arsye dhe në një periudhë që ka qenë me raport mjekësor.

FAKTET

Me shkresën nr. 32/170, datë 27.03.2019 të DROSHKSH Elbasan, ankuesi është njoftuar se për shkak të ristrukturimit transferohet në pozicionin e punës, Drejtor i NJVKSH Berat.

Referuar dokumentit Fletë Përmbledhje e Daljes, datë 10.08.2020, të lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, rezulton se ankuesi ka qenë i shtruar në spital nga data 28.07.2020 deri në datë 10.08.2020.

Referuar dokumentacionit të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ankuesi është paguar me raport paaftësie të përkohshme në punë për periudhën 05.11.2020 deri më 05.04.2021.

Me Urdhrin nr. 16, datë 12.02.2021 të DROSHKSH Elbasan është bërë lirimi i A. B nga pozicioni Drejtor i NJVKSH Berat dhe kalimi në pozicionin Shef i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor në NJVKSH Berat.

Referuar procesverbalit nr. 133, datë 16.02.2021, rezulton se ankuesi në këtë datë ka kryer dorëzimin e detyrës dhe vulës së institucionit.

Ditën e përfundimit të raportit shëndetësor, ankuesi me shkresën datë 05.04.2021, drejtuar DROSHKSH Elbasan, ka refuzuar Urdhrin nr. 16, datë 12.02.2021 për lirimin e tij nga pozicioni

Drejtor dhe kalimin në pozicionin Shef Shërbimi, me arsyetimin se e konsideron urdhrin e paligjshëm dhe në shkelje të dispozitave të Kodit të Punës.

NJVKSH Berat me shkresën nr. 265, datë 06.04.2021 ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me A. B në pozicionin si Shef Sektori.

Ankuesi kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës është bërë në kohë të papërshtatshme dhe ka ndodhur për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- VKM-së nr. 419, datë 04.07.2018 “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor*”;
- Udhëzimit nr. 673, datë 02.10.2019 “*Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH*”, të ndryshuar, të MSHMS.

KONKLUSIONE

Lidhur me argumentimin e DROSHKSH Elbasan se ndryshimi i pozicionit të punës të ankuesit është bërë duke vlerësuar detyrat e NJVKSH Berat i cili është një institucion i angazhuar në diagnostikimin e sëmundjes infektive COVID 19, duke konstatuar gjendjen shëndetësore të A. B., dhe shprehjen e interesit të tij për të punuar si “Mjek Dermatolog” në Spitalin Rajonal Berat; Komisioneri vlerëson se:

- Momenti i ndryshimit të pozicionit të punës të ankuesit nga “Drejtor” në “Shef Shërbimi” në NJVKSH Berat, është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët e saj.

Pra, çdo ndryshim i kushteve të kontratës, pa miratimin e punëmarrësit do të konsiderohet zgjidhje e kontratës në mënyrë të njëanshme. Në këtë kontekst, ndryshimi i pozicionit të punës së ankuesit përbën ndryshim të kontratës së punës në dëm të tij si punëmarrës dhe nuk është i vlefshëm për sa kohë ai nuk ka rënë dakord me të. Përkundrazi, rezultoi e provuar dhe dokumentuar se ankuesi e ka refuzuar/kundërshtuar atë shkresërisht në rrugë administrative dhe gjyqësore.

DROSHKSH Elbasan ka parashtruar si argument para Komisionerit se, ndryshimi i pozicionit të punës së ankuesit është bërë pasi ai gjatë periudhës që ka qenë me raport shëndetësor ka qenë në punë por jo për menaxhimin dhe organizimin e punës së Sektorëve të institucionit.

Lidhur me këtë qëndrim të DROSHKSH Elbasan, Komisioneri konstaton se ai është tërësisht i njëanshëm, i pambështetur ligjërisht dhe i pabazuar në dokumentacion, pasi nga ana e DROSHKSH Elbasan nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit asnjë dokument që të provonte se drejtuesi i OSHKSH Berat, kishte penguar kryerjen e detyrave funksionale të institucionit.

Gjithashtu, rezultoi se kontrata e punës me ankuesin ka përfunduar gjatë kohës që ai ishte me raport paaftësie të përkohshme, pra në një kohë të papërshtatshme dhe punëdhënësi nuk mund ti ndryshonte kontratën deri sa të përfundonte raporti shëndetësor në datë 05.04.2021.

Bazuar në sa më sipër, rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, si dhe duke iu referuar faktit se veprimet e punëdhënësit ndaj ankuesit janë kryer në periudhën kur ankuesi ka qenë me raport paaftësie të përkohshme në punë, si dhe në kushtet e mungesës së një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm nga punëdhënësi të këtyre veprimeve, Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për largimin nga puna të ankuesit por është e lidhur me gjendjen shëndetësore të ankuesit. Në konkluzion, Komisioneri konstaton se DROSHKSH Elbasan, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim për shkak të gjendjes shëndetësore.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit A. B., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan.
- Në referim të pikës 1, Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

X. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR

I. B. kundër Shkollës Jopublike, Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër

VENDIM NR. 56, Datë 12.04.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (Ankimimi për diskriminim pranë KMD-së)
Forma: Diskriminim në formën e viktimizimit
Fusha: Punësim
Statusi: Vendimi i paankimuar.

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Shkollën Jopublike, Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër. Ndaj tij është marrë masë për largim nga puna për shkak se është ankuar për diskriminim kundër Shkollës tek Komisioneri, duke e viktimizuar atë.

FAKTET

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Shkollën Jopublike, Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër. Ai ka qenë mësues fiskulture prej vitesh në këtë institucion dhe ndaj tij është marrë masa për largim nga detyra duke zgjidhur marrëdhëniet e punës, pikërisht pas ankimimit të tij për diskriminim tek Komisioneri.

Ankuesi ka pretenduar se motivacioni i përdorur nga punëdhënësi për largimin e tij nga detyra nuk qëndron dhe se largimi i tij është bërë për t’u hakmarrë për ankimimin e tij për diskriminim tek Komisioneri.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se nga ana e Medresesë nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit nuk kanë ndodhur pas ankimimit të tij për diskriminim të ish-punëdhënësit/Medresesë, pranë Komisionerit, apo që ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale të justifikuara dhe objektive.
- Përkundrazi, u provua e kundërta, që ankuesi është larguar nga puna, vetëm një muaj pas vendimmarrjes së Komisionerit dhe konstatimit të diskriminimit nga ky i fundit.
- Për më tepër, megjithëse në njoftimin e zgjidhjes së kontratës të punës me Shkollën/Medresenë, citohet se arsyeja e largimit të tij nga puna është ristrukturimi i Institucionit, punëdhënësi nuk depozitoi asnjë akt shkresor për të provuar se ristrukturimi kishte ndodhur realisht, duke shkurtuar numrin e punonjësve dhe për më tepër sa do të ishte numri i punonjësve (nga stafi i mësuesve) që do të largoheshin nga puna; cilat do të ishin kriteret mbi bazën e të cilave do të realizohej ristrukturimi dhe përzgjedhja e punonjësve (mësuesve) të cilët do të vazhdonin punën dhe atyre që do të largoheshin nga puna; cila ishte procedura, afatet dhe strukturat/personat e ngarkuar me procesin e ristrukturimit; dhe si ishte vlerësuar përmbushja e kriterëve, kualifikimi dhe performanca në punë e ankuesit në raport me personat e tjerë.
- Gjatë shqyrtimit të ankesës Medreseja nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se nevoja për rivlerësimin e marrëdhënies së punës me ankuesin kishte si shkak ristrukturimin e këtij Institucioni/shkurtimin e numrit të stafit pedagogjik të tij.
- Medreseja nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të saj, se shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin ishte ristrukturimi.

Po ashtu, Komisioneri vlerësoi se, procedura e ndjekur për largimin e ankuesit nga puna është në shkelje të parashikimeve ligjore, pasi:

- Shkolla nuk ka provuar me dokumentacion që të ketë ndjekur një procedurë të rregullt ligjore, sa i takon afateve, mënyrës së njoftimit të ankuesit për bisedimet për zgjidhjen e kontratës së punës, mundësisë që ai të parashtronte kundërshtimet e veta lidhur me këtë masë apo mundësisë që ai të mbrohej efektivisht kundrejt tij.
- Përkundrazi ankuesit i është komunikuar largimi nga puna, në ditën e parë të punës, të vitit shkollor 2022-2023, ditë kur ai ishte paraqitur për të filluar punën normalisht.
- Është shkelur e drejta e subjektit ankues për të pasur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ndaj masës ekstreme të largimit nga puna, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht i njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e Shkollës/Medresesë.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në *formën e viktimizimit*, kundrejt subjektit ankues I. B., nga ana e Shkollës Jopublike, Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër, për shkak të ankimimit të tij për diskriminim, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

F. Ll. kundër Ministrisë së Kulturës, Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kombëtare dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër

VENDIM NR. 110, Datë 20.06.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër¹¹”
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mosrestaurimi i banesës së ankuesit dhe rrezikimi për shembje të saj, e cila ka status të veçantë dhe mbrohet nga ligji, diskriminon ankuesin për shkak të statusit që gëzon, duke i mohuar të drejtën për gëzim të banesës në mënyrë të sigurt dhe të qetë.

FAKTET

Ankuesi ka në pronësi një banesë e cila ka status të veçantë dhe mbrohet nga ligji. Shtëpia ka nevojë për ndërhyrje emergjente sepse si pasojë e hyrjes së shiut nga çatia rrezikohen disa piktura që janë në shtëpi. Ankuesi ka bërë kërkesa të herëpashershme tek institucionet përkatëse, përfshirë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër për të ndërhyrë për restaurimin e shtëpisë, qoftë edhe me paratë e tij por nuk më është dhënë leja përkatëse.

Shtëpia ku banon ankuesi gëzon status të veçantë nuk lejohet të ndërhyhet nga vetë ankuesi, por duhet miratim i posaçëm nga shteti (përfshirë edhe fondet për këtë çështje). Nisur nga kjo situatë e vështirë, ankuesi pretendon se diskriminohet në mënyrë të qëllimshme nga ana e këtyre institucioneve pikërisht nisur nga historiku i familjes së tij, si familje e cila ka qenë e përndjekur politikisht, dhe mosveprimi i autoriteteve shtetërore është i qëllimshëm.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Kodi Civil;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;

¹¹ Statusi i veçantë ligjor që gëzon ankuesi si posedues banesës “H. Ll”, shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë.

- VKM nr. 531, datë 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”.

KONKLUZIONE

Bazuar në kompetencat e parashikuara në ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, IKTK, është njësia përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve, me të cilat bashkëpunon dhe bashkërendon punën në fushën e trashëgimisë kulturore. Në këtë kontekst, lidhur me problematikën objekt shqyrtimi, IKTK është informuar nga DRTK Shkodër për gjendjen alarmante të “Banesës H. Ll” dhe për nevojën e ndërhyrjes emergjente të saj, duke e dokumentuar edhe me aktet provuese.

IKTK¹² ka mbajtur të njëjtin qëndrim me DRTK Shkodër, duke evidentuar problematikën e mosdorëzimit nga ana e subjektit ankues të dokumentacionit lidhur me pronësinë e banesës, i cili duhet të jetë sipas kërkesave ligjore dhe i freskuar, gjë që, në mungesë të dorëzimit të tij nga Ll/poseduesi i kësaj pasurie, është bërë pengesë për vijimin e procedurës për aplikimin e miratimit të projektit për ndërhyrje në banesën në fjalë monument kulture, pranë organit kompetent që është KKTKM, pranë Ministrisë së Kulturës.

Ministria e Kulturës ka qenë në dijeni të kësaj problematike të banesës në fjalë, pasi është informuar në vijimësi lidhur me nevojën e ndërhyrjes emergjente për shkak të rrezikut evident për shembjen e saj, dhe po ashtu rrezikut potencial për shembje të pjesshme edhe të banesës “H. Ll”, banesa këto të dyja të shpallura monumente kulture të kategorisë së I-rë, pasuri kulturore të mbrojtura nga shteti.

Bazuar dhe në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, pavarësisht faktit nëse ankuesi ka paraqitur apo jo dokumentacionin për provimin e pronësisë mbi banesën, sipas formës së kërkuar nga ligji, vetë ligji ka paraprirë dhe parashikuar edhe rastet kur pronari apo poseduesi i pasurisë së shpallur monument kulture, refuzon, nuk pranon ndërhyrjen në banesën e tij.

Komisioneri vlerësoi se, legjislacioni ka parashikuar se, në raste të tilla (aq më tepër në këtë rast që ankuesi insiston që të merren masa për ndërhyrje në banesën objekt ankese dhe ia ka bërë të ditur organeve kompetente këtë fakt) është shteti që duhet të ndërhyjë edhe *kryesisht* me iniciativën e tij, kur vlerëson se banesa është në kushtet e nevojës emergjente për ndërhyrje, bazuar në pikën 2, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2028 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

Komisioneri theksoi faktin se, vetë Ligji është kujdesur të përcaktojë të dyja këto kategori subjektsh: si *pronarët* ashtu dhe *poseduesit* e banesave, duke njohur e konsideruar edhe

¹² Procedura për aplikimin është e publikuar në e-Albania:

https://e.albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=708&service_type=Y

problematikat ligjore e faktike në lidhje me çështjet e pronësisë së kësaj kategorie banesash, (një pjesë e madhe e tyre disa qindra vjeçare). Ligji njeh kësisoj si subjekt të tij, edhe *poseduesin* e banesës, në kuadër të të drejtave e detyrimeve pronësore mbi të.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerësoi se, ministria përgjegjëse, MK, në këtë rast, do të duhej që nëpërmjet akteve nënligjore të saj, të kishte parashikuar e rregulluar edhe rastet kur banesa monument kulture nuk ka *pronar formal*, por gjithsesi ka një *posedues*, dhe më tej kryerjen e procedurave vijuese.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se pretendimi i subjektit ankues lidhur me neglizhencën dhe mosveprimin e institucioneve respektive shtetërore për të marrë masa emergjente efektive lidhur me degradimin e monumentit të kulturës “Banesës Xh. Ll” në një kulm me banesën e tij, është mëse i drejtë dhe i bazuar.

Nga këqyrja dhe analizimi i deklarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga IKTK dhe MK, Komisioneri evidentoi se ato nuk kanë marrë masat e nevojshme efektive në kushtet e emergjencës të situatës degraduese (të cilën vetë e pohojnë dhe dokumentojnë si të tillë) të “Banesës Xh. Ll”, e cila përveçse rrezikon të shembet vetë, rrezikon po ashtu edhe “Banesën H. Ll”, (të cilën e posedon ankuesi).

Nga komunikimi me këto institucione (IKTK dhe MK), vërehet se ato vetëm kanë informuar Komisionerin lidhur me situatën alarmante të banesës në fjalë, dhe në asnjë moment edhe pse Komisioneri ofroi mundësinë për ndërmjetësim mes palëve, me qëllim për të zgjidhur këtë problematikë me mirëkuptim dhe bazuar në kompetencat e përgjegjësitë ligjore të tyre, ata nuk ndërmorën asnjë hap konkret e efektiv që të dëshmonte vullnetin për të ndërhyrë sa më parë tek ky objekt/ banesë monument kulture i kategorisë së I-rë.

Në përfundim të analizës së tij, Komisioneri gjykoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e IKTK dhe MK (në varësi të së cilës është organi vendimmarrës KKTKM).

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, F. Ll., në fushën e të mira dhe shërbimeve, për shkak të statusit të veçantë ligjor që gëzon ai, *si posedues* i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë, nga ana e Ministrisë së Kulturës (MK) dhe Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kombëtare (IKTK).
- Në referim të pikës 1, institucionet përgjegjëse MK dhe IKTK, të marrin masa efektive për ndërhyrjen urgjentisht në banesat e shpallura monument kulture të kategorisë së I-rë, “Banesa Xh. Ll” dhe “Banesa H. Ll”, sipas nevoja specifike.

P. S. kundër znj. S.G, Rektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

VENDIM NR. 128, DATË 12.07.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër/“konstatimi i problematikave, mbajtjes së qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimit të situatave të pretenduara në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit nga ana e ankuesit.”

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, duke mos i marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi ndaj studentes, për shkak të konstatimit të problematikave, mbajtjes së qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit si dhe denoncimit të situatave të pretenduara në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit nga ana e ankuesit.

FAKTET

Ankuesi punon në pozicionin e pedagogut pranë Fakultetit të Ekonomik, të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Ankuesi pretendon se diskriminimi i tij nga ana e strukturës drejtuese të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, është e lidhur me disa ngjarje të ndodhura në këtë universitet, si pasojë e ankesës së një studenteje ndaj tij, për një ngjarje të stisur, kundër të cilës ai ka kërkuar që të merret masa disiplinore, por ankesat e tij nuk janë marrë në shqyrtim.

Rezulton se gjatë viteve 2021-2022, në disa raste ankuesi gjatë detyrës së tij si pedagog ka konstatuar problematika, ka mbajtur qëndrime kritike dhe ka denoncuar situata të pretenduara në kundërshtim me ligjin, që kanë lidhje me shkeljen e të drejtave të studentëve, si dhe politikat dhe mbarëvajtjen e punës në këtë universitet, duke përfshirë ndër të tjera çështje që kanë të bëjnë me tarifat e studentëve, mosfrimin e ngrohjes për studentët, përllogaritjen e gabuar të të ardhurave dhe shpenzimeve, problematika në lidhje me zbatimin e rregullores së studimeve në universitet, keqmenaxhimin i cili ka shkaktuar rënien e numrit të studentëve, duke rrezikuar mbylljen e degëve.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar;

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Kodi i Punës;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri vlerëson se, duke mos marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi, Rektorja e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshilli i Etikës, kanë cenuar të drejtën e tij për të pasur një shqyrtim të pretendimeve të tij për cenim të interesave dhe reputacionit të tij nga sjelljet joetike e studentes. Në këtë kuadër, ankuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke iu mohuar të drejtat bazë të këtij procesi siç janë, e drejta për t’u njohur me faktet, provat, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e Rektores së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshillit të Etikës, pranë këtij universiteti, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, në kuadër të marrëdhënieve të punës.

Rektorja e USHLG, nuk arriti të provojë se mosmarrja në shqyrtim e ankesave të paraqitura nga ankuesi kundër studentes nuk kishte asnjë lidhje shkakësore me shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, ndërsa justifikimet e paraqitura në lidhje me mostrajtimin e këtyre ankesave rezultuan plotësisht të pabazuara. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Rektores së USHLG, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi në lidhje me mosmarrjen në shqyrtim të ankesave të tij kundër studentes, mbetet shkakun i diskriminimit.

Në lidhje me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe jo të barabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi nga ana e KE, bazuar në tërësinë e provave të administruara, Komisioneri gjykon se, nuk jemi në kushtet që mund të prezumohet se një trajtim i tillë nga ana e KE ka ardhur për shkakun e mbrojtur. Problematikat e konstatuara, qëndrimet apo denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra nga ankuesi nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e KE, si një organ kolegjal i ngarkuar me shqyrtimin e pretendimeve për shkelje të Kodit të Etikës. Çështjet që ankuesi adreson ndaj një prej anëtarëve, janë të pamjaftueshme për të ngritur prezumimin për diskriminim, në kushtet kur KE është një organ kolegjal. Nga ana tjetër, bazuar në provat e administruara, nuk provohet se, vendimmarrja e KE është marrë në kushtet e ndikimit apo udhëzimeve të rektores .

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit P.S., nga ana e znj. S.G., Rektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në të drejtën për punësim, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij kundër studentes, për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, duke mos i marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi ndaj studentes, për shkak të konstatimit të problematikave, mbajtjes së qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit si dhe denoncimit të situatave të pretenduara në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit nga ana e ankuesit.
- Rektorja e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe të gjitha strukturat përgjegjëse pranë këtij Universiteti, të marrin masa për të mos përsëritur në të ardhmen situata të ngjashme dhe për të trajtuar me efektivitet dhe mbi baza të barabarta çdo ankesë që paraqitet nga çdo subjekt i Kodit të Etikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Të merren masa nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për trajtimin e ankesave të ankuesit adresuar organeve të Universitetit.
- Të merren masa nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për hartimin e një Kodi Etike të qartë me procedura dhe afate të qarta, për trajtimin e ankesave me efektivitet dhe transparencë.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit P.S., nga ana e Këshillit të Etikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

A. D. kundër Shoqërisë “Illyrian Guard” sh. a. Tiranë

VENDIM NR. 156, DATË 07.08.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (Konfliktet me Administratorin për shkak të denoncimit të tij tek Ministri)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Illyrian Guard” sh. a, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë. Ankuesi është diskriminuar nga ana e Administratorit të Shoqërisë, duke e larguar nga detyra në shenjë hakmarrjeje, për shkak se ai ka kundërshtuar zbatimin e praktikave dhe procedurave të kundraligjshme.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Illyrian Guard” sh. a, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë.

Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit/Administratorit të kësaj Shoqërie, duke e larguar nga detyra në shenjë hakmarrjeje. Pas vetëm 5 (pesë) muaj nga emërimi i tij në detyrë, ndaj ankuesit është ndërmarrë një praktikë përjashtuese, duke e kufizuar atë në kryerjen e detyrës si Drejtor i Përgjithshëm i Sigurisë. Ankuesi ka pretenduar se sjellja diskriminuese ndaj tij ka ndodhur për shkak se ai ka kundërshtuar zbatimin e praktikave dhe procedurave të kundraligjshme në mënyrën e organizimit të punës dhe për shkak të presionit të ushtruar nga ana e Administratorit për zbatimin e tyre.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se punëdhënësi nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, lidhur me procedurën e ndjekur për lirim të tij nga detyra.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se, punëdhënësi nuk ka provuar se:

- Ankuesit t'i ishin komunikuar e bërë të ditura shkeljet e pretenduara;
- Që atij t'i ishte krijuar mundësia për t'u njohur me aktet e paraqitura kundër tij, (siç ishte rasti i ankesave të depozituara kundër tij, për të cilat ai as nuk ka patur dijeni, as nuk është njohur, e aq më tepër t'i ishte dhënë mundësia që ai të parashtronte variantin e tij të rrethanave, ngjarjeve e fakteve);
- Që ai të ketë ballafaquar apo pyetur të dyja palët (ankuesin dhe personat që kishin depozituar ankesa për të), apo të ketë dalë në konkluzione mbi bazë provash lidhur me sa është pretenduar në ato ankesa, por punëdhënësi ka marrë të mirëqena vetëm deklaratimet e njërës palë, duke shprehur dukshëm njëanshmëri në këtë proces;
- Ankuesi është njohur me to, formalisht, vetëm kur i është komunikuar shkresa për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të;
- Ankuesi nuk ka pasur asnjë mundësi reale për t'u mbrojtur efektivisht nga masa ekstreme e dhënë nga punëdhënësi kundrejt tij, duke i zgjidhur marrëdhëniet e punës në mënyrë të menjëhershme me të, për më tepër kur ai nuk ka justifikuar e provuar se është në plotësim të këtij kushti, pra në rrethanat e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës¹³.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstatoi se, nisur nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative subjektit ankues nga ana e punëdhënësit i kanë ardhur pas dhe për shkak të konfliktit që është krijuar mes tyre për shkak të kundërshtimit të zbatimit të disa praktikave e urdhrave të dhëna prej tij, gjë për të cilën ai është ankuar edhe pranë Ministrit të Brendshëm. Ky fakt jo vetëm është pranuar nga punëdhënësi, por i ka shërbyer atij edhe si një ndër arsytet për të justifikuar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri, gjykoi se, veprimet e punëdhënësit (lirimi i tij nga detyra) haptazi ka qenë i motivuar pikërisht nga ky konflikt mes tyre dhe si shkak i ankesës së tij kundër Administratorit tek Ministri i Brendshëm, dhe se atij i është cenuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta për punë dhe e ushtrimit të detyrës.

¹³ Referuar analizës së pjesës A, të Vendimit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, A. D., në të drejtën për punësim, për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, nga ana e Administratorit të Shoqërisë “Illyrian Guard” sh.a.
- Në referim të pikës 1, Administratori i Shoqërisë “Illyrian Guard” sh. a, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

M. K. kundër Spitalit Rajonal “Memorial” Fier

VENDIM NR. 170, Datë 28.08.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (ka vënë në dijeni drejtuesit e institucionit për pasaktësitë dhe shkeljen e ndodhur në procedurën e prokurimit të zhvilluar në institucion)

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, në pozicionin si farmacistë. Asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak se ka vënë në dijeni drejtuesit e institucionit ku parashtrohej problematika lidhur me datën e skadencës për produktet e pranuar në farmaci në prokurimin për kite dhe reagentë për nevoja spitalore.

FAKTET

Me Urdhrin nr. 258, datë 30.08.2021 M. K., është emëruar me detyrë Farmaciste në Shërbimin e Farmacisë pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier dhe mes palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës me afat të pacaktuar me nr. 669/1, datë 01.09.2021.

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në përfundim të programit të auditimit, me shkresën nr. 5249/8, datë 11.11.2022, ka dërguar Raportin Final të Auditimit të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.

Në zbatim të rekomandimeve si më sipër, Spitali Fier me Vendimin nr. 1, datë 01.12.2022 “Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të FSDKSH”, ka miratuar planin e veprimit sipas të cilit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është ngarkuar të zbardhë masat disiplinore “Vërejtje” për punonjësit të cilët nuk kanë përmbushur detyrat përkatëse, sipas gjetjeve të reflektuara në Raportin Final të Auditimit të FSDKSH, konkretisht edhe për farmacistët, M. K., dhe R. F.

Me Vendimin nr. 17, datë 02.12.2022 “Për dhënie mase disiplinore” ndaj punonjësës, M. K., është dhënë masë disiplinore “Vërejtje” për mospërmbushje të detyrave përkatëse sipas gjetjeve të reflektuara në Raportin Final të Auditimit të FSDKSH.

Me Urdhër nr. 123, datë 17.11.2022, Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit Fier ka krijuar grupin e punës për verifikimin dhe kontrollin e farmacisë spitalore për periudhën nga data 01.09.2022 deri me datë 17.11.2022.

Me Urdhrin nr. 142/1, datë 04.01.2023 *“Për ngritjen e komisionit të pritjes dhe marrjes në dorëzim të “Kite dhe reagente për nevoja spitalore”*”, Drejtori i Përgjithshëm ka ngritur Komisionin për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave për procedurën e prokurimit *“Blerje kite dhe reagent për nevoja spitalore”* në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 1157/9, datë 02.09.2022 me përbërje: D. Ç, laborante, Kryetare; M. K, farmacist, Anëtare dhe K. K, Përgjegjëse e financës, Anëtare.

Ankuesja me *e-mail-in* datë 17.01.2023, drejtuar Drejtores së Përgjithshme të Spitalit, Drejtores Juridike dhe të Prokurimeve dhe Përgjegjëses së Sektorit Juridik ka informuar për parregullsitë dhe si duhet të veprojnë për materialet e sipër përmendura të cilat nuk plotësojnë specifikimin në lidhje me datën e skadencës.

Me shkresën nr. 150, datë 25.01.2023 *“Njoftim për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”*, Spitali Fier ka njoftuar ankuesen për zgjidhjen e kontratës së punës për shkelje të dispozitave të kontratës individuale të punës, neni 13/1, germa a) *“Punëmarrësi është i paaftë nga ana profesionale për kryerjen e punës së caktuar”* dhe neni 5, pika 1: *“Punëmarrësi do të kryejë detyrat e tij duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme dhe të posaçme të punëdhënësit, në përputhje me kontratën e lidhur me Spitalin Rajonal Memorial Fier, Rregulloren e Spitalit, Kodin e Etikës si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Punëmarrësi do të jetë ekskluzivisht në dispozicion të punëdhënësit gjatë orarit të përcaktuar për kryerjen e detyrave të parashikuara në këtë kontratë dhe në aktet e tjera”. Afati i zgjidhjes së kontratës është një muaj”*.

Me Vendimin nr. 24, datë 20.02.2023 *“Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”*, Spitali ka vendosur zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për M. K me arsyen për braktisje të vendit të punës për më shumë se 7 ditë pa njoftim dhe pa shkak të ligjshëm dhe marrëdhëniet juridike të punës ndërpriten me datë 20.02.2023.

Me Vendimin nr. 2, datë 25.01.2023 *“Për dhënie masë disiplinore”*, Spitali Fier ka njoftuar farmacistin R. F., për masën disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”* për shkelje të dispozitave të kontratës individuale të punës, neni 5, pika 1: *“Punëmarrësi do të kryejë detyrat e tij duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme dhe të posaçme të punëdhënësit, në përputhje me kontratën e lidhur me Spitalin Rajonal Memorial Fier, Rregulloren e Spitalit, Kodin e Etikës si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Punëmarrësi do të jetë ekskluzivisht në dispozicion të punëdhënësit gjatë orarit të përcaktuar për kryerjen e detyrave të parashikuara në këtë kontratë dhe në aktet e tjera. Afati i zgjidhjes së kontratës është një muaj”*.

Ankuesja pretendon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të *e-mail-it* të dërguar drejtueses së spitalit ku parashtrohej problematika lidhur me datën e skadencës për produktet e pranuar në farmaci në prokurimin për kite dhe reagentë për nevoja spitalore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokolli 12 i saj;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë;
- Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Bazuar në dispozitat e Kodit të Punës, parashikohet se punëdhënësi nuk mund japë masa disiplinore dhe të zgjidhë kontratën e punës pa dhënë më parë arsyet me shkrim për zgjidhjen e kontratës. Referuar nenit 144/3, të Kodit të Punës, arsyet për të cilat një punëdhënës mund të zgjidhë kontratën e punës duhet të jenë të lidhura me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes. Në momentin që punëdhënësi vendos të ndërpresë marrëdhënien e punësimit me punëmarrësin ai duhet ta bëjë atë konform një procedure të përcaktuar dhe të parashikuar nga Kodi i Punës.

Parashikimet ligjore sipërcituar janë shkelur e keq zbatuar në këtë rast nga punëdhënësi lidhur me dhënien e masave disiplinore: “Vërejtje” nr. 17, datë 02.12.2022 dhe “Njoftim për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës” nr. 150, datë 25.01.2023 për ankuesen, pasi asaj nuk i është garantuar e drejta për t’u njohur e vënë në dijeni me faktin se ndaj saj kishte filluar një ecure disiplinore, e drejta për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova në favorin e vet apo për t’i kundërshtuar në gjykatë.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se Spitali Fier, ka nxjerrë vendimin për masën disiplinore vërejtje për ankuesen, por nuk rezulton se ankuesja ka marrë dijeni për këtë shpresë. Gjithashtu, Spitali Fier nuk arriti të provojë se ka realizuar ndonjë takim me ankuesen ku t’i ketë dhënë mundësinë kësaj të fundit që të dëgjohet dhe të mbrojtë interesat e saj të ligjshëm.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, pa marrë në konsideratë faktin nëse pretendimet e punëdhënësit kundrejt ankueses qëndrojnë apo jo, shkelja e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, ka cenuar rëndë të drejtat e saj si punëmarrëse për një proces të rregullt, të drejtë e ligjor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët rezulton se në Shërbimin e Farmacisë së Spitalit kanë qenë të punësuar dy farmacistë me detyra dhe përshkrim pune të njëjtë. Gjithashtu, rezulton se raporti i auditit të FSDKSH dhe relacioni i grupit të punës për verifikimin dhe kontrollin e farmacisë spitalore kanë evidentuar shkelje të njëjta për personelin e Shërbimit të Farmacisë. Ndërkohë që rezulton se janë marrë masë disiplinore “Vërejtje” për të dy farmacistet në datë 02.12.2022 dhe masa të ndryshme për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen dhe vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna për farmacisten R. F.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe parashtrimit të palëve, rezulton se detyrat dhe përgjegjësitë e farmacistit janë të njëjta për të dy farmacistet pavarësisht vjetërsisë në punë, e cila nuk ka qenë kusht për tu punësuar në Spitalin Fier, gjithashtu dhe shkeljet e konstatuara nga kontrolli i auditit të FSDKSH dhe grupi i punës i spitalit kanë arritur në përfundime se mungesat dhe tepricat janë konstatuar në Shërbimin e Farmacisë, pa specifikuar përgjegjësitë për secilën nga farmacistet dhe në këto kushte dhe masat disiplinore nga ana e Spitalit duhet të ishin të njëjta për të dy farmacistet.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstaton se, nisur nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e punëdhënësit i kanë ardhur pas vënies në dijeni të drejtueses së institucionit për problematikën lidhur me datën e skadencës për produktet e pranuar në farmaci, në prokurimin për kite dhe reagentë për nevoja spitalore dhe sepse ky është shkaku i vetëm që ankuesja është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me farmacisten tjetër lidhur me dhënien e masave të ndryshme disiplinore për mospërbushje të detyrës funksionale.

Në përfundim, Komisioneri konstaton se Spitali Rajonal “Memorial” Fier, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën për punësim, pasi zgjidhja e kontratës së punës, është marrë në kundërshtim flagrant të procedurës përkatëse për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nga ana e punëdhënësit dhe e motivuar për shkak të vënies në dijeni të drejtueses së institucionit mbi problematikën e materialeve të prokuruar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankueses M. K., në të drejtën për punësim, për shkak të vënies në dijeni të drejtueses së institucionit mbi problematikën e materialeve të prokuruar, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, nga ana e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.
- Në referim të pikës 1, Spitali Rajonal “Memorial” Fier, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

S. L. kundër Rektores së Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër

VENDIM NR. 202, Datë 13.10.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (Ankimimi për diskriminim pranë KMD-së)
Forma: Diskriminim në formën e viktimizimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Universitetin e Shkodrës. Ankueses i është refuzuar dhënia e lejes së zakonshme në periudhën e kërkuar, për shkak se ka paraqitur ankesë për diskriminim kundër Universitetit tek Komisioneri, në kuadër të një ankese të mëparshme.

FAKTET

Ankuesja është në marrëdhënie pune me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ajo ka parashtruar se ka kërkuar të marrë lejen e zakonshme për arsye familjare dhe i është refuzuar nga Rektorja e Universitetit.

Ankuesja pretendon se mohimi i lejes nga Rektorja është bërë me qëllimin për ta detyruar të ikë nga puna, si dhe është një veprim që bëhet në vazhdimësi të masave penalizuese kundrejt saj, në ndryshim nga punonjësit e tjerë. Ajo pretendon se është diskriminuar nga Rektorja e Universitetit, duke mos i miratuar lejen e zakonshme, pikërisht si hakmarrje për shkak të ankimit të saj pranë Komisionerit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- VKM nr. 568, datë 06.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore*”.

KONKLUZIONE

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se nga ana e Rektores të USH-së nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankueses nuk kanë ndodhur pas ankimimit të saj për diskriminim të punëdhënësit/Rektores të USH-së, pranë Komisionerit apo që edhe pse kanë ndodhur kronologjikisht, ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm¹⁴.
- Përkundrazi, u provua e kundërta, që ankueses i është mohuar e drejta për ezaurimin e lejes vjetore të planifikuar, vetëm dy muaj pas ankimimit të saj pranë Komisionerit, lidhur me pretendimin për diskriminim në marrëdhëniet e punës, nga ana e USH-së, në mënyrë të pabazuar e të justifikuar objektivisht.
- Gjatë shqyrtimit të ankesës USH, nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar e faktuar deklarimin e Rektores së USH-së, se arsyeja e refuzimit të miratimit të lejes vjetore për subjektin ankues, lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me ngarkesën në punë të saj, gjatë periudhës 15 Maj-12 Qershor 2023, si dhe Sektorit në të cilin ajo ushtronte detyrën, e për më tepër që mungesa e saj në këtë periudhë të përbënte shkak për cenimin e vijueshmërisë së punës së Sektorit, pjesë e të cilit ajo ishte.

Po ashtu, Komisioneri vlerësoi se, vendimmarrja e Rektores të USH-së, lidhur me refuzimin e miratimit të lejes vjetore për ankuesen, është në shkelje të parashikimeve ligjore, pasi:

- Është shkelur e drejta e subjektit ankues për të gëzuar lejen vjetore të kërkuar prej saj, sipas parashikimeve në aktete ligjore e nënligjore përkatëse. Ajo ka ndjekur e zbatuar edhe procedurën përkatëse lidhur me formalizimin e paraqitjen e kërkesës për lejen vjetore, duke e paraqitur më shumë se një muaj para afatit të kërkuar prej saj, duke njohur punëdhënësin edhe më arsyen e veçantë familjare për të cilën e kërkonte specifikisht në këto data (duke konsideruar se një ngjarje e tillë si lindja e fëmijës të vajzës së ankueses nuk mund të shtyhej a përcaktohej nga vullneti e dëshira e ankueses për një datë tjetër të mëvonshme).
- Rektorja e USH-së, nuk ka provuar e dokumentuar se vendimmarrja e saj lidhur me refuzimin e lejes vjetore të ankueses është e justifikuar dhe bazuar mbi fakte të vërteta. Justifikimi lidhur me ngarkesën e punës së ankueses dhe Sektorit ku ajo ushtronte detyrën, është analizuar më sipër nga Komisioneri, duke vlerësuar se është i pabazuar, i njëanshëm dhe i paragjykuar prej saj, për faktin se refuzimi është firmosur para se ajo të informohej dhe të kishte dijeni për ngarkesën e ankueses, si dhe për faktin se refuzimi ishte tërësisht i pa justifikuar objektivisht, e i pa bazuar në fakte e prova.

¹⁴ Për analogji citojmë vendimmarrjet e Komisionerit lidhur me konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, ardhur si pasojë e ankimimeve të ankuesve për diskriminim, si: Vendimin nr. 120, datë 05.10.2020, Vendimin nr. 86, datë 26.05.2021; Vendim nr. 254, datë 28.12.2021, Vendimin nr. 56, datë 12.04.2023, etj.

- Po ashtu, rezultoi e provuar se përkundrejt faktit se ka një praktikë që ndiqet nga USH lidhur me periudhat e dhënies së lejeve vjetore për punonjësit e saj, USH, për disa punonjës (cituar dhe analizuar në faqen 15, të Vendimit) ka vlerësuar rast pas rasti të miratojë lejet vjetore të kërkuara prej tyre, në periudha të cilat përkohë përfaqësojnë më së miri të kërkuar nga ankuesja (jashtë periudhave që lejet vjetore ezauroheshin sipas praktikës së krijuar ndër vite nga USH). Pra, sikurse rezultoi, ankueses në ndryshim nga këta punonjës, nuk i është miratuar leja vjetore e kërkuar, ndonëse kishte deklaruar edhe arsyen e veçantë familjare.

Në analizë të gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se refuzimi i miratimit të lejes vjetore të ankueses është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar, si dhe në mungesë të koherencës së deklarimeve e veprimeve administrative të Rektores së USH-së.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, punëdhënësi nuk arriti të justifikojë objektivisht e në mënyrë të arsyeshme, bindëse e më prova, faktin se mosmiratimi i lejes vjetore të ankueses kishte ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe të Sektorit ku ajo ushtronte detyrën dhe se mungesa e saj cenonte vijueshmërinë e punës së këtij Sektori.

Përfundimisht, Komisioneri vlerësoi se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, se refuzimi i miratimit të lejes vjetore për të, është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive, si dhe në shkelje të plotë të procedurës ligjore që duhet ndjekur për miratimin e lejeve vjetore të punonjësve.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, kundrejt subjektit ankues S. L nga ana e Rektores së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për shkak të ankimimit të saj për diskriminim, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

J. M. kundër Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)

VENDIM NR. 251, Datë 13.12.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (Konfliktet me punëdhënësin)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja është në marrëdhënie pune me OST sh. a, në detyrën e Drejtores të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë nga ana e punëdhënësit, lidhur me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, duke e diskriminuar atë për shkak të raportimeve të problematikave të evidentuara gjatë inspektimeve në godinat e NJOSH.

FAKTET

Subjekti ankues është me profesion “*Ekonomiste*” dhe mban detyrën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, pranë OST sh. a, që prej datës 01.12.2020 e në vijim.

Ankuesja ka parashtruar në ankesën e saj se, që prej momentit të emërimit të Drejtores së re të Administratës, ndaj saj ka filluar trajtimi diskriminues duke penguar edhe në kryerjen e detyrave funksionale të saj, gjë që ka çuar në krijimin e një konflikti me natyrë pune, si pasojë e të cilit ndaj saj është dhënë një masë disiplinore “*Vërejtje*”, për të cilën deklaron se është tërësisht e stisur dhe e sajuar nga ana e Drejtores së Administratës, dhe se ajo është dhënë në shkelje të të gjitha parashikimeve ligjore lidhur me iniciimin e një procedure të rregullt disiplinore kundrejt një punonjësi.

Subjekti ankues ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues gjatë procesit disiplinor lidhur me dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, gjë që ka cenuar edhe mbarëvajtjen e punës në vijim, për të cilën ajo pretendon se ka për qëllim përshkallëzimin e masave të njëpasnjëshme disiplinore, deri në largimin e saj nga puna.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;

- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se punëdhënësi nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, lidhur me procedurën e ndjekur për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, pasi ai nuk ka provuar se:

- Ankueses i ishin komunikuar e bërë të ditura shkeljet e pretenduara;
- Që asaj t’i ishte krijuar mundësia për t’u njohur me argumentet e paraqitura kundër saj apo motivacionin e përdorur prej tij;
- Që ai të ketë ballafaquar apo pyetur të dyja palët (ankuesen dhe eproren e saj direkt, E. D., e cila dhe ka propozuar iniciimin e ecurisë disiplinore kundrejt ankueses), apo të ketë dalë në konkluzione mbi bazë provash lidhur me sa është konstatuar nga ana e ankueses në inspektimet e kryera prej saj, por punëdhënësi ka marrë të mirëqena vetëm deklaratimet e njëres palë, duke shprehur dukshëm njëanshmëri në këtë proces.

Komisioneri vlerësoi se:

- Ankuesja është njohur me to, formalisht, vetëm kur i është komunikuar marrja e masës disiplinore “Vërejtje”;
- Ankuesja nuk ka patur asnjë mundësi reale për t’u mbrojtur efektivisht nga masa e dhënë nga punëdhënësi kundrejt saj;
- Ka një kontradiktoritet dhe fiktivitet në ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e masës disiplinore të dhënë kundrejt ankueses (ankimimit të saj) nga ana e punëdhënësit, Administratorit të Shoqërisë, gjë që ngre dyshime të arsyeshme në vendimmarrjen e tij, pasi, duket se ka një konflikt interesi të anëtarëve të këtij Komisioni- të tre punëmarrës të OST sh.a, të cilët do të shqyrtonin vendimmarrjen e punëdhënësit të tyre.
- Vetë Komisioni i ngritur për shqyrtimin e vendimit të Administratorit, nuk ka zbatuar parimin e kontradiktoritetit për t’i dhënë ankueses të drejtën për t’u dëgjuar, mbrojtur e depozituar fakte e prova lidhur me gjetjet e tyre, para se Komisioni të dilte në një vendimmarrje lidhur me ankimin e saj për masën disiplinore.
- Komisioni ka shqyrtuar ankimin e ankueses, bazuar vetëm në shkresën/ankimin drejtuar Administratorit, dhe për më tepër në momentin para se ky Komision të ngrihej, nuk e legjitimon atë (Komisionin) që të mos ftojë ankuesen për t’u dëgjuar e për ta pyetur lidhur me sa është pretenduar për shkeljet e saj.
- Komisioni, në përfundim të shqyrtimit të ankimimit të J. M., ka vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e Administratorit të OST sh. a, duke vlerësuar se Vendimi nr. 86, datë 28.03.2023 “Për dhënie mase disiplinore” duhet të mbetet në fuqi.

Sa më sipër Komisioneri arriti në përfundimin se, veprimet e kryera nga Administratori, krijojnë një situatë juridike të pakuptimtë, në kushtet kur Vendimi i Administratorit “shqyrtohet” nga Komisioni i ngritur prej tij (Komisioni i përbërë nga vartës të tij), dhe Komisioni, pasi e “shqyrton” atë, e gjen të drejtë, ia përcjell po Administratorit, dhe ku ky i fundit lë në fuqi po Vendimin e tij.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstatoi se, nisur nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative subjektivit ankues nga ana e punëdhënësit i kanë ardhur pas dhe për shkak të konstatimit e raportimit të problematikave përkatëse, të evidentuara gjatë inspektimeve respektive të kryera prej saj në nënstacionet e NJOSH, në datën 01.03.2023 dhe 06.03.2023. Ky fakt jo vetëm është pranuar nga punëdhënësi, por i ka shërbyer atij edhe si një ndër arsyet për të justifikuar motivacionin e masës disiplinore “Vërejtje” kundrejt ankueses. (referuar deklarimeve dhe shkresave të depozituara pranë KMD-së dhe cituar më lart).

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri, gjykoi se, veprimet e punëdhënësit (procedura e ndjekur për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”) haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga raportimet e bëra nga ankuesja, lidhur me evidentimin e konstatimet e problematikave të shumta të godinave të NJOSH-ve.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektivit ankues, J. M., në fushën e punësimit¹⁵, për shkak të raportimit të problematikave të konstatuara gjatë inspektimit të kryer prej saj në NJOSH, në datat 01.03.2023 dhe 06.03.2023, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, nga ana e Shoqërisë OST sh. a.
- Në referim të pikës 1, Shoqëria OST sh. a, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke anuluar Vendimin nr. 86, datë 28.03.2023 “Për dhënie mase disiplinore” (“Vërejtje”) kundrejt ankueses.

¹⁵ Lidhur me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” (Vendimi nr. 86, datë 28.03.2023 i Administratorit të OST sh. a)

X. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMEN NDËRSEKTORIALE

Shoqata “Për Drejtësi Sociale” kundër Bashkisë Vlorë

VENDIM NR. 49, DATË 03.04.2023

Shkaku: Etnia, gjinia, gjendja shoqërore dhe ekonomike
Forma: Diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Të mira dhe shërbime/Strehim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja është diskriminuar në të drejtën për strehim të përshtatshëm, në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të etnisë, gjinisë, gjendjes shoqërore dhe ekonomike, si rezultat i refuzimit të kërkesës për të përfituar në kuadër të programeve të stregimit social, nga ana e Bashkisë Vlorë.

FAKTET

Bazuar në ankesën e paraqitur Shoqata “Për drejtësi sociale” nuk pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, nuk pretendon cenim të një interesave kolektive, por pretendon diskriminim në emër dhe për llogari të D. M., Në bazë të akteve të administruara rezulton se, D. M., e cila pretendon se është diskriminuar dhe në emër të të cilës, Shoqata “Për drejtësi sociale”, ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi ka dhënë pëlqimin e saj me shkrim për paraqitjen e kësaj ankese. Komisioneri vlerëson se Shoqata “Për drejtësi sociale”, legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, në emër të D. M.

D. M., e datëlindjes 08.07.1962, është banore e Bashkisë Vlorë. Ajo është me gjendje civile beqare dhe është kryefamiljare e vetme. Ajo rezulton pronare e një pasurie të paluajtshme e llojit truall me sipërfaqe 41.60 m² dhe e një ndërtese me sipërfaqe 16 m². Banesa në pronësi të D. M., përbëhet nga 1 dhomë me sipërfaqe 16 m², që përfshihet brenda një ndërtese 3 katëshe të ndërtuar pa leje nga persona të tretë. Ndërtesa 3 katëshe, është vetëdeklaruar për legalizim nga personat e tretë është skualifikuar nga procedurat e legalizimit nga Aluizni Vlorë dhe është marrë vendim për prishjen e këtij objekti të kundraligjshëm. Vendimi për prishjen e objektit 3 katësh të ndërtuar në mënyrë të paligjshme, nuk është ekzekutuar nga ana e IMT Vlorë me arsyetimin se nuk ka kapacitetet teknike për realizimin e prishjes.

Midis D. M., dhe banorëve të ndërtesës 3 katëshe ka patur marrëdhënie të tensionuara dhe mosmarrëveshje, të cilat janë konstatuar dhe kanë qenë të njohura nga Bashkia Vlorë. Duke mos patur mundësi që të shfrytëzojë pronën e saj, D. M., është larguar dhe ka marrë me qira një ambient

tjetër për banim. Në datën 10.11.2020, D. M., ka aplikuar pranë Bashkisë Vlorë, për të përfituar nga programet e strehimit social, konkretisht atë të bonusit të qirasë. D. M., nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare në lidhje me këtë aplikim. Në datën 27.01.2021, D. M., i është drejtuar sërish Bashkisë Vlorë me kërkesën për të përfituar bonus qiraje ose për t'i siguruar asaj një strehim të përshtatshëm. Edhe për këtë kërkesë, ajo nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare. Në datën 08.03.2021, ka depozituar një kërkesë të tretë pranë Bashkisë Vlorë, duke parashtruar edhe njëherë nevojën për t'i siguruar një strehim të përshtatshëm nëpërmjet trajtimit me bonus qiraje. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Vlorë i ka kthyer përgjigje se ajo kishte në pronësi një pasuri e cila ishte brenda normave të strehimit të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për strehimin, duke i komunikuar se, kërkesa për të përfituar bonus qiraje, bie në kundërshtim me përcaktimet në ligjin për strehimin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Kodi Civil;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët.”
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, miratuar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara;
- Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 28 (2010) mbi detyrimet thelbësore të shteteve palë, sipas nenit 2 të Konventës, Komiteti CEDAW;
- Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 25 (2000) mbi dimensionet gjinore të diskriminimit racor, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 16 (2005) “E drejta e barabartë e burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)”, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

KONKLUZIONE

Komisioneri arrin në përfundimin se, D. M., nuk e gëzon *de facto* të drejtën e pronësisë mbi banesën prej 16 m², por vetëm *de jure*. Në këto kushte, kur Bashkia Vlorë ka dijëni të plotë mbi këtë fakt, pra, që D. M., *de facto* nuk e gëzon të drejtën e pronësisë, ka arritur në mënyrë të gabuar në përfundimin që ajo ka në pronësi një banesë dhe për këtë fakt ka refuzuar në kundërshtim me ligjin nr. 22/2018, kërkesën për ta trajtuar me instrumentin e subvencionimit të qirasë.

Megjithatë, edhe nëse do të pranohet faktin që rrethanat nuk do të përligjin cenimin e të drejtës së pronësisë së D. M., mbi banesën prej 16 m² që ajo zotëron me dokumentacion, rezulton se edhe në këtë situatë, D. M., zotëron sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Referuar normës së strehimit të përcaktuar nga pika 3 e VKM nr. 301, datë 15.04.2020, sipërfaqja e mjaftueshme për të garantuar një strehim të përshtatshëm për një individë është 30 m².

Si pasojë e refuzimit të kërkesës për t'u trajtuar me subvencionimin e qirasë nga ana e Bashkisë Vlorë, rezultoi se D. M., është detyruar të jetojë në një ambient jo të përshtatshëm për banim.

Komisioneri arriti në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, refuzimi i kërkesës së D. M. për të përfituar nga subvencionimi i qirasë, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfituar strehim nga programet sociale të strehimit, nga ana e Bashkisë Vlorë. Në këtë mënyrë, pretendimi i Bashkisë Vlorë se, D. M., nuk ka përfituar nga subvencionimi i qirasë për arsye të mospërmbushjes së kriterëve ligjore rezultoi i pabazuar. Si pasojë, D. M., është detyruar të jetojë në kushte të papërshtatshme banimi. Komisioneri, vlerëson se, kushteve të papërshtatshme të banimit në të cilat D. M., është detyruar të jetojë, i bashkëlidhet edhe rreziku i shtuar si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19. Në periudhën gjatë të cilës ankuesja i është drejtuar Bashkisë Vlorë, për të përfituar nga programet e strehimit social, jetesa në kushte të papërshtatshme banimi, ka përbërë një rrezik të shkuar për shëndetin, për shkak të rrezikut të infektimit me Covid 19.

Bashkia Vlorë, kundërshtoi se refuzimi i kërkesës së D. M., për të përfituar nga subvencionimi i qirasë, të ishte bërë për shkak të përkatësisë etnike dhe gjendjes shoqërore. Sipas Bashkisë Vlorë, përgjithësisht familjet e komunitetit egjiptian, ndër vite përbëjnë rreth 30-40 % të të gjithë përfituesve të bonusit të qirasë në Bashkinë Vlorë. Në lidhje me këtë pretendim, në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Vlorë në lidhje me numrin e përfituesve në përgjithësi në programet e strehimit social dhe në veçanti në programin e subvencionimit të qirasë, për pesë vitet e fundit (2017-2022), rezulton se personat nga komuniteti egjiptian janë në numër të konsiderueshëm përfitues të programeve të strehimit social pranë Bashkisë Vlorë. Pretendimi për diskriminim ndaj D. M., bazohet jo vetëm në shkakun e etnisë dhe faktin që ajo i përket pakicës egjiptiane në Shqipëri, por për shkak se ajo është një grua egjiptiane, duke shtuar këtu edhe vulnerabilitetin e shtuar të saj për shkak të gjendjes shoqërore, si një grua kryefamiljare e vetme

dhe në kushte të vështira ekonomike, me burim të vetëm të ardhurash ndihmën ekonomike.

Komisioneri vlerësoi se të dhënat e vendosura në dispozicion nga Bashkia Vlorë në lidhje me përfituesit egjiptianë të programeve të strehimit social gjatë 5 viteve të fundit, nuk ishin të përshtatshme për të bërë krahasimin me gjendjen e D. M., pasi nuk tregonin në lidhje me gjininë e përfituesve dhe gjendjen e tyre shoqërore. Komisioneri kërkoi nga Bashkia Vlorë, informacion se sa prej përfituesve të programeve të strehimit social që i përkasin pakicës egjiptiane, të raportuar prej tyre, ishin në të njëjtat kushte me ato të D. M., pra që ishin gra, që jetonin të vetme. Bashkia Vlorë nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar.

Nga verifikimi i bërë nga ana e Komisionerit në lidhje me listën personave që kanë përfituar nga programi social i strehimit, pagesën e qirasë, sipas VKM Nr. 58, datë 21.01.2015, të ndryshuar, në Bashkinë Vlorë, rezulton se, nga 53 përfitues, vetëm 1 prej tyre është grua. VKM nuk ka të dhëna në lidhje me përkatësinë etnike të përfituesve, por të dhënat tregojnë se, në raport me burrat, gratë janë të nën përfaqësuara ose pothuajse të padukshme.

Komisioneri mori në konsideratë edhe gjetjet dhe konstatimet e bërë nga disa organizma ndërkombëtare në lidhje me Shqipërinë, si raportin e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), raportin për vitin 2022 për Shqipërinë, të Komisionit Evropian, raportet periodike të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor, Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, raporte të Raportuesit Special për strehimin e përshtatshëm.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë D. M., është diskriminuar për shkak të etnisë, gjinisë dhe gjendjes shoqërore dhe ekonomike, në të drejtën për një strehim të përshtatshëm. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkisë Vlorë, i kalon barra e provës për të provuar se, trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar D. M., ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Vlorë ka treguar një qëndrim pasiv të pajustificuar në lidhje me trajtimin e D. M., pavarësisht se ka qenë në dijeni të vulnerabiliteteve të shtuara të saj, si grua egjiptiane, beqare dhe kryefamiljare e vetme ku burimi i vetëm për të siguruar jetesën është ndihma ekonomike. Në këtë kontekst Komisioneri gjykon se Bashkia Vlorë nuk e ka trajtuar në mënyrë efektive rastin e D. M., në raport me faktin se ajo i përket një grupi të disavantazuar në disa drejtime, çka sjell si pasojë një disavantaz kompleks. Komisioneri thekson gjithashtu faktin se, Bashkia Vlorë nuk arriti të tregojë se praktika dhe qasja e saj në zbatimin e programeve të strehimit social, mundëson gëzimin në mënyrë efektive të të drejtës për strehim për personat që janë në të njëjtat kushte me D. M. Komisioneri vlerësoi se Bashkia Vlorë dështoi që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar D. M., nuk ka ardhur si pasojë e ndërveprimit të etnisë, gjinisë dhe gjendjes shoqërore

dhe ekonomike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të D. M., në të drejtën për strehim të përshtatshëm, në formën e “diskriminimit ndërsektorial”, për shkak të etnisë, gjinisë, si dhe gjendjes shoqërore dhe ekonomike, nga ana e Bashkisë Vlorë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të siguruar strehim të përshtatshëm për D. M., në kuadër të programeve të strehimit, në përputhje me rrethanat dhe situatën në të cilën ankuesja ndodhet.

J. Q. kundër Bashkisë Korçë

VENDIM NR. 178, DATË 11.09.2023

Shkaku: Bindja politike dhe gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qënë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Korçë, deri më datë 24.02.2023. Pak kohë përpara zhvillimit të zgjedhjeve lokale, ankuseses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës si rezultat i ristrukturimit të pozicionit të saj të punës, për shkak të mos pasjes së një angazhimi politik dhe gjatë kohës që ka qënë me raport mjekësor.

FAKTET

Përmes procedurës së lëvizjes paralele, brenda shërbimit civil, ankuesja është emëruar në datën 28.06.2022 në pozicionin Specialist i Logjistikës pranë Bashkisë Korçë. Në muajin shtator 2022, ankuesja ishte shtuar në grupet në aplikacionin *whatsapp* me emrin K. Digital Bashkia Korçë dhe Publikime DPJMBNJ. Në grupin e krijuar në aplikacionin WhatsApp me emrin K. Digital Bashkia Korçë, punonjësit ishin lajmëruar që duhet të pëlqenin, të shpërndanin dhe të linin komente në postimet e publikuara në rrjetet sociale të Bashkisë Korçë dhe Kryetarit të saj. Gjithashtu, anëtarëve të grupit në aplikacionin *WhatsApp*, u ishte dërguar *link*-u për tu regjistruar në aplikacionin *Aktivist*.

Në datën 20.10.2022, nga ana e juristes së Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ankuesja ishte shtuar si anëtare në një tjetër grup në aplikacionin *WhatsApp*, me emrin Publikime DPJMBNJ. Për këtë, si në rastin e sipërcituar, i është komunikuar nga Drejtoresha e Drejtorisë, që punonjësit duhet të pëlqenin, të shpërndanin dhe të linin komente në postimet e publikuara në rrjetet sociale të Bashkisë Korçë dhe Kryetarit të saj.

Referuar provave të administruara në faqen e *Facebook* të Kryetarit të Bashkisë Korçë, evidentohet se përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, të Zgjedhjeve Vendore të 14 majit 2023, në llogarinë e tij kishte publikuar aktivitete me karakter zgjedhor, në mbështetje të subjektit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Sakaq, referuar udhëzimeve të dhëna nga përfaqësuesit e Bashkisë Korçë, në grupet e krijuara në aplikacionin *WhatsApp*, nëpunësit e bashkisë do të duhet të pëlqenin, shpërndanin dhe komentnin edhe postimet me karakter politik, të Kryetarit apo dhe kandidatit për kryetar në zgjedhjet vendore.

Në fillim të muajit dhjetor 2022, ankuesja ka patur disa shqetësime si pasojë e gjendjes së shtatzënisë dhe për këtë arsye, ishte pajisur me raport shëndetësor. Më pas kishte përfituar lejen e zakonshme dhe pas përfundimit kishte vijuar të qëndronte me raport shëndetësor. Referuar provave të administruara, ankuesja kishte njoftuar përmes mesazheve të shkëmbyera në aplikacionit *WhatsApp*, specialisten e Burimeve Njerëzore, se është shtatzënë dhe për këtë të lajmërojë Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore.

Pasi ankuesja është kthyer në punë, më datë 09.01.2023, nga ana e punëdhënësit, është vënë në dispozicion Formulari i plotësuar i Vlerësimit të Punës për periudhën 28.06.2022-31.12.2022, ku ishte vlerësuar me 3 (kënaqshëm) në të gjitha rubrikat, si dhe në atë përfundimtar. Duke mos rënë dakord me këtë, ankuesja e ka refuzuar duke kërkuar rivlerësim.

Në vijim, ankuesja ka përfituar raport për paaftësi të përkohshme në punë, nga data 10.01.2023-23.02.2023. Më datë 24.02.2023, ankuesja është kthyer në punë dhe ka konstatuar se në zyrën e saj mungonin mjetet e punës, të cilat ishin hequr, fakt ky i pranuar nga të dy palët në proces. Pasi ka diskutuar me punëdhënësit i janë rikthyer mjetet e punës.

Në momentin e rikthimit në punë, më datë 24.02.2023, me anë të *e-mail*-it të po kësaj dite, i është përcjellë nga punëdhënësi njoftimi me nr. 351 prot., datë 17.01.2023, për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit. Gjatë kësaj periudhe kur është bërë njoftimi i ankueses, ajo ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë, e shtruar në spital. Po në të njëjtën ditë, më datë 24.02.2022, ankueses i është dorëzuar Formulari i Vlerësimit të Punës i pa ndryshuar, pra me vlerësim 3 “mjaftueshëm”, si dhe vendimi nr. 13, datë 24.02.2023 për lirim nga shërbimi civil dhe shkëputjen e marrëdhënies financiare. Referuar Formularit të Vlerësimit, në faqen 9 të tij rezulton se ankuesja, ka përzgjedhur pikën 3 të tij, duke deklaruar se do ta ankimojë në rrugë gjyqësore vlerësimin për rezultatet në punë për periudhën 28.06.2022-31.12.2022 dhe ka nënshkruar në datën 24.02.2023.

Me urdhër, të Kryetarit të Bashkisë Korçë, është miratuar struktura e re e Bashkisë Korçë. Referuar informacionit të administruar, rezultoi se struktura pararendëse për shkak të nevojave të institucionit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore ishte shtuar numri i nëpunësve të nivelit ekzekutiv, që do të kryenin detyrën “Specialist logjistike”, duke e organizuar këtë njësi me 2 (dy) pozicione të tilla. Me miratimin e strukturës së re, pa asnjë arsyetim apo rivlerësim, pozicioni më sipër, u shkurtua përsëri, duke sjellë si pasojë edhe shkurtimin e vendit të punës që mbante ankuesja.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 17.2.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”;
- Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016 “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri konkludoi se, subjekti ankues ishte ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me përcaktimet ligjore dhe standardin e krijuar për vlerësimin e punës, ristrukturimin dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punësimit.

Njëkohësisht, rezultuan të provuara si deklaratimet e ankueses për mospasje të bindjeve politike dhe mos angazhim të saj në asnjë strukturë apo forcë politike, dhe po ashtu, rezultuan të provuara bindjet politike dhe përkrahja e aktiviteteve të PS, për kolegun e ankueses N. M., si dhe angazhimi politik dhe bindjet politike të Kryetarit të Bashkisë Korçë, S. F., Gjithashtu, rezultuan të provuara deklaratimet e ankueses sa i përket shkakut të pretenduar të gjendjes shëndetësore të ardhura si pasojë e shtatzënisë.

Rezultoi se, Kryetari i Bashkisë, kishte pasur një aktivitet të njohur politik. Bashkia Korçë, rezultoi gjithashtu, të kishte patur dijeni mbi bindjet dhe angazhimin politik të kolegut të ankueses N. M., i cili ishte favorizuar krahasuar me ankuesen. Kryetari i Bashkisë Korçë, si dhe kolegu i ankueses N. M., ishin në vartësi hierarkike institucionale përsa i përket marrëdhënieve të punës dhe përsa i përket bindjeve, angazhimit qytetar e politik i përkisnin forcës politike që qeveriste vendin. Kjo konstatohet edhe nga përkrahja e shtetasit N. M., në rrjetin social *Facebook*, ku ai publikon, mbështet dhe reklamon kandidimin e S. F., në zgjedhjet vendore të vitit 2015. Pavarësisht faktit që, Komisioni i Ristrukturimit kishte qenë në dijeni të faktit se Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), kishte propozuar dhënie e masës disiplinore: “*a- Nga “Vërejte” deri në “Largim nga puna” për kolegun e ankueses, N.M., me detyrë Specialist i Logjistikës...*”, nga ana e Bashkisë Korçë, ky fakt nuk ishte konsideruar dhe as përmendur në analizën e bërë nga Komisioni, duke e emëruar atë në pozicionin e Specialistit të Logjistikës dhe duke larguar ankuesen nga puna.

Gjithashtu, Komisioneri konstatoi se:

- Edhe pse kishte pasur pozicione të lira pune, gjatë procedurave të ristrukturimit, nga ana e Bashkisë Korçë ky fakt nuk ishte mbajtur në vëmendje por ishte vijuar me largimin e ankueses nga pozicioni i punës;
- Fakti që punëdhënësi, kishte qenë në dijeni se ankuesja se gjatë periudhës së ristrukturimit, kishte qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë, nga ana e tyre kishin vijuar procedurat e njoftimit për ristrukturimin e institucionit pa marrë parasysh gjendjen shëndetësore të saj;
- Vlerësimi i punës për ankuesen nuk ishte arsyetuar duke u hartuar formalisht;
- Nuk rezultoi që Bashkia Korçë të kishte përgatitur apo dhënë ndonjë informacion shterues, lidhur me arsyet që çuan në ristrukturimin e saj;
- Rezulton se ankuesja kishte marrë dijeni më datë 24.02.2023, sapo ishte paraqitur në punë, lidhur me njoftimin për fillimin e procedurave të procesit të ristrukturimit; Formularin e Vlerësimit të Punës të rishikuar; Relacionin e Komisionit të Ristrukturimit dhe njoftimin për lirim nga shërbimi civil, duke mos ndjekur dhe respektuar afatet dhe procedurat në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil;
- Edhe pse strukturat e Bashkisë Korçë, kishin patur dijeni lidhur me shtatzëninë e ankueses, nga ana e tyre ishin vijuar me procedurat e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Komisioneri konstatoi se Bashkia Korçë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, kishte diskriminuar ankuesen në të drejtën e saj për punësim, në formën e diskriminimit ndërsektorial, trajtim i cili kishte ardhur si pasojë direkte e mospasjes apo mosdeklarimit të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore të saj, lidhur me vlerësimin e punës, procedurat e ristrukturimit dhe zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, në formën e diskriminimit ndërsektorial, të ankueses J. Q., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore, nga ana e Bashkisë Korçë.

J. Sh. kundër Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK), Bashkia Tiranë

VENDIM NR. 67, DATË 28.04.2023

Shkaku: Gjinia, shtatzënia, gjendja familjare
Forma: Diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Vendimi i paankimuar.

Ankuesja është diskriminuar në të drejtën për punësim për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes familjare.

FAKTET

Ankuesja banon në Tiranë dhe është nënë e dy fëmijëve, një djali të datëlindjes 27.12.2017 dhe një vajze të datëlindjes 15.09.2021. Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë AMK, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, me detyrë specialiste në Sektorin e Kontrollit të Shërbimeve të Transportit Publik, Drejtoria e Inspektimit, Monitorimit për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike. Marrëdhënia e punës midis ankuseses dhe AMK Bashkia Tiranë ka qenë e lidhur për një afat kohe të papërcaktuar. Marrëdhënia e punës midis ankuseses dhe AMK, Bashkia Tiranë ka filluar prej datës 04.12.2015. Në datën 15.09.2021, ankuesja ka lindur duke sjellë në jetë një vajzë. Sipas dokumentacionit mjekësor të administruar rezulton se ankuesja ka kryer një lindje të parakohshme. Nga ky moment, ankuesja ka qenë me leje lindje, për t'u rikthyer në punë në muajin gusht 2022.

Ankuesja pretendoi se pas rikthimit të saj në punë pas lejes së lindjes, ka punuar për një javë, në pozicionin e mëparshëm të punës si specialiste, i cili konsistonte në kryerjen e detyrave, kryesisht hartimin e shkresave, në ambientet e zyrës, në orarin 08:00-16:00. Pas këtij momenti ankuesja pretendon se verbalisht dhe jo më anë të një dokumenti shkresor, i është caktuar si detyrë dalja në terren si kontrollore, me orarin 07:00-15:00, si dhe pa i specifikuar kohëzgjatjen e këtij urdhri. Duke e konsideruar këtë si ndryshim të pozicionit të punës ankuesja pretendon se ka kërkuar takim me punëdhënësin për tu informuar në lidhje këtë ndryshim apo për të shprehur qëndrimin e saj, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ankuesja pretendon se, nuk iu mundësua në asnjë moment nga ana e punëdhënësit që t'i parashtronte këtij të fundit pamundësinë objektive për të qenë prezent në orën 7:00 në vendin e punës, duke marrë në konsideratë kushtet në të cilat ajo ndodhej, si paraqitja në punë pas lejes së lindjes, fakti i të qenit nënë e dy fëmijëve të mitur, ku njëra është bebe, mosha 1 vjeçe dhe tjetri është mosha 5 vjeçare, rrethana këto që e kushtëzonin ankuesen në kohë, hapësirë dhe mundësi, në raport me punonjës të tjerë. Ankuesja pretendoi se për shkak të kushteve në të cilat ajo ndodhej,

e kishte të pamundur të përballonte punën në terren me oraret e sipërcituara, pasi fëmijët e saj janë në çerdhe dhe kopsht dhe këto të fundit hapen në orën 7:00, dhe që fëmijët të jenë në orën 7:00 në kopsht duhet të çohen në 5:30 nga gjumi, të bëhen gati, pastaj të dërgohen në kopsht, e pas kësaj ankuesja të paraqitet në vendin e punës, po në orën 7:00.

Rezultoi e provuar se pas kthimit nga leja e lindjes në datën 15.08.2022, ndaj ankueses janë marrë dy masa disiplinore. Në datën 29.08.2022 është marrë masa e parë disiplinore “vërejtje” dhe në datën 08.09.2022 është marra masa e dytë disiplinore “vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”. Për të dyja masat disiplinore arsyeja apo shkaku i dhënies së tyre është fakti që ankuesja nuk ka dalë të ushtrijë detyrat e saj funksionale si specialiste në Sektorin e Kontrollit të Shërbimeve të Transportit Publik, por ka qëndruar në zyrë. Rezulton e provuar se ankuesja është paraqitur rregullisht në zyrë dhe një fakt i tillë është pasqyruar edhe në procesverbalet e mbajtura gjatë procedurës disiplinore.

Në datën 9.9.2022, ankuesja ka paraqitur pranë punëdhënësit AMK Bashkia Tiranë kërkesën për dorëheqje. Në kërkesën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ankuesja shprehet se, është detyruar të japë dorëheqjen, sepse pas rikthimit nga leja e lindjes është hasur në sjellje diskriminuese dhe jo njerëzore, është ndjerë në presion psikologjik i cili ka ndikuar drejtpërsëdrejti tek fëmijët e saj të mitur dhe se titullari i institucionit nuk ka pranuar të japë asnjë arsye për vendimet arbitrare që merr dhe as të mundësojë një takim për të gjetur një zgjidhje profesionale dhe ligjore për situatën. Kërkesa është miratuar brenda ditës dhe ankueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 183 “Mbrojtja e Amësisë, 2000”, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për punëtorët me përgjegjësi familjare, C 156, 1981”;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

KONKLUSIONE

Në lidhje me pretendimin për ndryshimin e kushteve të punës, pas rikthimit të ankueses nga leja e lindjes.

Rezultoi e provuar se pas rikthimit në punë nga leja e lindjes, ankuesja është sistemuar në të njëjtin pozicion pune që mbante para se të largohej me lejen e lindjes dhe me të njëjtën pagë, por një javë pas rikthimit në punë nga leja e lindjes, kushtet e punës në të cilat ajo duhet të përmbushte detyrat e saj funksionale që buronin nga pozicioni i punës, kishin ndryshuar. Rezultoi e provuar se kishin ndryshuar këta elementë thelbësore të kushteve të punës, sikurse janë, vendi i punës, natyra e detyrave që ajo duhet të kryente, si dhe orari i punës. Konkretisht para lejes së lindjes vendi i punës së ankueses ka qenë në zyrë, pas lejes së lindjes në terren; para lejes së lindjes natyra e punës që kryente ankuesja ka qenë përpilimi i shkresave dhe raporteve të ndryshme, pas rikthimit nga leja e lindjes natyra e punës ka qenë kontrollore në terren e linjave të transportit publik; para lejes së lindjes ankuesja duhet të paraqitej në punë në orën 08:00 ndërsa pas lejes së lindjes ky orar ishte 07:00. legjislacioni shqiptar ka si synim të tij të mbrojë gratë, jo vetëm përgjatë periudhës së shtatzanisë së tyre, por edhe pas përfundimit të lejes së lindjes e rikthimit në punë. Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, nga ana e Agjencisë për Mbrojtjen e Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, sepse pas rikthimit nga leja e lindjes i janë ndryshuar kushtet e punës, krahasimisht me ato në të cilat ajo punonte para se të merrte lejen e lindjes, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën që të kthehet në vendin e punës në kushte që nuk janë më pak të favorshme për të.

Në lidhje me trajtimin e ankueses si punëmarrëse me përgjegjësi kundrejt fëmijëve të vegjël dhe në moshë foshnjore.

Ankuesja është nënë e dy fëmijëve, prej të cilëve një në moshën 5 vjeç dhe tjetri foshnjë pa mbushur 1 vjeç. Në këto kushte është e padiskutueshme që për shkak të moshës fare të vogël, fëmijët e ankueses janë të varur prej nënës së tyre, e në veçanti vajza e saj e cila është ende një foshnje e cila nuk ka mbushur moshën 1 vjeç.

AMK në cilësinë e punëdhënësit nuk e ka dëgjuar ankuesen në lidhje me kushtet në të cilat ajo ndodhej si një punonjëse e cila kishte përgjegjësi familjare, si nënë me dy fëmijë të vegjël, prej të cilëve njëri në moshë foshnjore, të cilët ishin të varur prej saj. AMK në cilësinë e punëdhënësit nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka vlerësuar në asnjë moment nevojat e ankueses, si punonjëse e cila kishte në përgjegjësi dy fëmijë të vegjël për ti mundësuar në mënyrë efektive ankueses ushtrimin dhe gëzimin e të drejtës për punë. AMK nuk i kundërshtoi pretendimet e ankueses se ajo e ka vënë në dijeni punëdhënësin për nevojat që ajo kishte në drejtim të fëmijëve të saj të vegjël dhe konfliktit që krijohej midis përgjegjësive të saj familjare dhe jetës së saj profesionale dhe kushteve të punës në të cilat punëdhënësi e kishte detyruar që të punonte. Por, AMK në cilësinë e punëdhënësit, nuk arriti të provojë se kishte dëgjuar dhe vlerësuar në mënyrë

objektive nevojat e ankueses dhe kushteve të pafavorshme në të cilat ajo ishte vendosur për të përmbushur detyrat e saj funksionale për shkak të përgjegjësive të saj familjare. Vetëm në përfundim të një vlerësimi objektiv të kërkesave të ankueses dhe nevojave të punëdhënësit, ky i fundit mund të mos ngarkohet me përgjegjësi për shkelje të ofrimit të mundësive të barabarta dhe trajtim të barabartë ndaj punonjësve me përgjegjësi familjare. Komisioneri arrin në përfundimin se mosmarrja në konsideratë dhe vlerësimi i nevojave të ankueses si nënë me dy fëmijë të vegjël, të cilat kanë të bëjmë me kushtet e punës, e kanë vendosur atë të pozita të disfavorshme për të ushtruar në baza të barabarta të drejtën e saj në punësim për shkak të përgjegjësive të saj familjare për tu përkujdesur për fëmijët e saj të vegjël.

Në lidhje me masat disiplinore të marra ndaj ankueses

Komisioneri vlerëson se të dyja masat disiplinore nuk janë dhënë në respektim të parashikimeve të Kodit të Punës dhe Rregullores së AMK. Procedura e shqyrtimit të këtyre masave disiplinore nga punëdhënësi nuk ka garantuar të drejtën e ankueses që të dëgjohet, të mbrohet dhe të parashtrijë faktet dhe provat në mbështetje të pretendimeve të saj, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Cenimi i këtyre garancive konsiderohen shkelje flagrante të procedurës së parashikuar nga neni 37 i Kodit të Punës. Të dyja masat disiplinore janë produkt i një procesi disiplinor që nuk ka respektuar garancitë dhe procedurën e përcaktuar nga ligji dhe rregullorja e vetë institucionit. Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm gjatë procesit disiplinor në dhënien e dy masave disiplinore.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi prima facie) se në pamje të parë ankuesja është diskriminuar për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes familjare, pasi:

- Ankueses i është cenuar e drejta për t'u rikthyer pas lejes së lindjes në të njëjtat kushte pune me ato që kishte para se të largohej me lejen e lindjes dhe kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e shtatzënisë së ankueses dhe se, çdo trajtim i pafavorshëm që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me shtatzëninë ose amësinë përbën diskriminim të drejtpërdrejtë gjinor;
- Ankuesja është vendosur në kushte të disfavorshme pikërisht për shkak të përgjegjësive të saj familjare ndaj dy fëmijëve të saj të vegjël, prej të cilëve vajza e saj në moshë foshnjore. Për shkak se gratë vazhdojnë të mbajnë pjesën më të madhe të përgjegjësisë për përkujdesje, kjo situatë ka një ndikim joproportional bazuar në gjini;
- Ankuesja është ndëshkuar me dy masa disiplinore në kundërshtim flagrant me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe pa iu dhënë e drejta që të dëgjohet dhe të mbrohet. Këto masa disiplinore rezultojnë se janë dhënë pikërisht për faktin se ankuesja ka refuzuar ndryshimin e kushteve të punës në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi, pas kthimit të saj nga leja e lindjes dhe se kushtet e ndryshuara të punës e vendosin atë në pozita të disfavorshme për shkak të përgjegjësive familjare,

Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, AMK Bashkia Tiranë, i kalon barra e provës për të provuar se, trajtimi i padrejtë, i disfavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Komisioneri vlerëson se AMK Bashkia Tiranë dështoi që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesja J. Sh, nuk ka ardhur si pasojë e gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes familjare të ankuses. Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja është diskriminuar gjatë marrëdhënies së punës për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes familjare.

Në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

Komisioneri konstaton se nga ana formale përfundimi i marrëdhënies së punës midis ankuses dhe AMK ka ndodhur në bazë të kërkesës për dorëheqje të ankuses. Në kërkesën për dorëheqje që ankuesja ka depozituar pranë punëdhënësit, ajo ka deklaruar se po largohet nga puna jo me vullnetin e saj, por pasi është ndjerë e detyruar si pasojë e sjelljeve diskriminuese ndaj saj, që nga momenti i rikthimit nga leja e lindjes.

Kërkesa për dorëheqje e paraqitur nga ankuesja është miratuar nga punëdhënësi brenda të së njëjtës ditë nëpërmjet nxjerrjes së urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Motivacioni i cituar në urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është *“arsye personale”*. Nga përmbajtja e kërkesës për dorëheqje konstatohet se, *“arsyet personale”* konsistojnë në pretendimet për diskriminim që ankuesja parashton para punëdhënësit. AMK, në urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënies të punës i konsideron *“arsye personale”* pretendimet e ankuses për diskriminim, ndërsa nuk ka marrë asnjë masë për shqyrtimin e pretendimeve për diskriminim, në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni 15 i ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar. Komisioneri vlerëson se një sjellje e tillë vjen në kundërshtim të hapur me parimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe garancitë ligjore që ofrohen për çdo punëmarrës.

Referuar kërkesës së dorëheqjes që ankuesja i ka paraqitur punëdhënësit pasqyrohet qartë se, vullneti i deklaruar prej saj nuk përputhet me vullnetin e saj të brendshëm. Vullneti i shprehur për të ndërprerë marrëdhënien e punës është pasojë e frikës së krijuar tek ankuesja për pasojat negative që mund të vijnë tek ajo dhe fëmijët e saj, për shkak të sjelljeve diskriminuese në vendin e punës dhe mosmarrjen e asnjë mase nga ana e punëdhënësit për ta mbrojtur.

Sikurse rezultoi e provuar, ankuses i është cenuar e drejta për tu rikthyer pas lejes së lindjes në të njëjtat kushte pune me ato që kishte para se të largohej me lejen e lindjes, nevojat e saj si punonjëse me përgjegjësi prindërore nuk janë dëgjuar, vlerësuar apo marrë në konsideratë, pas dy masave disiplinore të marra në kundërshtim flagrant me të drejtën për një proces të rregullt ligjor,

masa disiplinore e radhës nëse ankuesja nuk do të nënshtrohej sjelljes së punëmarrësit do të ishte zgjidhja e kontratës së punës, dhe përfundimisht, përballë të gjitha këtyre sjelljeve, punëdhënësi nuk merr asnjë masë për të shqyrtuar pretendimet e ankueses për diskriminim, por i konsideron ato “arsye personale”. Komisioneri vlerëson se, vullneti i shprehur nga ankuesja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk përputhet me vullnetin e saj të brendshëm. Komisioneri vlerëson se, ankuesja e ka shprehur vullnetin e saj për të ndërprerë marrëdhënien e punës duke u ndjerë e shqetësuar dhe e frikësuar për pasojat e dëmshme dhe negative që mund të vinin për atë dhe fëmijët e saj, nga sjelljet diskriminuese në vendin e punës, duke vijuar në këtë marrëdhënie punësimi.

Gjinia dhe shtatzënia, janë dy shkaqe të mbrojtura veçmas nga ligji, por njëkohësisht ato janë të ndërlidhura me njëri tjetrin. Shtatzënia mund të duket si një nëngrup i gjinisë, më tepër se një shkak më vete. Megjithatë, jo të gjitha gratë janë shtatzëna dhe disa gra mund të mos kenë mbetur ose të mbeten shtatzënë kurrë. Nga ana tjetër, një grua shtatzënë mund të trajtohet në mënyrë të disfavorshme jo vetëm në raport me gratë e tjera jo shtatzëna, por edhe në raport me burrat dhe për këtë arsye, çdo diferencë në trajtim, direkte ose e tërthortë, që lidhet me shtatzëninë, përbën diskriminim gjinor. Një qasje e ngjashme mund të bëhet edhe në kontekstin e gjendjes familjare të punonjësve dhe përgjegjësive të tyre ndaj fëmijëve. Përsëri, jo të gjitha gratë dhe as të gjithë burrat janë punonjës që kanë përgjegjësi apo që janë në një situatë që duhet të kujdesen për fëmijët e tyre.

Punonjëset e tjera gra nuk janë në të njëjtat kushte me ankuesen, një grua e cila është kthyer nga leja e lindjes, pasi ka sjellë në jetë vajzën e saj. Ndërkohë, jo të gjithë punonjësit e tjerë gra dhe burra, të cilët, janë në të njëjtat kushte me ankuesen, e cila është nënë e dy fëmijëve të vegjël, njëri prej të cilëve në momentin që kanë ndodhur ngjarjet ka qenë pa mbushur 1 vjeç. Në këto kushte, disavantazhi i përjetuar nga ankuesja si grua, e sapo kthyer nga leja e lindjes, dhe një punonjëse me përgjegjësi familjare ndaj dy fëmijëve të vegjël, nuk është i njëjtë me atë të përjetuar nga një punonjëse grua që nuk ka sjellë në jetë një fëmijë apo punonjëset gra dhe punonjësit burra të cilët nuk kanë në përgjegjësi fëmijë të vegjël. Komisioneri vlerëson se, gjinia, shtatzënia dhe gjendja familjare e ankueses, veprojnë dhe ndërveprojnë në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuara me njeri tjetrin, në gjenerimin e situatës diskriminuese në të cilën është vendosur ankuesja. Komisioneri gjykon se ankuesja është viktimë e diskriminimit ndërsektorial.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses J. Sh., në të drejtën për punësim, në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes familjare, nga ana e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Tiranë

R. G. kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

VENDIM NR. 179, DATË 12.09.2023

Shkaku: Moshë, gjendja arsimore, gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim ndërsektorial/Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja, për shkak të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike e ka të pamundur që të marrë vetë në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *on-line*. Praktika e ndjekur nga ASHK në ofrimin e shërbimeve kadastrale *on-line*, në dukje e barabartë për të gjithë, e ka diskriminuar ankuesen.

FAKTET

Ankuesja është 58 vjeçe dhe banon në qytetin e Korçës. Pas ndarjes nga jeta të bashkëshortit të saj, ka përgatitur dokumentacionin për kalimin e pronësisë së shtëpisë në emrin e saj dhe është paraqitur për të kryer veprimet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), por aty i kanë komunikuar (verbalisht) se dokumentacionin e përgatitur duhet ta dërgonte *online* nëpërmjet *e-Albania*. Ankuesja parashtron se, është paraqitur përsëri pranë këtij institucioni për të kërkuar ndihmë për kryerjen e aplikimit, por përgjigja që ka marrë (verbalisht) ka qenë se duhet të aplikonte vetë.

Ankuesja pretendon se, për shkak të moshës, faktit që është me arsim 8 vjeçar, kushteve në të cilat ajo ndodhet pasi nuk zotëron një aparat telefon, kompjuter e internet dhe se nuk di t'i përdori këto pajisje për të dërguar dokumentacionin nëpërmjet *e-Albania*, është e detyruar që të shkojë në një internet kafe ose pika të ndryshme që merren me këto punë kundrejt pagesës, ndërsa thekson se, ka si burim të ardhurash dhe jeton vetëm me pensionin e bashkëshortit prej rreth 6 400 (gjashtë mijë e katërqind) lekë në muaj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”;
- Ligji nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 389, datë 13.5.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, i ndryshuar;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;

KONKLUZIONE

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në qëndrimin e parashtruar nga ASHK, ky institucion nuk rezultoi të ketë vendosur në dispozicion ndonjë mjet apo strukturë të dedikuar për asistimin e qytetarëve të cilët për arsye të ndryshme kanë vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *online* nëpërmjet *e-Albania*.

Personat e moshuar, ata që kanë një nivel të ulët arsimor dhe nuk kanë aftësitë, kapacitetet, mjetet dhe mundësitë informatike për përdorimin e shërbimeve kadastrale digjitale *online* nëpërmjet *e-Albania* nuk mund t’i marrin vetë drejtpërdrejt shërbimet në *e-Albania*. Aksesimi i shërbimeve kadastrale *online* në *e-Albania* nëpërmjet palëve të treta e ngarkon këtë kategori personash me kosto shtesë krahasimisht me personat e tjerë të cilët kanë mundësi që t’i marrin vetë shërbimet *online*. Për ata persona që janë në pamundësi ekonomike, gjendja e tyre ekonomike i vendos ata në kushte akoma më të vështira dhe të pamundura për të marrë shërbimet kadastrale *online* edhe nëpërmjet palëve të treta, pasi janë në pamundësi financiare për të mbuluar pagesat shtesë që vijnë si rezultat i marrjes së këtij shërbimi publik, nëpërmjet shërbimeve të palëve të treta private.

Ankuesja R. G., e cila është në moshën 58 vjeçare, që nuk ka njohuritë dhe dijet e nevojshme në lidhje me përdorimin e internetit dhe nuk disponon mjetet e nevojshme teknologjike për të aksesuar internetin, e ndodhur në kushtet kur të ardhurat e saj të vetme për të siguruar jetesën është një pension në masën prej 6 427 (gjashtë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) lekë, është vendosur në kushtet e pamundësisë për të marrë shërbimin kadastral të ofruar nga ana e ASHK *online* nëpërmjet *e-Albania*. Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, krahasuar me persona të tjerë, pasi ankuesja nuk ndodhet në kushte e rrethana të njëjta me ata, pikërisht për shkak të moshës, faktit që nuk ka kapacitetet, mjetet dhe mundësitë informatike për përdorimin e shërbimeve kadastrale digjitale *online* nëpërmjet *e-Albania*.

Në këtë kontekst, marrja e shërbimeve kadastrale dhe pajisja me aktet përkatëse kadastrale nga ana e ASHK, si autoriteti i ngarkuar nga ligji për lëshimin e tyre, janë aspekte të rëndësishme të të drejtës së një pronari, për të gëzuar dhe disponuar lirisht pronën e tij, pasi në mungesë të pasqyritit dhe regjistrimit të titullit të pronësisë, përfshi edhe trashëgiminë, në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, pronari nuk mund ta tjetërsojë pasurinë e paluajtshme, nuk mund ta lërë peng sendin deri në përmbushjen e një detyrimi që ka ndaj një subjekti tjetër, apo nuk mund ta vendosë si garanci hipotekare deri në shlyerjen e një kredie në favor të të tretëve. Rrjedhimisht, pamundësia e ankueses, për të marrë shërbimet kadastrale të ofruara nga ASHK dhe të pajiset me aktet përkatëse kadastrale, për shkaqet e pretenduara prej saj, e vendos atë në kushte të pafavorshme për të gëzuar në mënyrë efektive të drejtat e saj pronësore.

Në pamje të parë të gjithë personat që kërkojnë të marrin shërbimet kadastrale *online* nëpërmjet *e-Albania* të ofruara nga ASHK trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk ka në pamje të parë asnjë ndalim, kufizim apo përjashtim për marrjen e shërbimit në bazë të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike.

Ankuesja, e cila për shkak të moshës dhe nivelit të ulët arsimor, nuk zotëron aftësitë dhe dijet për të përdorur dhe aksesuar nëpërmjet teknologjisë së informacionit shërbimin kadastral të ofruar nga ASHK vetëm *online* nëpërmjet *e-Albania*, vendoset në kushte më pak të favorshme dhe ndikohet në mënyrë negative nga kjo mënyrë e ofrimit të shërbimeve edhe pse shërbimet ofrohen në të njëjtën mënyrë për të gjithë. Në kushtet kur ankuesja nuk mund t'i marri vetë drejtpërdrejtë shërbimet kadastrale *online* në *e-Albania* dhe nuk janë vendosur në dispozicion mënyra alternative për të marrë këtë shërbim publik, ajo vendoset në kushtet e pamundësisë për të marrë shërbimin krahasimisht me personat e tjerë që nuk ndodhen në të njëjtat kushte me të. Njëkohësisht, ankuesja është në pamundësi financiare dhe nuk disponon mjetet e nevojshme teknologjike dhe nuk ka akses në internet. Në kushtet kur ankuesja nuk mund të marrë vetë dhe drejtpërdrejtë shërbimin publik ajo është e detyruar që t'i drejtohet palëve të treta, që mund të jenë noterë, avokatë apo qendra interneti, si e vetmja mënyrë për të marrë shërbimin. Marrja e shërbimit nëpërmjet palëve të treta e ngarkon ankuesen me kosto shtesë, krahasimisht me personat që mund të marrin vetë drejtpërdrejtë shërbimet e ofruara nga ASHK *online* në *e-Albania*. Përveç kësaj kostoje shtesë që rëndon mbi ankuesen, në kushtet e pamundësisë ekonomike, ankuesja vendoset në kushtet e pamundësisë për të marrë shërbimin edhe nëpërmjet palëve të treta.

Të dhënat e administruara, tregojnë që të moshuarit, personat me nivel të ulët arsimor dhe ata që janë në kushte të pamundësisë financiare, përbëjnë grupe vulnerabël dhe me më pak akses ndaj teknologjisë së informacionit, e rrjedhimisht personat nga këto grupe vendosen në kushte më pak të favorshme për të marrë shërbimet kadastrale të cilat nga ASHK ofrohen vetëm *online* nëpërmjet *e-Albania*. Praktika që ndiqet nga ASHK në ofrimin e shërbimeve kadastrale *online* nëpërmjet *e-Albania*, është e njëjtë për të gjithë personat që dëshirojnë t'i marrin këto shërbime, pa marrë në konsideratë nevojën dhe situatën e veçantë në të cilën gjenden personat që i përkasin grupeve të mësipërme vulnerabël.

Justifikimi i dhënë nga ASHK për praktikën e ndjekur prej saj, është se kjo praktikë kushtëzohet nga kuadri nënligjor në fuqi i cili vendos detyrimin për ofrimin e shërbimeve kadastrale digjitale vetëm *online* nëpërmjet *e-Albania*. Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se ky akt nënligjor është VKM nr. 252/2022, nëpërmjet të cilit janë detajuar procedurat e ofrimit të shërbimeve *online* nga institucionet shërbimofruese, ku përfshihen edhe shërbimet e ofruara nga ASHK. Me miratimin e kësaj VKM-je, nga data 1 maj 2022, shërbimeve publike, përfshi edhe shërbimet publike të ofruara nga ASHK, kryhen *online*, duke mbyllur sportelet për marrëdhëniet fizike me qytetarët.

Referuar informacionit të vendosur në dispozicion nga Kryeministria, gjatë inspektimeve të kryera në muajin maj 2022, për të monitoruar zbatimin e VKM-së nr. 252/2022, ndër problematikat e evidentuara përfshihen edhe ato të vështirësive të qytetarëve për të marrë shërbimet *online* për shkak të moshës dhe/apo mungesës së një pajisjeje elektronike të përshtatshme. Kryeministria informon se, në përgjigje të kësaj problematike, çdo institucion përgjegjës për ofrimin e shërbimeve *online* ka vënë në dispozicion një apo disa punonjës të cilët ndihmojnë çdo qytetar, i cili për arsye të ndryshme ka vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet *online*.

ASHK deklaroi se, nuk disponon asnjë mjet apo strukturë të dedikuar për asistimin e kësaj kategorie të qytetarëve në kryerjen e shërbimeve kadastrale. ASHK nuk ofroi asnjë shpjegim se cilat ishin arsyet që ajo nuk kishte marrë asnjë masë për të asistuar qytetarët të cilët nuk mund të marrin vetë në mënyrë të pavarur shërbimet publike kadastrale, në kushtet kur, çdo institucion përgjegjës për ofrimin e shërbimeve *online*, duhet të vendosë në dispozicion një apo disa punonjës të cilët ndihmojnë çdo qytetar, i cili për arsye të ndryshme ka vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet *online*.

Komisioneri arrin në përfundimin se, praktika e ndjekur nga ASHK, duke e trajtuar ankuesen në mënyrë të njëjtë me të gjithë personat e tjerë, e vendos atë në kushte të pafavorshme dhe e ekspozon ndaj pasojave më negative, pasi për shkak të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike, ankuesja e ka të pamundur të marrë vetë në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *online* nëpërmjet *e-Albania*, në raport me personat e tjerë të cilët nuk janë në të njëjtat kushte me të. Komisioneri vlerëson se, dështimi i ASHK për të trajtuar ndryshme ankuesen, e cila për shkak të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike e ka të pamundur që të marrë vetë në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *online*, nuk është objektivisht e justifikuar. Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se, praktika e ndjekur nga ASHK në ofrimin e shërbimeve kadastrale *online*, në dukje e barabartë për të gjithë, vjen në kundërshtim me ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar pasi e vendos ankuesen në pozita diskriminuese për shkak të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike.

Komisioneri vlerëson se, është ASHK, e cila duhet të kishte marrë masa për të siguruar mjetet e nevojshme dhe për të rregulluar ofrimin e ndihmës në marrjen e shërbimit kadastral *online* nëpërmjet *e-Albania*, për kategorinë e personave, sikurse ankuesja, të cilët nuk mund të marrin vetë në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *online* nëpërmjet *e-Albania*.

Komisioneri, vlerëson se jemi në kushtet kur trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm e i pabarabartë ardhur si rezultat i dështimit për të trajtuar ndryshe ankuesen, lidhet në të njëjtën kohë me të tre shkaqet, moshën, gjendjen arsimore dhe gjendjen ekonomike, të cilët, kanë bashkëvepruar më njëri-tjetrin në mënyrë të pandashme dhe në të njëjtën kohë, duke e diskriminuar në mënyrë të tërthortë ankuesen.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses R. G., për shkak të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj në nivel vendor, të asistojë ankuesen duke i vendosur në dispozicion një punonjës për ta ndihmuar në marrjen e shërbimit kadastral *online* nëpërmjet *e-Albania*.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, duhet të marrë masa për të siguruar mjetet dhe mënyrën e ofrimit të asistencës dhe ndihmës për të gjithë personat, të cilët nuk mund të marrin vetë dhe në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *online* nëpërmjet *e-Albania*.

P. GJ. kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë

VENDIM NR. 184, DATË 14.09.2023

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (për arsye të profesionit si gazetar lokal i njohur nga punonjësit e policisë së shtetit dhe se televizioni Fax News ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie dhe gazetarit ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal)

Forma: Diskriminim në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë

Fusha: Shërbime

Statusi: Në gjykatë

Ankuesi me profesion gazetar është shoqëruar në mënyrë të paligjshme nga punonjës të Policisë së Shtetit në Komisariatit të Policisë Lezhë. Motivacioni i këtij veprimi procedural ka qenë i lidhur me dyshimin e pjesëmarrjes së P. Gj në protestën e cilësuar si të paligjshme, organizuar nga banorët e Njesisë Administrative Fan, Mirditë.

FAKTET

Në datë 11.04.2021, nga ora 09:30 deri ora 12:30, në superstradën Milot-Morinë, në hyrje të tunelit të Thirrës (Kalimash) është zhvilluar një protestë kundër ndërtimit të një Hidrocentrali në fshatin Sang-Fan, Mirditë.

Referuar komunikimeve të gazetarit P. Gj me redaksinë e televizionit Fax News rezulton se ankuesi ka qenë në vendin e protestës dhe ka raportuar ngjarjen. Pas mbarimit të protestës, P. Gj., ka qenë duke u kthyer në Lezhë me një mjet të transportit publik (mikrobus). Rreth 40 km nga vendi i organizimit të protestës, mjeti i transportit ku udhëtonte ankuesi është ndaluar nga punonjësit e Komisariatit të Policisë Mirditë dhe pasagjerët së bashku me ankuesin, janë shoqëruar për në mjediset e Komisariatit të Policisë Lezhë.

Referuar Formularit të Raportit të Shoqërimit ose Ndalim/Arrestimit, të mbajtur në orën 14:05, nga Inspektori i Komisariatit të Policisë Mirditë, shpjegohet arsyeja e shoqërimit të ankuesit, në të cilën rezulton se: *“Shtetasi P. Gj., u ndalua tek mbikalimi i Gjocit Mirditë, për arsye që dyshohet për pjesëmarrje në një protestë të paligjshme në fshatin Fan Mirditë. U shoqërua në ambientet e Komisariatit të Policisë Lezhë. Pa probleme”*.

Referuar librit të Hyrje-Dalje të Personave në Institucion, të Komisariatit të Policisë Lezhë, figuron se P. Gj., është paraqitur në orën 13:45 dhe ka dalë në orën 17:45.

Referuar deklaratave të palëve, rezulton se gazetari P. Gj., gjatë zhvillimit të protestës nuk është pënguar për të kryer detyrën e tij për raportimin e ngjarjes dhe nuk ka pasur ndonjë ankesë ndaj

punonjësve të policisë. Pretendimet e ankuesit janë rreth situatës së shoqërimit të tij pas protestës dhe mbajtjes së tij për verifikim në mjediset e Komisarariatit të Policisë Lezhë, për rreth 4 orë.

Referuar kronikave/lajmeve që kanë mbuluar ngjarjen dhe deklaratave të palëve, rezulton se kjo ngjarje është raportuar nga shumë gazetarë të mediave kombëtare dhe lokale, si: Top Channel, News 24, Report Tv, Rozafa Tv, ABC News, Ora News, Scan Tv, Syri Tv, etj dhe gjithashtu rezulton se asnjë gazetar i këtyre televizioneve nuk është shoqëruar në polici, si gjatë zhvillimit të protestës, ashtu dhe pas protestës, me përjashtim të P. Gj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se P. Gj., ka qenë i vetmi gazetar i shoqëruar nga Policia e Shtetit, pavarësisht se ka qenë në vendin e zhvillimit të protestës (duke raportuar) dhe duke u kthyer nga vendi i ngjarjes në të njëjtën kohë si të gjithë gazetarët e tjerë, por në ndryshim me gazetarët e tjerë vetëm ky gazetar është ndaluar dhe shoqëruar për në Komisariatin e Policisë Lezhë, duke i mohuar këtij të fundit dhe medias Fax News që të pasqyronte/raportonte informacionin me ngjarjet e ndodhura pas zhvillimit të protestës dhe ndalimit/shoqërimit të pjesëmarrësve në Komisarariat.

DVP Lezhë ka deklaruar se në rastin konkret nuk kemi një shoqërim të mirëfilltë dhe nuk është mbajtur procesverbal, pasi P. Gj., nuk ka qenë i ndaluar/shoqëruar në dhomat e ndalim/shoqërimit si dhe nuk i është mbajtur asnjë nga sendet personale.

Referuar intervistës së dhënë nga P. Gj., në televizionin Fax News, pas daljes nga mjediset e Komisarariatit por dhe fotografisë së dërguar për qëndrimin në mjediset e brendshme të Komisarariatit të Policisë Lezhë, rezulton se P. Gj., ka deklaruar se ka qenë duke raportuar ngjarjen dhe ka paraqitur dokumentet e tij, por punonjësit e policisë nuk i kanë marrë parasysh. Gjithashtu gjatë intervistës P. Gj., ka deklaruar se i kanë sekuestruar telefonat, dokumentin e identifikimit dhe të gazetarit, gjë e cila nuk është pasqyruar në Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

Referuar kronikave televizive të televizionit Fax News, rezulton se P. Gj., është një gazetar lokal i njohur në Lezhë. Gjithashtu, referuar dhe informacionit të DVP Lezhë, rezulton se P. Gj., ka qenë i njohur nga punonjësit e policisë dhe për më tepër është etiketuar si person problematik dhe konfliktual që në disa raste ka cenuar figurën e punonjësve të policisë në Lezhë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- Ligji 8773/2001 “Për tubimet”;
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

- Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë;
- Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Urdhri nr. 938, datë 24.07.2019 i Policisë së Shtetit, “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

KONKLUZIONE

Komisioneri e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e DVP Lezhë se nuk është ndaluar asnjë gazetar tjetër duke u kthyer nga vendi i protestës, pasi P. Gj., nuk ka qenë në të njëjtat kushte me gazetarët e tjerë në vendngjarje për të cilët nuk ka informacion se si kanë udhëtuar, me mjete transporti publik apo me mjete private, të dallueshme apo jo, pasi ai është ndaluar rreth 40 km nga vendngjarja. Nga ana e DVP Lezhë nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin se P. Gj., nuk ka pasur shenjat e identifikimit si gazetar dhe se DVP Lezhë ka ndjekur procedurën ligjore lidhur me dokumentimin e rastit. Gjithashtu, rezultoi e provuar se P. Gj., është një gazetar lokal që raportonte për televizionin Fax News dhe se njihej nga punonjësit e policisë i identifikuar edhe si person problematik dhe konfliktual.

Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim ndaj DVP Lezhë, duhet të vlerësohet në kuadër të parashikimeve të nenit 3, pika 3, të LMD, pasi konstatohet se ankuesi është diskriminuar si pasojë e ndërveprimit të më shumë se një shkakut dhe konkretisht, atë të profesionit të gazetarit lokal që raporton për problematikat e zonës, Televizioni (Fax News) ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal, si dhe faktit që është njohur si gazetar problematik në zonë, shkaqe të cilat kanë bashkëvepruar në një mënyrë të pandashme me njëri tjetrin në të njëjtën kohë për të prodhuar situatën diskriminuese, atë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar P. Gj., si rezultat i shoqërimit të vetëm këtij gazetari lokal dhe të mosrespektimit të procedurës ligjore të shoqërimit të tij.

Në përfundim, Komisioneri konstaton se Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për të ushtruar profesionin e gazetarit për të raportuar ngjarjet e zhvilluara pas protestës, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë, trajtim i cili ka ardhur si pasojë e identifikimit të P. Gj., si gazetar lokal që raporton për problematikat e zonës dhe se televizioni Fax News kishte një linjë editoriale për evidentimin e problemeve në nivel lokal.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë, të ankuesit, P. Gj., për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.